

NUK MË NDAL ASGJË

Kaluan ditët e verës. Lulja e vogël me prindërit u kthye nga deti.

Shiu i përzuri njerëzit nga deti.

Lulja këto ditë do të bëhet nxënëse. Hyn e del në dhomë dhe e sheh fustanin e ri.

Fustanin për ditën e parë të shkollës. Qëndron pranë dritares dhe shikon

shiu që bie me rrëmbim. Rri Lulja dhe mendohet. E pyet Gimin, vëllaqon,

që hy në klasë të tretë:

- Po të bjerë shi edhe nesër, si do të shkojmë në shkollë?

-E kemi ombrellën, -ia kthen Gimi. Dhe shton: - Ti nesër bëhesh nxënëse, kurse nxënësi nuk i frikësohet shiut.

- Mirë e ke, Gimi, - i thotë Lulja. E kemi ombrellën dhe nuk do të më laget fustani i ri.

As librat dhe fletoret e reja, as kordela ime e kuqe...as...dhe gëzohet Lulja.

- Po kur të bjerë borë, Gimi? - pyet Lulja me kërkshëri.

- Do ta shkelim borën dhe do të shkojmë në shkollë, - i jep zemër Gimi motrës së vet.

Lulja rri pranë dritares, sheh fluskat e shiut në hurdat në oborr, mendohet dhe pyet përsëri:

- Po kur të fryjë era e fuqishme, ajo era që tund e shkund plepat e rugës, si t'ia bëjmë atëherë?

- Nxënësit s'ia ndalë rugën as shiu, as bora, as era...- i përgjigjet vëllai motrës.

- Rri Lulja në dhomë, shikon pikat e mëdha të shiut që trokëlojnë në dritare, shikon fustanin e ri, çantën e re plot libra dhe flet ngadalë, në vetvete:

" Nesër unë shkoj në shkollë. Nesër bëhem nxënëse . Shiu le të bjerë sa të dojë...Ne me

Gimin e kemi ombrellën. Le të fryjë edhe erë. Mirë thotë Gimi: nxënësin nuk e tremb asgjë.

Nesër do të bëhem e madhe edhe mua nuk do të më ndalë asgjë rugës për në shkollë.

Fejzi Bojku



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

- rrëmbim - grabitje
- kërshëri - kuriozitet
- hurdat - vend i mbushur me ujë
- trokëllojnë - bëjnë zhurmë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Si i kaluan ditët e verës Lulja e vogël me prindërit?
- Si do të shkojnë në shkollë po të bjerë shi?
- Çka flet Lulja ngadalë në vetvete?

Të interpretojmë sipas planit:

- Lulja me prindërit u kthyen nga deti.
- Biseda e Lules me Gimin.
- Nxënësit s'ia ndalë rrugën as shiu, as bora, as era..
- Lulja flet ngadalë në vetëvete.

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Në fletoren tënde, shkruaj një hartim të shkurtër për atë se si i ke kaluar pushimet verore duke u bazuar në këto pika:

... me kënaqësi ... duke luajtur ... duke lexuar ... libër ... duke shëtitur ... rrezet e diellit ... valët e detit ... rëra ... liqeni ... lumi ... natyra... mali ... drunjtë ... shpezët ... kullosat ... fushat ... i gëzuar... i lumtur ... me plot dëshirë ...

Të flasim në vetën e parë duke u bazuar në tekstin e mësipërm:




Pushimet verore i kaluam me _____

Të gjithë kemi qenë _____




Tani që filloi viti i ri shkollor, ne jemi më _____

Do të bëhemi më _____

UJKU TREMBET NGA SHKOLLA


 sa dëgjoi  shkollore, i tha mëmës  :


-Mami, ma jep  me  e  se do të shkoj


në  .  ,nga gëzimi e përqafoi 


Gjatë rrugës për në  e takoi  e cila e pyeti:

-Ku po shkon o  me atë  në shpinë?

-A s'e dëgjove  shkollore? Po fillon viti i ri shkollor.

-Prit se po vij edhe unë! Po a nuk frikohesh prej  ?

-Jo, aspak! Edhe ti mos u friko, sepse  shumë trembet nga

 ,  ,  dhe  !

Qemal Halili


lepurushi



zilja



lepurusha



çanta




libri



lapsi



shkolla



drenusha



ujku



Të kuptojmë përmbajtjen:

- Çka i tha lepurushi mëmës kur e dëgjoi zilen?
- Ç'bëri lepurusha nga gëzimi?
- Kë e takoi lepurushi gjatë rrugës për në shkollë?
- Çka e pyeti drenusha lepurushin?
- Si iu përgjigj lepurushi drenushës?
- Prej kujt frikohej drenusha?
- Prej kujt frikohej ujku?

Të lexojmë bukur:

- Lexoni tekstin duke i zëvendësuar figurat me fjalë: lepurushi, zilja, lepurusha, çanta, libri, lapsi, shkolla, drenusha dhe ujku.

Të zhvillojmë aktivitet:

- * Shkruani tekstin në fletore duke u bazuar në figurat e dhëna.

PËRRALLA PËR DY MOLLË

Fëmijët ktheheshin nga shkolla.

-Mirëdita, xha Zeqo!-e përshëndetën fëmijët bariun e fshatit.

-Mirëdita!

-Do të na e tregosh një përrallë të bukur? -lutën fëmijët.

-Po,do t'ua tregoj nëse dini të përgjigjeni në një pyetje. Dakord?

-Dakord, -pranuan fëmijët njëzëri.

-Dëgjoni pra. Në ditën e Dytë, të javës së Dytë, të muajt të Dytë, në orën Dy, në rrugën e Dytë të lagjes së Dytë, në qytetin e Dytë, i kam parë Dy mollë!.

-Pastaj?-pyetën fëmijët.

-Ju e keni për detyrë t'ia qëlloni ç'u bë me to?

Fëmijët menduan e menduan, pastaj u përgjigjën.

Fëmija i PARË: I ke marrë ti dhe i ke ngrënë.

Fëmija i DYTË: I ke marrë ti, nuk i ke ngrënë, por ua ke dërguar fëmijëve në shtëpi.

Fëmija i TRETË: Vetëm i ke shikuar dhe nuk i ke marrë. I ke lënë aty ku i ke gjetur.

Fëmija i KATËRT: Nuk i ke marrë, sepse ke shpresuar që mund të kthehet pronari i tyre.

Fëmija i PESTË: Ti nuk ke pasur mundësi ta bësh as njërën prej këtyre që i thanë shokët e mi, sepse ato Dy mollë kanë qenë duke i ngrënë Dy fëmijë...

-Shumë bukur ia qëlllove, -tha bariu i fshatit.

-Tash na e trego përrallën – kërkuan fëmijët.

-Pse, kjo që ua thash nuk ishte përralla për Dy mollët, që i hëngrën Dy fëmijë?

Ragip Ramaj



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

dakord – në rregull
lagjes – mëhallës

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Me kë u takuan fëmijët kur ktheheshin nga shkolla?
- Për çfarë e lutën fëmijët xha Zeqon?
- Pasi ranë dakord, si e filloi tregimin bariu i fshatit?
- Ç'u dha për detyrë fëmijëve?
- Si u përgjigj fëmija i pestë?
- Cila ishte përralla që ua tregoi xha Zeqo?

Të interpretojmë sipas planit:

- Kthimi i fëmijëve nga shkolla dhe takimi me xha Zeqon.
- Biseda e tyre me xha Zeqon.
- Përgjigjja e bukur e fëmijëve.
- Përgjigjja e xha Zeqos.

Të lexojmë bukur:

Lexoni tregimin rrjedhshëm sipas roleve.

Të zhvillojmë aktivitet:

* Shkruani në fletore si në shembullin e dhënë:

F-1	Fëmija i parë	F-6	Fëmija i gjashtë
F-2		F-7	
F-3		F-8	
F-4		F-9	
F-5		F-10	

Shkruani në fletore përgjigjet e pesë fëmijëve, sipas tregimit:

F-1 _____

F-2 _____

F-3 _____

F-4 _____

F-5 _____

GJUHA SHQIPE

Kodrina, brigje
proje, burime,
dinë gjuhën shqipe
të nënës sime.



Rrypina, gryka,
suka, rrënime,
e flasin gjuhën
e nënës sime.



Në pyje, zabele,
shullane, rripe,
ligjëron bilbili
në gjuhën shqipe.



Çdo gur i vendit,
çdo lul'e mbime,
dinë gjuhën shqipe
të nënës sime.

GJUHA BASHKON KOMBIN

Rexhep Hoxha



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

rrypina - brez i ngushtë dhe i gjatë toke; vend i pjerrët
shullane- vend që e zë dielli mirë
rripe - rrypina
ligjëron - këndon

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kujt i kushtohet vjersha?
- Kush e di dhe e flet gjuhën shqipe, sipas strofës së parë dhe të dytë të vjershës?
- Në ç'vend ligjëron bilbili në gjuhën shqipe?
- Cilën gjuhë e flasin prindërit e tu?

Të lexojmë bukur:

- Lexoni strofën e parë. Kujdes, pas çdo fjale ka presje, ndaloni zërin për çdo presje dhe në fund të vargut.
- Lexoni strofën që ju pëlqen më tepër.

Detyrë:

Mësojeni vjershën përmendsh dhe recitojeni bukur!

Të shtojmë njohuritë:

Gjuha që flasim ne shqiptarët është gjuha shqipe.
Këtë e kanë folë të parët tanë me mijëra vjet më parë.

Të zhvillojmë aktivitetet:

* Formoni fjalë me rrokjet dhe shkruani ato në fletore:

na-në

nëna

ha-gju

bi-bil-li

nja-shqi-po

dhe-më-më-u

HUANI DHE MILINGONA

Huani i vogël shkoi të mësojë në qytet. Por, që nga dita e tretë iku nga shkolla.

-Sa shumë shkronja!-ofshau-Asnjëherë nuk do të mund t'i mësoj!

Dhe u nis drejt fshatit. Kur u lodh, u ul të pushojë. Në atë moment pa një milingonë duke bartur një kokërr gruri gati dy herë më të madhe se vetja.

Duke u tërhequr ashtu zvarrë, milingona arriti deri te një pjerrinë dhe kurrsesi t'ia dalë me barrën e rëndë në shpinë. Pas pak fryni një erë dhe ia rrokullisi kokrrën nga shpina. Ajo e mori përsëri dhe me një mundim të madh përsëri e vuri në shpinë dhe iu ngjiti pjerrësirës. Era prapë e rrëzoi, e ajo sërish e ngarkoi dhe vazhdoi rrugën. Në fund, pas shumë tentimesh arriti ta fus në vrimën ku e kishte shtëpinë.

-Shih, shih, sa çudi! -tha Huani. -Kjo milingonë kaq e vogël, me aq përpjekje e mundim të madh arriti që edhe kundrejt erës dhe pjerrësirës ta çojë kokrrën deri në banesën vet, ndërsa unë u frikova nga disa shkronja!

Dhe i turpëruar u kthye prapë në shkollë dhe vazhdoi mësimin.

Tregim popullor kinez



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

milingona – mizë dheu, thnegël
ofshau – rrënkoi thellë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku shkoi Huani i vogël?
- Pse iku nga shkolla?
- Ç'bënte milingona?
- Pse më vonë Huani u kthye në shkollë?

Të interpretojmë sipas planit:

- Huani i vogël shkoi në shkollë.
- Milingona e vogël bartte në shpinë një kokërr.
- Milingona arriti në banesë.
- Huani i turpëruar u kthye në shkollë.

Të zhvillojmë aktivitet: (Bashkëbisedim)

- * Çka na tregon ky tregim popullor kinez?
- * Tregoni ndonjë rast kur ju nuk keni qenë këmbëngulës në ndonjë punë.

“Puna këmbëngulëse e mposht çdo vështirësi dhe pengesë
dhe asnjë punë nuk është e vështirë,
nëse do dhe ke vullnet.”

O R A

T i k – t a k, t i k – t a k,
punon ora mbi oxhak.

T i k – t a k, t i k – t a k,
ecë akrepi pak nga pak.

-T i k – t a k, "hajde", zgjohu,
lahu, krehu, rregullohu!

T i k – t a k, mirë vishu,
Mbathi këpucët edhe nisu!

Shko në shkollë të mësosh,
djalë i urtë, bukurosh!

I.D



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

oxhak – vatra ku ndizet zjarri dhe shkon tymi
akrep – shigjetëzat e orës që rrotullohen

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Si bën ora?
- Ç'bën akrepi?
- Çka lajmëron tiktaku i orës?

Detyrë:

- Lexojeni me vëmendje këtë vjershë dhe tregoni se ç'bëjnë: ora, akrepi dhe djali!
(Kini kujdes në fjalët që tregojnë veprime).
- Shkruani në fletore porosinë e orës që i jep djalit
(duke u bazuar në vargjet e fundit të vjershës).
- Mësoni vjershën përmendsh!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shkruaj në fletore, sipas modelit, disa fjali duke i plotësuar me foljet e vjershës: "Ora"!

.....ora mbi oxhak.

Punon ora mbi oxhak.

..... akrepi pak nga pak.

Nga gjumi....., sytë....., flokët....., rrobat, mirë.....,
këpucët..... edhe për në shkollë!

.....në shkollë të.....,djalë i urtë, bukurosh.

Bëj autodiktimin e vjershës!

TREGIMI GRAMATIKOR

Jetonte dikur një bretkosë. Bretkosa si bretkosë,
e vogël, me tri rrokje: BRET-KO-SA.

Jetonte dikur një dre.

Dre! I madh, i madh! Por vetëm me një rrokje: DRE!

Kurse bretkosa e vogël tallej me drerin e madh:

-E, e, e! Sa i madh, kurse vetëm me një rrokje!

Por nga kënetat doli një GA-TË me dy rrokje dhe e kollofiti
BRET-KO-SËN me tri rrokje.

Dhe, kjo ishte e tëra...

Emë Moshkovska



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

kënetë – vend me ujë të ndenjur, moçal
dre – kafshë e egër me brirë të gjatë
gatë – shpend uji që rri nëpër kënetë
kollofiti – gëlltiti, e hëngri

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ndërmjet kujt zhvillohet biseda në këtë tregim?
- Ç'bëri bretkosa?
- Si tallej bretkosa me drerin?
- Ç'i ngjau bretkosës e cila lavdërohej?

Të interpretojmë sipas planit:

- Bretkosa: me tri rrokje.
- Dre: me një rrokje.
- Lavdërimi i bretkosës.
- Gata hëngri bretkosën.

Të lexojmë bukur:

Lexoni me kujdes fjalët lavdëruese të bretkosës.

Të zhvillojmë bisedë:

Pse tregimi ka titullin: “Tregimi gramatikor”?

Të zhvillojmë aktivitet: (Shkruani në fletore)

- * Ndaj në rrokje fjalët vijuese: tregimi, druri, jetonte, zanore, kallëzim.
- * Shkruaj nga dy fjalë që përbëhen me nga një, dy dhe tri rrokje.
- * Përshkruaj pesë rreshta nga kallëzimi, mandej ndaj emrat në rrokje.

Mbaj mend:

Sa zanore ka fjala, ka po aq rrokje.

LIBRI I HUAZUAR

Librat e huazuar ndonjëherë ngjajnë mu si jetimë. Më ndodhi mua njëherë të shoh se si një fëmijë i shkarraviste fletët e një libri. Atëherë i thashë:

-Pse nuk kujdesesh më mirë për librin?

Fëmija m'u përgjigj:

-Paj, nuk është i imi!

-E dëgjuat? Libri i huazuar duhet të ruhet më mirë se i yti!

France Bevk



GJËEGJËZË

Ara e bardhë-fara e zezë,

(L).

Me dorë mbillet-me gojë s'lidhet

(Sh)

LIBRI ËSHTË PASURI MË E MADHE



KULTURË NGA MEDIUMET:

Njerëzit që shkruajnë vepra letrare quhen shkrimtarë.

Shkrimtarët që shkruajnë vjersha quhen poetë.

Tekstet shkruhen në prozë dhe në vargje.

Librat e shkrimtarëve shiten në LIBRARI.

Librat për të lexuar huazohen në BIBLIOTEKË.

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

huazuar – një gjë që mirret për ta kthyer prapë.
jetimë – këtu: i shkretë, i mjerë
shkarraviste – përlynte

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'kishte bërë një fëmijë me librin?
- Ç'i kishte thënë njeriu i panjohur djaloshit?
- Si është përgjigjur fëmija?
- Ç'mendoni për përgjigjen e fëmijës?

Të interpretojmë sipas planit:

- Njeriu i panjohur sheh fëmijën duke shkarravitur librat.
- Pyetja e njeriut që ja bëri të panjohurit.
- Përgjigjia e fëmijës.
- Porosia e njeriut të panjohur.

Të lexojmë bukur:

Lexoni me kujdes porosinë në rreshtin e fundit të tregimit!

Bashkëbisedim:

- * Prej ku huazohen libra për të lexuar?
- * Kush punon në bibliotekë?
- * Si vepron ti me librat e huazuar në bibliotekë?
- * Cili është libri i fundit që ke huazuar në bibliotekë dhe a e ke lexuar?

Të zhvillojmë aktivitetet:

Shkruaje një fjali në lidhje me librin, sipas zgjedhjes tënde!

Shkruaje fjalinë me fjalët që mungojnë:

Librat e..... duhet të më mirë se

(Nëse nuk të kujtohet lexo tregimin!)

LIBRI I PINOKUT

-Dua menjëherë të nisem për në shkollë!- i tha Pinoku babait të vet, Gjepetos. Do të doja që në një mënyrë edhe të të falënderoj për të gjitha ato punë që ke bërë për mua.

-Shumë djalë i mirë më je!...u përgjigj Gjepeto.

-Po, për në shkollë më duhen rroba!...

Varfanjak, pa një lek në xhep, Gjepeto vetë i qepi rrobat Pinokut nga një letër gazete. Këpucët ia bëri nga lëvorja e drurit, kurse kapelen ia ndreqi nga gualli i kungullit. Për një çast, Pinoku u gjend pranë legenit plot me ujë që i shërbente si pasqyrë, i kënaqur kështu si ishte, gëzueshëm klithi:

-Ehe...si ngjasokam, si një zotëri i rëndë!...

-Ashtu është! Rrobat e pastërta e bëjnë njeriun zotëri, e jo të rejat-u përgjigj Gjepeto.

-Si do të shkoj në shkollë, kur nuk kam gjënë më të vlefshme?

-Çka të mungon?

-Nuk kam Libër.

-Po, si do ta blejmë? -pyeti Gjepeto.

-Lehtë, do ta gjejmë në librari dhe aty do ta blejmë.

-E, para? S'kemi para-tha Gjepeto.

Pinoku u shqetësua edhe pse është fëmijë i qetë për nga natyra. Të gjithë e kuptojnë peshën e varfërisë, bile aq më shumë fëmijët.

-M'u kujtua! -në moment bërtiti Gjepeto.

Ai veshi kapotën e vjetër dhe doli nga shtëpia. Kur u kthye, në dorë mbante librin, por tani më në trup nuk kishte kapotën edhe pse jashtë binte borë.

-Ku e ke kapotën babi? -pyeti Pinoku.

-Më vinte nxehtë...

-Pinoku menjëherë kuptoi se ç'ishte puna. Kishte zemër të mirë dhe nuk arrinte të fshihte dashurinë e vet. Duke iu hedhur në përqaftimin atëror, ai filloi të puthte faqet e plakushit.



Karlo Kolodi

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

rroba – veshje
varfanjak – i varfër
kapelë - kaçketë
gualli – lëvorja e kungullit

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Për ku bëhej gati Pinoku?
- Çfarë brengje kishte ai?
- Çfarë rrobash i qepi Gjepeto?
- Çfarë bëri plakushi për t'i blerë libër Pinokut?
- Si e shprehu Pinoku dashurinë e tij ndaj babait të vet?

Të interpretojmë sipas planit:

- Nisja e Pinokut për në shkollë.
- Qepja e rrobave nga ana e plakushit.
- Pinokut i mungonte libri.
- Gjepeto del nga shtëpia.
- Kthimi i Gjepetos me libër në dorë.
- Shprehja e gëzimit nga ana e Pinokut.

Bashkëbisedim:

- * Cilën shfaqje të teatrit me kukulla ke parë apo ke dëgjuar?
(Qoftë në teatër, qoftë në televizor apo në radio).
- * Përshkruaje pamjen e Pinokut dhe trego se ku ndryshon ai nga kukullat tjera!

Të shtojmë njohuritë:

- Shfaqje teatrale është ajo shfaqje ku aktorët luajnë në skenë para shikuesve. Ka shfaqje teatrale ku aktorët zëvendësohen me kukulla dhe ato quhen shfaqje kukullash. Pinoku është kukulla më e njohur në botë, është i ndërtuar nga druri dhe ka hundë të madhe.
“Hunda e Pinokut rritet edhe më shumë kur ai gënjen”

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Përshkruaje Pinokun duke u shërbyer me tekstin!
Si duket nga pamja e tij e jashtme?
(trupi, koka, hunda, këmbët dhe duart) .

MOLLA

Ende s'kishin xixëlluar yjet në qiell, kur nëna e Zanës shkoi te një shoqe.
Zana qe duke fjetur.

Kur u zgjua, në dhomë ishte vetëm babai, motra më e madhe Rona dhe vëllai, Adriani.
Vogëlushja nisi të qajë me ngashërim. Kërkonte nënën.

“Sillni një mollë të kuqe dhe të ëmbël për Zanën!”, -tha babai. Rona vrapoi në dhomën tjetër dhe i solli mollën. Molla ishte e kuqe mu si faqet e Zanës.

Babai filloj t'ia ndajë në flegra. Ashtu ka dëshirë Zana. Këtë e dinë të gjithë.


Derisa babai po ndante mollën në flegra, vogëlushja pushoi së qari. Vetëm, nëpër skajet e syve i kishte ngelur nga një pikë lot.

Zana u ngrit, mori flegren e parë, po në vend që ta kafshonte, ia dha të vëllait, Adrianit.

“Urdhëro, Ardi! Unë kam mjaft” -tha.

Në zemrën e vëllait sikur këndoij një bilbil.

Zejnullah Halili



Të kuptojmë fjalët e panjohura

ngashërim – mallëngjim i thellë
flegra – një pjesë e prerë e mollës

Të kuptojmë shprehjet:

sikur këndoi një bilbil – u gëzua;
i qeshi fytyra

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku shkoi nëna e Zanës?
- Ç'bëri Zana kur u zgjua?
- Çka tha babai?
- Ç'bëri Zana pasi mori flegrën e mollës?
- Si u ndje vëllai i Zanës, Ardi, në atë moment?

Të interpretojmë sipas planit:

- Nëna e Zanës shkoi te një shoqe.
- Zana u zgjua dhe filloi të qajë.
- Rona i solli mollë.
- Babai nisi t'ia ndajë mollën në flegra.
- Zana ia dha flegrën e mollës Ardit.


Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Tregoni me fjalët tua rastin kur Zana veproi mirë me të vëllanë.
- * Çfarë thoni kur jepni dikujt ndonjë gjë. Çfarë thoni kur kërkon ndonjë gjë?
- * Përcaktoni me shenjë (✓) gjininë dhe numrin e këtyre emrave dhe shkruani sipas shembullit të dhënë.

	Gjinia		Numri	
	Mashkullore	Femërore	Njëjës	Shumës
një mollë		✓	✓	
yje				
babai				
motër				
dhoma				
bilbil				

Një mollë: është emër i gjinisë femrore në numrin njëjës.

FRUTËZA, MOJ FRUTËZA!



Dardhëza, moj dardhëza,
me lule të bardhëza;
a e dini? Unë
seç ju dua shumë,
kur çelni petalet
si bora në malet.

Kumbulla, moj kumbulla,
me lule të bukura,
a e dini? Unë
seç ju dua shumë,
porse, pa u pjekur,
nuk kam për t'ju prekur.

Mollëza, moj mollëza,
me cipëza të hollëza,
a e dini? Unë
seç ju dua shumë,
kur ju skuqin faqet,
zemra më kënaqet!

Adelina Mamaqi

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

frutëza- kokrrat e pemëve
petalet – fletët e luleve
cipëza- fija e hollë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kujt i këndon poetja në strofën e parë?
- Si ngjajnë petalet e luleve?
- Në strofën e dytë, kujt i këndon?
- Çfarë porosie jep poetesha në këtë rast?
- Meqë në strofën e tretë i këndon mollës,
ç'ndjen ajo kur i sheh fëmijët me faqet e skuqura?

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Cilën shkronjë duhet ta shënojmë në katror për t'i shëndërruar emrat e mëposhtëm në numrin shumës:

dardh →
kumbull →
moll →

□

Ç'frutë ju pëlqen më shumë? Tregoni pse?

Përshkruani dardhën dhe thoni se ku ndryshon ajo nga molla.

Përshkruani një frutë pa ia thënë emrin. Shokët le të thonë se për cilën frutë është fjala.

KAM NJË SHPORTËZË ME MOLLË



Vjeshta erdhi dhe iriqit na i dha një shportë me mollë, dhe i tha: -Të pret mësuesja,- mos vono, nisu në shkollë!

Dhe gjembaçi ëmbël foli: -Ti më prit e dashur shkollë, pa më prisni dhe ju, shokë, kam një shportëzë me mollë.

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

gjembaç – iriq
shportëzë – shportë e vogël

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Çka i dha vjeshta iriqit?
- Ç'i tha ajo?
- Çka foli gjembaçi?
- Çka i tha në fund shkollës, klasës, bangëz dhe shokëve?

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Gjej emrat në vjershën e mësipërme dhe radhiti sipas gjinisë.
- Nëse emri përsëritet disa herë, shkruaje vetëm njëherë.

Gjinia	
Mashkullore	Femërore
iriqi	vjeshta

Lexoni emrat e mëposhtëm dhe vëndoni shenjën (✓) për pemët, kurse shenjën (✓) për perimet.

molla	✓	karota	✓
hudhra		kungulli	
speci		qepa	
pjeshka		rrushi	
domate		lakra	
patate		kajsia	
dardha		kumbulla	
grosha		vishnja	
ftoi		dredhëza	
qershia		trangulli	

PSE XIXËLLONJA NUK KA MIQ

Personazhet: TREGIMTARI, XIXËLLONJA, KARKALECI, MILINGONA.

Tregimtari: Një natë të bukur vere xixëllonja e ndjeu veten shumë të vetmuar e të mërzhitur. Prandaj, mori fenerin dhe fluturoi për të gjetur ndonjë mik.

Xixëllonja: Ore, karkalec, dëshiron të bëhemi miq?

Karkaleci: Po, dua.

Xixëllonja: Atëherë, eja të luajmë!

Karkaleci: Po, pritme njëherë! Së pari, patjetër ta gjej vëllaun tim!

Xixëllonja: Nuk kam kohë për të pritur. Nesër do të luaj me ty.

Tregimtari: Më pastaj xixëllonja u takua me milingona.

Xixëllonja: Ore, bubrec, dëshiron të luajsh me mua?

Milingona: Dua, por më së pari duhet ta shpie këtë kokërr në shtëpi.


Nëse dëshiron, mund të ma ndriçojsh rrugën deri atje.

Xixëllonja: Nuk mundem, tani shpejtoj të gjej ndonjë mik.

Tregimtari: Tërë verën xixëllonja fluturoi andej-këndej me fenerin e saj.

E, ç'kërkonte? Ndoshta ndonjë mik! Ç'mendoni ju, pse deri tani ende nuk e ka gjetur?

SUN JUN GJIN



Fjalë të urta për miqësinë:

“Miku i mirë është si vëlla”

“Edhe pse ke vëlla, mos rri pa mik”

“Miku i mirë shihet në ditë të vështira”

“Më trego me kë rri, të të tregoj se kush je”

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

personazhe – persona, vetë
tregimtari – rrëfimtari
karkaleci – mizë e madhe
fener – llampë ndriçimi
shpie – çoj, dërgoj

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Si e ndjeu veten një natë xixëllonja ?
- Ku fluturoi ajo?
- Ç'kërkonte nga karkaleci dhe milingona?
- Xixëllonja a gjeti mikun që kërkonte ?
- Pse nuk gjeti asnjë mik?

Të interpretojmë sipas planit:

- Xixëllonja del për të gjetur ndonjë mik.
- Takimi me karkalecin.
- Takimi me milingonën.
- Xixëllonja nuk gjen asnjë mik.

Të bisedojmë së bashku:

- * Përgjigju në pyetjen e fundit të tregimit:
- * Me çka e arsyeton xixëllonjën?
- * Me çka e fajëson?
- * Kush është shoku yt më i ngushtë?
- * Numëro shkaqet se pse shoqërohesh me të!
- * Së bashku me mësuesin, gjeni fjalitë që ju kanë pëlqyer më së shumti.

Të zhvillojmë aktivitetet:

Shkruaj si duhet fjalitë e dhëna:

1.Fjalitë me fjalët që mungojnë.

Njëherë e pyeta time.

-A e di Enën e kammë të

2.Fjali të shkruara me fjalë të gabuara.

-Sepse me Elën imi shoçe dhe rrijmë mu një bën�. Bashk mësojm dhe i tregojm detirat njëna qetrës.

3.Fjali në të cilat ka fjalë të përenditura.

zë me Qesha. ula U bankë në.të mirë kishte Ena vërtetë me të shoqe.

Ç'KA KJO DALLËNDYSHE



Ç'ka kjo dallëndyshe,
kë vallë kërkon,
herë përmbi tela,
herë në ballkon?

Fluturon e ndalet,
shikon në çdo skaj;
më në fund e gjeti
mikeshën e saj:

-Mirupafshim, Mira,
nisem për shtegtim;
ciu, ciu, çerdhen
ta lë si kujtim!



Bekim Harxhi

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

mikeshë – mike, shoqe
shtegtim – udhëtim

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'bënte dallëndyshja?
- Ku ndalet ajo?
- Çka gjeti ajo më në fund?
- Çfarë porosie i la mikeshës së saj?

Të interpretojmë sipas planit:

- Dallëndyshja kërkon andej-këndeje.
- Ajo gjen mikeshën e saj.
- Përshëndetet me Mirën.

Të zhvillojmë aktivitet: (Bashkëbisedim)

- * Cila shpezë të pëlqen më shumë? Pse?
- * Çfarë shpezësh ka në rrethinën tënde ku jeton? Shkruaj ato në fletore.
- * Përshkruaje dallëndyshen. Thoni ku ndryshon ajo nga laraska.
- * Përshkruaje me fjalë një shpezë pa thënë emrin e saj.
- * Le ta gjejnë shokët se për cilën shpezë bëhet fjalë.



ARUSHI I NGRIRË

Ishte se ç'na ishte...

Ishte qëmoti-thotë përralla-një Arush i vogël. Ai kishte dëshirë t'i hapte syzet e tavolinave në shtëpi, lëshonte radion:trak, lëshonte televizorin dhe hapte derën e frigoriferit. Uh, sa i bezdisshëm që ishte!

Një mëngjes e ëma dhe i ati sapo bëheshin gati të shkonin në punë, i thanë:

“Do të rrish urt, biri ynë?Të mos hapësh asnjë syze, asnjë dollap!”

Ai tha “po”,duke pohuar me kokë.

E ëma dhe i ati e puthën dhe e lanë në shtëpi. Pa kaluar as gjysmë ore, ai u mërzit.

Nisi të hapte krahët e dollapëve, lëshoi radion që bënte zhurmë, lëshoi televizorin.

Hipi mbi karrige, çoi receptorin e telefonit. Desh të bisedonte me dikë, sepse ishte i vetmuar, por telefoni nuk thoshte asnjë fjalë,por bënte:ti...ti...ti.

Dikur ky Arushi i vogël hapi derën e frigoriferit. Atje lartë pa një tortë që e kishte lënë e ëma. Hop, kërceu ta kapte dhe u fut brenda në frigorifer.

Obo-bo.U mbyll në frigorifer. Aty ishte terr. Aty ishte ftohtë.

Dikur i ati telefoni nga zyra, por nuk dëgjoi zërin e tij. U merakos sa s'bën. Thirri të shoqen dhe me veturë nxituan dhe shkuan në shtëpi. Panë krahët e hapur të dollapëve, syzet e tavolinave, radioja gumëzhinte, televizori po ashtu. Shikuan gjithandej, por nuk e gjetën. Më në fund kur hapën derën e frigoriferit e panë të ngrirë. I tëri ishte i bardhë.

Mezi lëvizte qepallat. Atëherë e shpurën në banjo, e lanë me ujë të vakët, e fshinë me peshkirë dhe e shpurën te mjeku që i bëri ca gjilpëra.

Rifat Kukaj



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

syzet -raftet, sirtarët
receptorin - folësen e telefonit
tortë - ëmbëlsirë
gumëzhinte - ushtonte ,gjëmonte
gjithandej - gjithkund, kudo kahmos
qepallat- kapakët e syrit
e shpurën - e çuan, e dërguan

Të kuptojmë shprehjet:

Ja bëri ca gjilpëra - i dha injeksione

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Për kë bëhet fjalë në këtë tregim?
- Çfarë prirjesh kishte Arushi i vogël?
- Çka e porositën nëna dhe babai kur shkuan në punë?
- A e mbajti premtimin Arushi?
- Ç'bëri ai pas një gjysmë ore?
- Pse u merakos babai kur telefonoi nga zyra?
- Ç'panë nëna dhe babai kur u kthyen nga puna?
- Ku e çuan Arushin?

Të interpretojmë sipas planit:

- Sjelljet e këqia të Arushit.
- Këshillat e prindërve para se të nisen për në punë.
- Veprimet e Arushit pa praninë e prindërve.
- Kthimi i babait dhe nënës me nxitim.
- Shpjerja e Arushit në banjo dhe te mjeku.

Të lexojmë bukur:

- * Lexoni me zë fjalitë ku shprehen veprimet e këqia të Arushit!
- * Lexoni me kujdes këshillat e prindërve që ia përcjellin të birit!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shkruani sjelljet e kundërta nga ato që i bën Arushi:

Arushi i vogël i hapte syzet e tavolinës.

Unë nuk i hapi syzet...

Arushi i vogël lëshonte radion me zë të lartë. -----

Arushi i vogël hapte derën e frigoriferit. -----

Arushi i vogël luan me telefonin. -----

PËRRALLAT

Goni hyri në librari. Sapo e pa xhaxhi shitësin u habit. "Ky qenka gjyshi" -tha me vete.
-Urdhëro, vogëlush!-tha xhaxhi shitësi.

-Më falni, xhaxhi, ju nuk qenkeni gjysh...Më thanë se dini shumë përralla, - tha Goni.

-Mirë të kanë thënë, unë di shumë përralla,-u përgjigj xhaxhi shitës dhe priti ku do të dalë vogëlushi.

Goni, disi mori frymë më lehtë dhe pyeti:

-A m'i shitni disa?- dhe ia zgjati dorën me paratë që i mbante në grusht.

-Po, - u përgjigj xhaxhi shitësi dhe nga mesi i librave të shumtë e nxori njërin prej tyre.

Goni doli nga libraria shumë i gëzuar për përrallat që i bleu.

Ragip Ramaj

LIBRARIA



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

librari – dyqan ku shiten libra

Të kuptojmë shprehjet:

ku do të dalë- çka do të bëjë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku hyri Goni?
- Kë e pa në librari?
- Ç'mendoi Goni kur e pa xhaxhi shitësin?
- Ç'bisedë u bë ndërmjet Gonit dhe xhaxhi shitësit?
- Si veproi xha shitësi kur vogëlushi i dha paratë?
- Si e ndjeu veten Goni kur doli nga libraria?

Të interpretojmë sipas planit:

- Goni në librari.
- Xha shitësi nuk është gjysh.
- Vogëlushi “blen” përralla.

Punë e pavarur:

Ky tregim është i shkruar në formë të bisedës ndërmjet Gonit dhe xhaxhi shitësit. Tentoni të luani në role: njëri të bëhet Goni, kurse tjetri xhaxhi shitës. Më pastaj ndërroni rolet.

Të shtojmë njohuritë:

- * Përrallat janë tregime shumë tërheqëse për fëmijët. Pleqtë tanë dinë shumë përralla. Lutni ata që t'ju rrëfejnë ndonjë prej tyre!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shkruani dy fjali ku shprehet mirësjellja ose bontoni:

1.

2.

Shkruajeni tregimin në fletore në formë të dramatizimit. Psh:
Xhaxhi shitës: (pasi e pa Gonin duke hyrë në librari): Urdhëro, vogëlush!
Goni: ...

POROSIA E FUNDIT E SKËNDERBEUT

Skënderbeu, para se të vdiste, thirri pranë vetes trimat e tij. Iu drejtua më të riut e i tha:
-Gjin, ti je i ri e i fuqishëm. Merri ato thupra dhe ashtu grumbull siç janë, thyjeji! Djaloshi mori thuprat dhe u përpoq me gjithë fuqinë, por s'i theu dot. Pas tij provuan edhe dy-tre të tjerë, por as ata nuk mundën t'i thyenin. Atëherë Skënderbeu iu drejtua të birit:

-Gjon, veçoi thuprat dhe thyjeji një nga një.

Gjoni i theu të gjitha.

-Siç e patë,-tha Skënderbeu, - as më i fuqishmi nga ju s'mundi t'i thyejë thuprat së bashku, kurse një nga një i theu edhe Gjoni që është ende i vogël. Prandaj porosia ime e fundit është: "Qëndroni gjithmonë të bashkuar, sepse kështu edhe pa mua do të fitoni. Shqipërisë nuk i kanë munguar trimat.Betohuni!"

Menjëherë të gjithë trimat nxorën shpatat dhe thirrën:

-Betohemi!

Luftërat për liri vazhduan edhe pas vdekjes së Skënderbeut.

● NË BASHKIM ËSHTË FUQIA. ●



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

porosi – amanet, urdhër në formë këshille
betohemi – japim besën, japim fjalën

Të kuptojmë shprehjet:

porosia e fundit- fjalët e fundit para se të vdiste

Të kuptojmë përmbajtjen:


- Ç'bëri Skënderbeu para se të vdiste?
- Çfarë e urdhëroi Gjiniin të bënte?
- Por Gjoniit çfarë i tha të bënte?
- Ç'u tha trimave më pastaj?
- Cila ishte porosia e fundit e Skënderbeut?
- Pse u betuan të gjithë luftëtarët?

Të interpretojmë sipas planit:


- Skënderbeu dhe Gjini.
- Skënderbeu dhe Gjoni.
- Porosia e fundit.
- Betimi i trimave.

Të shtojmë njohuritë:


* Në paraqitjet e mëposhtme janë armët që përdorshin nga ushtria e Skënderbeut.




shpatë



heshtë



parzmore



hark me shigjetë

Të zhvillojmë aktivitetet:

Bashkarisht në klasë shikojeni filmin: “Skënderbeu” dhe bisedoni në lidhje me filmin!
Simbas mundësive, ftoni në shkollë ndonjë aktor dhe bisedoni për filmin e shikuar!



SA JEMI SHQIPTARË

Sa jemi shqiptarë
kemi gjithë një besë,
jemi gjithë një farë
dhe rojm' me një shpresë,
s'jemi kurrë të ndarë.

Në çdo vend që t'jemi,
mëmëdhen' kujtojmë,
'dhe kudo të vemi,
kombin s'e harrojmë,
vëllazërin' e kemi...

Naim Frashëri

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

sa jemi – gjithë sa jemi
një farë – një fis, një komb
mëmëdheun – atdheun
të vemi – të shkojmë

Të kuptojmë shprehjet:

s'jemi kurrë të ndarë- jemi të bashkuar
vëllazërinë e kemi- e kemi dashurinë për
njëri-tjetrin

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kujt ia kushton këtë vjershë Naimi?
- Cilat vlera të shqiptarëve i çmon ai?
- Pse Naimi ndien dashuri për kombin?
- Ç'na mëson shkrimtari me këtë vjershë?

Të lexojmë bukur:

- Lexoni vargjet ku tregohen cilësitë e shqiptarëve.
- Lexoni vargun që ju pëlqen më shumë.
- Mësojeni vjershën përmendsh dhe recitoheni bukur!

Të bisedojmë së bashku:

- * Në cilin qytet ose fshat jetoni ju?
- * Çfarë qytetesh tjera keni parë?

Të zhvillojmë aktivitetet:

Përsëriteni në fletore pesë vargjet e fundit.

Plotësoni këto fjali:

- Pranë qytetit (fshatit) ndodhet mali _____
- Në qytetin (fshatin) tonë rrjedh lumi _____
- Vendi ynë ka _____

DUAJE ATDHENË SI DALLËNDYSHJA FOLENË

NJERIU PA SHOKË SI MURI PA THEMEL

Agim Bora ishte djalë tregtari. Kokën e ka në qiell e mendjen në diell, thoshin për të shokët e klasës. Përditë e ndërronte veshjen. Flokët e shamosura i mbante çdo ditë. Madje dukej se edhe fytyrën e lyente me krema. Rrinte i vetmuar dhe i shihte “rrjepacakët”, siç i quante ai të varfërit. Ama në mësim ishte tapë. E ëma dhe i ati kujdeseshin veç ta rritnin të shëndetshëm.

Një mbasdite, djaloshi bukurosh ndodhej i shqetësuar: po kryente detyrat e matematikës dhe u mërzit pasi që nuk po zgjidhte dot asnjë ushtrim. Gjyshi, burrë i rryer, kuptoi shqetësimin e nipçes dhe iu afrua.

-Hë, Gimi,- foli me përkëdhelje,- nuk po i zgjidh dot detyrat, më duket.

-Po, gjysh. Janë shumë të vështira!

-Atëherë shko këshillohu me shokët, more nipçe!

-Ata janë rrjepacakë!

-Aha! Kështu do të përfundosh keq, biro! Njeriu pa shokë është si muri pa themel. Prandaj, muri pa themel shkërmoqet edhe nga një lëkundje më e lehtë.

● MENDJEMADHËSIA ËSHTË LIGËSI ●

Bardhyl Xhama



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

tregtar – njeri që mirret me shitblerje
të shamosura – të lyera me gel
krem – preparat për të lyer fytyrën
i rryer – me përvojë të pasur jetësore
rrjepacakë – leckamanë
shkërmoqet – prishet, rrënohet

Të kuptojmë shprehjet:

kokën në qiell e mendjen në diell –
mbahet mendjemadh
ishte tapë – nuk kupton, nuk ia pret
mendja

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kush ishte Agim Bora?
- Si i konsideronte ai shokët tjerë?
- Për çfarë kujdeseshin e ëma dhe i ati ?
- Pse ishte i shqetësuar djaloshi?
- Ç'i tha gjyshi Gimit kur kuptoi shqetësimin e nipçes?
- Si iu përgjigj nipçea gjyshit?
- Me ç'fjalë gjyshi e këshilloi Agimin?

Të interpretojmë sipas planit:

- Agim Bora - mendjemadh.
- Shqetësimi i djaloshit.
- Biseda e gjyshit me nipçen.
- Këshillimi i gjyshit.

Të lexojmë bukur:

- * Hë, Gimi, nuk po i zgjidh dot detyrat, më duket.
- * Po, gjysh. Janë shumë të vështira!
- * Atëherë shko këshillohu me shokët, more nipçe!
- * Ata janë rrjepacakë!
- * Aha! Kështu do të përfundosh keq, biro!...
- * Lexoni tregimin bukur sipas roleve.

Të zhvillojmë aktivitetet:

Plotëso emrat e mëposhtëm me shkronjat që u përgjigjen:

BA _____ KIM

BE _____ IM

B _____ RIM

SH _____ RESA

V _____ GAN

SH _____

PREM _____ IM

B _____ SA

PE _____ RIT

DRYL _____ N

SEL _____ IE

SHP _____ TIM

- Shkruani në fletore vetëm dialogun ndërmjet gjyshit dhe Agimit.
- Për shembull:
- Hë, Gimi, nuk po i zgjidh dot detyrat. (vazhdo!)

DETYRAT E SHTËPISË NË KAPAK TË FLETORES

Mos të ju vijë si lavde nëse ju them të vërtetën se të gjithë nxënësit e klasës sonë janë shembullorë. Të gjithë përpiqen të mësojnë sa më shumë. I tillë është edhe Agroni, një shok yni shumë i dashur dhe i urtë. E duam dhe e nderojmë të gjithë. Bëjmë çmos që ai të mos ndjej mungesën e babait dhe peshën e varfërisë.

Ai mëson shumë dhe detyrat i bën me pedantëri të madhe. Fletoret e tija janë shumë të pastra. Nuk lë asnjë faqe të zbrazët, sepse nuk ka nga dy fletore për çdo lëndë mësimore. Në një fletore i bën edhe detyrat e klasës edhe ato të shtëpisë. Mirëpo, një ditë fletorja e tij e matematikës iu harxhua, kurse ai nuk kishte ku t'i bënte detyrat e shtëpisë. Ra në hall të madh. Kështu, pasi u mendua një kohë të gjatë, sëç iu kujtua dhe, detyrat vendosi t'i shkruajë në fund të fletores - në kapakun e saj.

Të nesërmen shkoi në shkollë. Mësuesi filloi t'i kontrollojë detyrat. Kështu arriti edhe deri te Agroni.

-Agron, a i ke bërë detyrat?

-Po, mësues, -tha, dhe uli kokën poshtë. Mësuesi e pa se detyrat i kishte bërë, por në kapakun e fletores.

Mësuesit i erdhi shumë rëndë. Ai u ngushtua më shumë se Agroni. Nuk i tha asgjë, vetëm shtiu dorën në xhep dhe hoq kuletën, nxori paratë, i lëshoi mbi bangë, duke e porositur të blejë një fletore.

Agroni mezi i shtiu paratë në xhep. Nga turpi i madh e mbuluan djersët, dhe mendoi: "Edhe një fletore e sigurova, por si do t'ia bëj herave tjera?!"

Jetullah Curri



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

si lavde – si me u lavdëruar
shembullorë – të zellshëm
pedantëri – pastërti, me elegancë
i rryer – me përvojë të pasur jetësore
hoq kuletën – nxori kuletën

Të kuptojmë shprehjet:

peshën e varfërisë – mjerimin
ra në hall – u brengos
uli kokën poshtë – u turpërua
e mbuluan djersët – u sikletos

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Për kë bëhet fjalë në këtë pjesë leximi?
- Çfarë nxënësi është Agroni?
- Cila ishte brenga më e madhe e tij?
- Ç'i ndodhi një ditë dhe si veproi me këtë rast?
- Pse uli kokën poshtë?
- Si e ndjeu veten mësuesja dhe si veproi?
- Më në fund, çfarë tha me vete Agroni ?

Të interpretojmë sipas planit:

- Agroni – shok i mirë.
- Fletorja iu harxhua.
- Mësuesja i kontrollon detyrat.
- Agroni merr paratë i turpëruar.

Të lexojmë bukur:

Lexoni fjalët ku tregohen cilësitë e Agronit, duke veçuar fjalët:
shok i dashur, i urtë, mëson, bën detyrat me pedantëri...

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shkruani në fletore vetëm karakteristikat e Agronit.
- * Çfarë nxënësi është ai. Për shembull:

Agroni është nxënës shembullor.
Agroni..._____

MËSUESI

Mësues Iliri ngrihet herët. Ai shpesh çohet sapo agon dhe del për të shëtitur pak në kopsht; ec ngadalë midis postateve, u merr erë trëndafilave, pastaj shkon më tej, shkullë ndonjë bar të keq në ngastrën e dredhkave.

Ditën e sheh gjithmonë me një grumbull fletoresh përpara. Atij i pëlqen ajo tryezë e vogël mbushur me revista, me libra e me figura për të ilustruar mësimet.

Ky profesion nuk të lodh kurrë,-pëshpëritë shpesh. -Mësues nuk je derisa bëhesh pesëdhjetë vjeç, mësues mbetesh tërë jetën.

Çdo gjë që ngjan rreth tij apo në vende të tjera, ai ua thotë nxënësve të klasës së tij. Dhe sa herë ulet përpara fletoreve, e kujton rrugën e jetës së tij. Ka nxënës që nuk ka parë as lumë, as qytet të madh, as tren , as det, atëherë ai përpiqet t'ua shpjegojë sa më qartë me fjalë e me shembuj.

Mësues Iliri, si rëndom, bën apel për çdo mëngjes dhe pas çdo emri-një fatos, pas çdo fëmije-një familje dhe një copë të atdheut. Ai ngrihet dhe vëren për një çast klasën, pastaj fillon zgjidhjen e një problemi në matematikë. Ndërkohë kalon nga banga në bangë dhe u bën vërejtje nxënësve ose ndihmon herë njërin, herë tjetrin. Atij i pëlqen ajo zhurmë e lehtë që bëhet në klasë kur nxënësit zgjidhin detyrat.

“Puna e mësuesit, -thotë ai, është e veçantë, se s’ka të bëjë me drurin ose me gurin, po me nxënës që kërkojnë të mësojnë a të përgatiten për rrugët e jetës.”

*Punë, punë
natë e ditë,
që të shohim,
pakës dritë.*



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

agon – zbardh dita, gdhin dita
postate – rrip toke që ndodhet midis dy vijave
ngastra – copë toke për mbjellje
profesion – zanat
apel – thirrje

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kujt i kushtohet ky tregim?
- Ç'flitet për mësuesin e këtij tregimi?
- Ku e kalon pjesën më të madhe të kohës mësues Iliri?
- Ç'thotë për profesionin e mësuesit?
- Pse puna e mësuesit duhet nderuar?

Të interpretojmë sipas planit:


- Mësues Iliri në kopsht pranë tryezës (tavolinës).
- Thëniet për profesionin e mësuesisë.
- Puna me nxënësit.
- Dashuria për nxënësit dhe profesionin.

Të lexojmë bukur:

Lexoni tregimin në heshtje, pastaj me zë dhe rrjedhshëm!
Veçoni dhe lexoni fjalitë ku flitet për profesionin e mësuesisë!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shkruani fjali me këto fjalë të fjalorit: agon, apel, përvojë.
- * Për shembull: Dielli po agon.
- * Shkruani në fletore këshillat që zakonisht ua jep mësuesi duke përdorur këto fjalë: detyrë, punë, orar, rregull, kujdes, pastër, sjellje, ndihmë.



VIZATIMET E ANILËS

Ç'bën Anila shtruar-shtruar,
me fletorkë e laps në duar?

Heq ca viza mbi fletore,
ca të drejta, ca harkore;
bën ca njolla bardhezi,
thotë: "Bëra një ari".

Kur me viza fletët mbush,
thotë: "Bëra lepurush".
bën ca pika, ca kuti,
thotë: "Vizatova dhi".

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

fletorkë - fletore e vogël
harkore - të lakuara

Të kuptojmë shprehjet:

shtruar - lirshëm, natyrshëm
nga na mbiu - nga na erdhi

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'bënte Anila në fletorkë?
- Si ishin vizat që i bënte ajo?
- Ç'arë vizatimesh bëri?
- Çka i tha babai?
- Si u përgjigj ajo?

Të interpretojmë sipas planit:

- Anila merr fletoren.
- Ajo bëri një ari.
- Mandej vizatoi një lepurush e një dhi.
- Pyetja e babait.
- Përgjigjja e Anilës.

Detyrë:

- * Mëso vjershën përmendsh! Recitoje me zë!
- * Sipas mbamendjes tënde, bën autodiktimin e vjershës!

Të zhvillojmë aktivitetet: (Bashkëbisedim)

- * Cila nga kafshët e egra të pëlqen më shumë. -Pse?
- * Ç'farë kafshësh të egra ka në rrethinën tënde ku jeton? Shkruaj ato në fletore!
- * Përshkruaje ariun. Thoni ku ndryshon ariu nga ujku!
- * Përshkruaje me fjalë një kafshë të egër pa ia thënë emrin.
- * Le ta gjejmë shokët për cilën kafshë bëhet fjalë!

Pa më thuaj, moj Anilë,
ku i ke se s'i shoh mirë...

Ku i ka veshët ariu?

Po kjo vizë nga na mbiu?

Ku është koka, ku janë sytë?

Ku i kanë këmbët dhitë?...

Thotë Anila e dëshpëruar:

- Pse, o babi, s' ke mësuar?!

Bëhu sa unë, po të shikosh,
do mësosh të vizatosh!

Skënder Haskaj

PËRSHËNDETJA E NGROHTË

Sot i erdhi radha babit të përgatitë senduicin për në shkollë. Në shkollë, në pushimin e gjatë, kur fillova të ha senduicin, ndërmjet thelave të bukës gjeta letrën ku shkruante:

“Eстера e dashur, unë shumë të dua!

Përshtëndetje të ngrohtë ...Babi!”

Orët mësimore më kaluan shumë shpejtë.

Ester Skrivier (Danimarkë)

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

senduic – copë buke e lyer me gjalpë e në mes ka sallamë, djathë etj.
thela - copë të prera të bukës

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kush e kishte radhën të bënte senduic?
- Çka gjeti Eстера ndërmjet thelave të bukës?
- Çka shkruante në letër?
- Si i kaluan Esterës orët mësimore?
- Si u ndje ajo?

Detyrë:

Tento të rikujtohesh: Kur të kanë kaluar orët mësimore shpejt? Pse?

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shkruaje emrin dhe mbiemrin tënd, emrin e prindërve tu dhe anëtarëve tjerë të familjes!
- * Shkruaje emrin e shkollës tënde ku mëson!
- * Zhvilloni gara në klasë:
- * Kush do të gjejë më shumë fjalë me shkronjën M.

Shkruani në fletore dhe numëroni, psh:

mësuesi _____
molla _____
miu _____

-Shkruani në fletore emrat e shoqeve të klasës!

-Shkruani në fletore emrat e shokëve të klasës!

-Vendosni shkronjën që i përgjigjet fjalës! N _____ M _____

	ëshmor		ëshmor
	rindërit		rindërit
N	yshja	M	yshja
	ësuesja		ësuesja
	xënëse		xënëse

DENARI I FATOSIT

Personazhet:

- **Ervini**-fëmijë
- **Bardhi**-shok i tij
- **Fatosi**-shok i tij
- **Caci**-shitës i akullores

(**Shokë e shoqe të Ervinit dhe Fatosit**)

Ervini: (Del në skenë dhe ulet e merr diçka.) O, qenka një denar.
Kush e di kujt i ka rënë...

Caci: (me karrocën e akullores) Akulllore, qumështore! Hajde miciruk e bleni...

Ervini: (me vete) Sikur ta bleja një akulllore... Jo, jo, se kjo para është e tjetërkujt...

Shokët e shoqet të Ervinit: (Hyjnë plot zhurmë duke lëpirë akulllore.) O, Ervin!
Lëpij nga akullorja ime!
-Jo, nga e imja! -Nga e imja!

Bardhi: Pse të lëpijë nga akulloret tona? Ja ku e ka denarin.

Shokët e shoqet: Mirë thotë Bardhi, pse nuk e blen me denarin tënd?

Ervini: Po ky nuk është denari im. Unë atë e gjeta këtu. Dikujt i ka rënë...
dhe duhet t'ia kthej.

Shokët e shoqet: Ashtu?!

Fatosi: (Hyn duke qarë) Ë ë ë ë...

Të gjithë: Pse po qan Fatos?

Fatosi: Më ka humbur një denar.

Ervini: Një denar e gjeta unë këtu...

Fatosi: Po të ketë një njollë në mes është i imi.

Ervini: (mblidhen kokë më kokë dhe e shikojnë) Ja ku qenka pika e zezë.
Merre, se ky është denari yt. (ia jep)


Shokët e shoqet: A do të blesh akulllore tani, o Fatos?

Fatosi: Po, do të blej dy: një për Ervinin e një për vete!

(Blejnë akulllore dhe dalin të gjithë tok të gëzuar e duke lodruar)

Odhise Grillo

GJËJA E GJETUR ËSHTË E HUAJA, PRANDAJ DUHET KTHYER



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

skenë – pjesë e ngritur ku luajnë aktorët
njollë – shenjë
lodruar – lozur
miciruk – fëmijë të vegjël

Të kuptojmë shprehjet:

kokë më kokë – në një vend

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kush janë personazhet e kësaj pjese teatrale?
- Çka gjeti Ervini?
- Ç'bënte Caci me karrocën e akullores?
- Ç'mendonte Ervini me vete kur e gjeti denarin?
- Si u zhvillua biseda ndërmjet shokëve e shoqeve të Ervinit ?
- Si veproi Fatosi në fund të kësaj pjese?

Të interpretojmë sipas planit:

- Ervini gjen denarin.
- Caci shet akullore.
- Shokët e shoqet lëpijnë akullore dhe bisedojnë.
- Biseda e Fatosit me Ervinin.
- Blerja e dy akulloreve.

Punë të pavarur:

Ndani pjesën teatrale në role dhe realizojeni në klasë.
Vizitoni teatrin, shikoni ndonjë dramë dhe bisedoni për të.

Kulturë nga mediumet:

Pjesët e këtylla teatrale quhen dramë. Ajo shkruhet në formë të dialogut që e zhvillojnë personazhet. Këtë e luajnë në skenë apo teatër.
Secili personazh ka rolin e vet. Ka pjesë teatrale për fëmijë dhe për të rritur.

Të zhvillojmë aktivitetet:

* Plotësoni fjalitë:

Ervini bëri një veprim _____ meqë ia
ktheu denarin e gjetur shokut të vet.

Fatosi veproi me _____ pasi

E mira kthehet me _____

AGË YMERI

Agë Ymeri u martua. Bëri dasëm të madhe, por me nusen ndejti vetëm një natë, sepse iu desh të shkojë ushtar.

-Sa kohë do të më presësh, moj nusja ime? -pyeti Agë Ymeri të shoqen.

-Nëntë vjet do të pres, pastaj do të martohem, o im shoq! -Ia ktheu nusja e re.

Pas tri luftash, Agë Ymeri u zu rob. Kalojnë muaj e vite, kurse dita e besës së dhënë po afrohej. Mërzitet shumë e lahutës s'po i bie më. Kërkoi nga e bija e mbretit t'i japë tri ditë leje e të kthehet përsëri. Ajo, pa pyetur të jatin e lëshoi. Ndërkohë mbreti e dënoi të bijën, pasi kishte vepruar kokë në vete.

Agë Ymeri u nis me të shpejtë për në vendlindje. Kur arriti te Kroi i Bardhë, u takua me krushqit e nuses së tij.

-A më lejoni t'i them nuses nja dy fjalë? -pyeti Agë Ymeri- dhe iu afrua pajtonit ku gjendej nusja, pastaj pyeti:

-A e njeh Agë Ymerin?- i tha nuses.

-Agë Ymeri ka vdekur në luftë. Vetëm një natë me të kam ndejtë. E ëma më ka thënë se ka pasë një shenjë në krahun e djathtë -foli nusja.

Agë Ymeri përveshi mëngën e këmishës, ku u duk shenja. Nusja kur e pa këtë, iu hodh në përfaqim dhe u foli krushqve.

-Rruga e mbarë, more krushq, se unë e gjeta fatin e parë!

Pa kaluar tri ditë, Agë Ymeri u kthye në burg përsëri, duke mbajtur fjalën e dhënë, kurse mbreti si shpërblim për besën e mbajtur i tha:

-Të qoftë falë burgu, se ti e mbajte fjalën e shqiptarit -dhe e lëshoi në liri, por edhe të bijës ia fali gabimin.

Kështu, Agë Ymeri u kthye në shtëpi dhe vazhdoi të jetojë i lumtur me nusen e tij, pasi e mbajti premtimin.

(Popullore)

BESA E BURRIT PESHA E GURIT



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

lahutë – vegël muzikore popullore me një tel
mbreti – sundimtar i një vendi
krushqi – njerëzit që shkojnë për të marrë nusen
pajton – karrocë ku hypë nusja
premtimin – fjalën e dhënë

Të kuptojmë shprehjet:

kokë në vete – pa pyetur kënd

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kush është personazhi kryesor i kësaj balade?
- Ç'ndodhi me Agë Ymerin pasi u martua?
- Ç'kërkoji nga bija e mbretit?
- Përshkruaje bisedën e zhvilluar te Kroi i Bardhë!
- Ç'bëri Agë Ymeri pasi u rinjohën me gruan e tij?
- Pse e liroi mbreti Agë Ymerin nga burgun?

Të interpretojmë sipas planit:

- Martesa e Agë Ymerit.
- Zënia rob dhe burgosja.
- Dhënia e lejes nga ana e bijës së mbretit.
- Takimi me të shoqen dhe rinjohja.
- Kthimi në burg dhe falja e dënimit.
- Vazhdimi i jetës së lumtur bashkëshortore.

Të lexojmë bukur:

- * Lexoni tekstin në heshtje, pastaj me zë dhe rrjedhshëm!
- * Gjeni momentin e rinjohjes së Agë Ymerit me nusen!

Vëni re:

Kjo baladë këndohet edhe si këngë folklorike shqiptare ose krahinae. Këto këngë këndohen me vegla muzikore popullore: me lahutë, me kavalle, çifteli, sharki etj.

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shëno me PO këngët popullore (folklorike) shqiptare dhe me JO ato që nuk janë të tilla:

“ Hasan Aga” _____
“Rroka mandolinën” _____
“ Qaj gitarja ime” _____
“ Agë Ymeri” _____
“ Ura e shejtë” _____
“ Muja e Halili” _____
“ Motra me 9-të vëllezër” _____

FLUTURA FJALËBUKURA

A e njihni?
Kjo është Flutura
që përdor
fjalët e bukura.
Zgjohet nga gjumi
lan sytë e zes,
u thotë prindërve:
“Mirëmëngjes!”

Shkon në shkollë
Me dëshirë,
I thotë gjyshes:
“Ditën e mirë!”
Kur gabon flet
me ngadalë:
“Të lutem, mami,
të lutem, më fal!”
Kur e thërret
për ndonjë gjë,
thotë: “Urdhëro!”
e nuk thotë: “Ë”.
Çupë e mirë,
s’ke ç’i thua,
s’e njuh fare
fjalën: “S’dua!”

Tasim Gjokutaj



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

çupë – vajzë, gocë, cucë
s'ke ç'i thua – nuk ka më të mirë

Të kuptojmë shprehjet:

nuk thotë: “Ë” – nuk kundërshton

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kujt i këndon poeti në këtë vjershë?
- Çfarë fjalësh përdor Flutura?
- Si i përshëndet prindërit ajo?
- Po gjyshen si e përshëndet?
- Çfarë fjale përdor kur gabon?
- Çfarë çupe është Flutura, sipas strofës së fundit të vjershës?

Të interpretojmë sipas planit:

- Flutura që përdor fjalë të bukura.
- Përshëndetja me: “Mirëmëngjes!”.
- Ndarja me gjyshen- me “Ditën e mirë!”.
- Përdorimi i fjalës: “Më fal!” dhe “Urdhëro!”.
- Çupë e dëgjueshme.

Të lexojmë bukur:

- * Lexo me kujdes këtë vjershë dhe tregimin “Fjala magjike”
- * Trego se a kanë diçka të përbashkët?
- * Çka kanë?

Detyrë:

- Mësojeni vjershën përmendsh!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Formoni fjalë me rrokjet (që janë të nxjerruna nga vjersha) dhe shkruani ato në fletore.

GJES MËN MI RË _____
MI RË E DI TËN _____
TEM LU TË _____
RO DHË UR _____

DJALI DHE GJARPRI

Një djalë luante me një gjarpër të butë. "Gjarpër i dashur! Nuk do të rrija kurrë me ty, po të mos ta kishin hequr helmin. Ju gjarpërinjtë jeni krijesat më të këqia dhe më mosmirënjohëse. Kam lexuar se çfarë i ka ndodhur një njeriu që e mori dhe e mbajti në gji një gjarpër të ngrirë..."

Sapo erdhi në vete, gjarpri e pickoi dhe njeriu i mirë vdiq i helmuar..."

-Po më çudit! -iu përgjigj gjarpri. -Është kollaj të mbash anën e atij njeriu dhe të shash gjarpurin. Mua më kanë treguar ndryshe... Ai njeriu juaj i mirë mendoi se gjarpri kishte ngrirë me të vërtetë, prandaj e mori me vete për t'ia rrjepur lëkurën. A është e drejtë kjo?!

-Pusho, gjarpër! Ju jeni mosmirënjohës...

-Dëgjo, more bir-ndërhyri babai që e kishte dëgjuar bisedën e tyre, kur diskutonin mirënjohja dhe mosmirënjohja, duhet të dëgjohej të dyja palët.

Nuk është lehtë t'i japësh një njollë të rëndë dikujt që nuk e ka.


Por unë dua të them se bëmirsit e vërtetë nuk flasin për të mirat që bëjnë.

Mosmirënjohësit e përgojnë të vërtetën...

...Djali e lëshoi gjarpurin...

E.G.Lessing

**MOS E FAJËSO DIKË
PA PATUR FAKTE.**



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

krijesa – gjallesa, gjë të gjalla
mosmirënjohës – që nuk ia di për të mirë tjetrit
pickoi – e shpoi, e thumboi
diskutohet – bisedohet, bëhet fjalë fajëson kot, pa të drejtë
mirënjohja – që ia di të mirën tjetrit
njollë – shenjë, leq
bëmirësit – ata që bëjnë mirë
përgojnë – merr nëpër gojë dikë

Të kuptojmë shprehjet:

erdhi në vete – çeli sytë, u zgjua
të mbash anën e atij– e përkrah

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Me kë luante djaloshi?
- Çka i tha djali gjarprit?
- Si u përgjigj gjarpri?
- Kush e dëgjoi bisedën e tyre?
- Ç'i tha babai të birit ?

Të interpretojmë sipas planit:

- Akuza e djalit që ia bën gjarprit.
- Përgjigjja e gjarprit.
- Ndërhyrja e babait.

Punë të pavarur:

- * Në fletoren tënde shkruaj fjalët e babait që ia tha të birit.

Të zhvillojmë aktivitet:

- Gjej kuptimin e kundërt të fjalëve:

të këqia	_____	të mira	_____
mosmirënjohës	_____		_____
i mirë	_____		_____
kollaj	_____		_____
e drejtë	_____		_____
e rëndë	_____		_____
mirëbërës	_____		_____

TOMI DHE XHERI

Maçoku i quajtur Tom, donte t'i jepte mësimin e gjuhës angleze miut të vogël me emrin Xheri. Bëri gati librin e gramatikës, mori një copë djathë, e vendosi kurthin dhe i vuri pranë deriçkës së miut.

Duke pritur aty, filloi të këndonte: "Mi i vogël, eja shpejt, ty anglishtja po të pret!" . Në moment ia pret miu, Xheri:

-Besa, aty s'mund të vij, gjuha më pëlqen por, mësuesi kurrsesi.




MOS E PRANO DHURATËN QË TA JEP ARMIKU



GJËEGJËZË

Ka mustaqe, po s'është burrë,
Ka dhe thonj, po s'i pret kurrë,
Ka lëkurë s'i duhen rroba,
I pëlqen të flej te soba.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

kurthin – grackë; mjet për të zënë minj, zogj etj.
deriçkë – derë e vogël
moment – çast

Të kuptojmë përmbajtjen:

Ç'donte të bënte Tomi?
Çka vuri maçoku pranë deriçkës së miut?
Si filloi të këndonte ai?
Si iu përgjigj Xheri?

Detyrë:

Shikoni ndonjë film vizatimor dhe ritregoni në fletore një epizod nga ai (personazhet dhe përmbajtjen)!
Bisedoni me arsimtarin më gjëresisht për filmin vizatimor në përgjithësi.

Të dijmë edhe këtë:

Tregimi “Tomi dhe Xheri” është marrë nga filmi vizatimor për fëmijë me të njëjtin emër nga autorët: WILIAM HANNA dhe JOSEPH BARBERA”.
Për fëmijë kemi filma vizatimor dhe artistik.

Kulturë nga mediumet:

Filmi është art që paraqet ngjarje dhe veprime të paraqitura nëpërmjet figurave lëvizëse. Simbas përmbajtjes, kemi filma historik, luftarak, kriminalistik etj.
Çdo film artistik krijohet nga një bashkëpunim i ngushtë i skenaristit me aktorët, kostumografin, kompozitorin, regjisorin etj.
SKENARISTI- është ai që shkruan tekstin ose veprën letrare.
AKTORËT - janë artistët që luajnë ose interpretojnë rolet.
SKENOGRAFI- bën dekoret ose zbukurimet nga të cilët bëhet filmi.
KOSTUMOGRAFI- është ai që i zgjedh veshjet e aktorëve.
OPERATORI- përdor kamerën për inqizime të skenave të ndryshme.
KOMPOZITORI- komponon muzikën për përcjelljen e filmit.
REGJISORI-planifikon, organizon dhe e drejton tërë punën.

Të zhvillojmë aktivitetet:

Lidhni fjalët dhe shkruani ato sipas shembullit:

gomari
maçoku
kali
qeni
pula
sorra
trumcaku

→ mjaullon
kakariz
leh
krakëllin
pëllet
cicërrin
hingëllin

maçoku mjaullon

UNË JAM MIUSHI

Rastësisht kuptova se nuk jam miu i vetëm në botë, por kam edhe unë farefis, miun elektronik. Jam shumë i gëzuar dhe mezi pres ta njohtoj. U interesova pak dhe ja se çfarë kuptova:

Me siguri të gjithë keni dëgjuar për kompjutorin. Ai është makinë elektronike për llogaritje, vizatime, për lojra të ndryshme e për të marrë informacione të ndryshme apo për të komunikuar me miqë e shokë përmes internetit dhe për shumë operacione tjera. Gjithsesi ai mund të kryejë edhe shumë punë tjera të ndërlikuara shumë më shpejtë dhe më saktë se njeriu.

Kuptova se ai përbëhet prej shtëpizës, monitorit, tastaturës dhe miut. Prandaj, unë, miushi jam shumë i gëzuar që më në fund bëra një mik të aftë e të mençur, kurse ju fëmijë të dashur mësoni sa më parë të punoni me kompjutor, kështu unë do të bëhem edhe me ju miku më i dashur në botë.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

miu elektronik – miu i kompjutorit
interneti – formën e dhënies dhe marrjes së informatave në kompjutor
të ndërlikuara – të vështira

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'ndodhi me miushin një herë?
- Çka kuptoi ai për kompjutorin?
- Pse u gëzua ai?
- Me kë tjetër miushi do të bëhet mik?

Detyrë:

- Vizitoni kabinetin e informatikës dhe njohtoeni më për së afërmi për kompjutorin dhe funksionin e tij!
- Bisedoni me mesimdhënësin më gjëresisht për rolin e kompjutorit!

Kulturë nga mediumet:

Paraardhësi i kompjutorit të sotëm quhet Abakus dhe më parë njerëzit e kanë shfrytëzuar për t'i numëruar lopët, delet, kuajt... Duket si një llogaritës i vjetëruar për fëmijë. Pra, në qoftë se keni një të tillë në shtëpi, lirisht mund të thoni se keni një kompjutor. Kompjutori i parë ka qenë shumë i madh dhe i rëndë sa që janë dashur katër dhoma për ta vënë në funksion, kurse sot përveç që mund ta vëmë në tavolinë, ka kompjutor sa një çantë dore, të cilin mund ta bartim edhe me vete.

Gjëegjëzë

Është i zgjuar
por s'është njeri,
din më shumë
se unë e ti,
a mund ta gjeni
kush është ai!

k.....i

Fshehtësia

Duarthatë nuk jam
një fshehtësirë e kam,
e ruaj me shumë kujdes
më vonë ta them në vesh.

Më beso ti vogëlush
nuk ma tha askush,
as në rrugë nuk e gjeta,
këtë ma mësoi jeta.

Sikur zogut fluturimin
kroit të ahut gurgullimin,
rrezushës rrugën në lug,
kojrilës drejtimin në jug.

Ta tregoj, mbaje në mend
dhe përcille në çdo vend,
-S'ka më të ëmbël ndër ne-
se dashuria për Atdhe.

Halit Gashi

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

gurgullimin-zhurma që dëgjohet kur rrjedh uji
rrezushës-rrezes së diellit
lug-pjesë e ulët në një livadh, arë apo fushë
kojrilës-shqiponjës

Të kuptojmë shprehjet:

më mësoi jeta-përvoja
kroit të ahut-kroit të ftohtë

Të kuptojmë përmbajtjen:

Çka ruan me kujdes poeti?
Kush ia mësoi fshehtësirën?
Me çka e krahason atë poeti?
Cila është ajo dashuri e fshehtë?

Të interpretojmë sipas planit:

Ruajtja e fshehtësisë.
Drejtimi me fjalë-vogëlushit.
Krahasimi i fshehtësisë.
Zbulimi i saj.

Detyrë:

* Mësojeni vjershën përmendsh.

Të lexojmë bukur:

* Gjeneroni dhe lexoni me kujdes strofën e tretë.
* Rikëndoni edhe njëherë vargun e tretë dhe të katërt të strofes së fundit.

Të shtojm njohuritë:

Vjersha: "Fshehtësira" ka katër strofë. Secila strofë ka nga katër vargje. Puthitja e dy fjalëve në fund të vargut quhet rimë, për shembull, fjala: vogëlush...askush; gjeta...jeta; fluturimin...gurgullimin; lug...jug.

Të zhvillojmë aktivitetet: (Ushtrime gojore)

Të ushtrojmë me rima:

Onomina-donomina; bilbila-kajranfila; hallaqe-budallaqe; burbuqe-faqekuqe; oropajka-taralajka; karolina-mandolina


Vazhdoni të bëni gara se cili prej jush do të gjejë më shumë fjalë të rimuara.

DUAJE ATDHENË, SI SHQIPONJA FOLENË!



FJALË SHPEJTA

Bëni gara njëri me tjetrin duke i përsëritur këto shprehje shpejt e shpejt pa gabim disa here. Kush nuk mund t'i shqiptojë mire, ai del prej lojës.



- Thesi me grun, thesi pa grun.
- E shes thesin, s'e shes thesin.
- Ka derë oda, s'ka derë oda.
- Pyll'i ngratë, n'mal t'thatë.
- Kupa me kapak, kupa pa kapak.
- Len lis era, s'len lis era.
- Ka trap ara, s'ka trap ara.
- Kapuçi n'krye, kryet n'kapuç.

FSHATARI PËRTAC

Një fshatar që s'ia kishte ënda punën, shkoi të shohë vreshtin e tij, të cilin më e kishte mbuluar kullosa dhe tha: “Duheshka me e punuar vreshtin!...” Aty pranë një kaçube kishin qenë të strukura këlyshët e dhelprës dhe dëgjuan fjalët e fshatarit. Kur erdhi nëna e tyre, pyeti të vegjëlit se mos kanë parë dikë afër strofkullës së tyre, kurse ata u përgjigjën të trembur:

-Nënë, të ikim qëkëtej, sepse i zoti i vreshtit qe këtu dhe tha se do ta punojë!...

-Mos kini dert-u përgjigj ajo-se fshatari që keni dëgjuar ju, nuk e ka ndërmend ta bëjë këtë, sepse që sa vjet këtë vreshtë e kam gjetur në këtë gjendje, ihaaaa!...

Pas disa ditësh fshatari përsëri “vizitoi” vreshtin dhe pa se bari edhe më shumë ishte rritur, mandej tha: “Vreshtin e paska mbuluar bari, prandaj i duheshka vërë zjarri!...” -dhe iku.

Kur erdhi dhelpra, të vegjëlit i treguan sërish.

-Të ikim prej këtu! -u tha ajo- sepse përtaci për të punuar nuk punon, kurse për të djegur, besoj, sepse kjo është puna më e lehtë për të.

Dhe ikën me të katra.

Tregim popullor

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

ëndja – dëshira
shkurnajat – kaçubat
kaçubë – shkurre pa trung
strukur – fshehur
strofkull – vend i gërmuar në tokë
ku flejnë kafshët

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku shkoi fshatari?
- Ç’tha ai kur pa vreshtin?
- Ç’menduan këlyshët e dhelprës?
- Si iu përgjigj dhelpra?
- Çka tha fshatari për së dyti?
- Ç’bënë tani dhelpra me të vegjëlit?
- Pse ikën tani?

Të interpretojmë sipas planit:

- Fshatari shkoi në vreshtë.
- Biseda e dhelprës me të vegjëlit.
- Fshatari vizitoi përsëri vreshtin.
- Të vegjëlit i tregojnë rastin e “zjarrit”.
- Ikja nga strofkulla.

Detyrë:

- * Gjej personazhet e tregimit!
- * Lexo përgjigjen e fundit të dhelprës!
- * Mëso dhe ritrego një tregim me ndonjë përmbajtje të këtillë!



DALLËNDYSHJA

Me sqepin gjilpërë,
me bishtin gërshërë,
me krahët e lehtë,
à s'ngjaj si shigjetë?
Nisemi kur vjen vjeshta,
në vendet e nxehta.
Pranverës, me vrap,
në çerdhe vij prapë.
Dhe juve bebushka
të mira, të urta,
të dashurat gjyshe
ju thonë: D a l l ë n d y s h e!

Adelina Mamaqi



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

bebushka – fëmijë të vegjël

Të kuptojmë shprehjet:

me krahë të lehtë - pa ndonjë vështirësi

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Si e përshkruan poeti dallëndyshen në strofën e parë?
- Kur shkojnë dhe kur vijnë dallëndyshet te ne?
- Ku shkojnë ata në dimër?
- Kujt i thuan gjyshet “dallëndyshe”?

Të interpretojmë sipas planit:

- Krahasimi i pjesëve të dallëndyshes.
- Shtegtimi i tyre.
- Krahasimi i bebushes me dallëndyshen.

Të lexojmë bukur:

- * Lexojeni ngadalë vjershën në heshtje .

Detyrë:

- Mësojeni vjershën përmendsh!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Shkruani fjali me fjalët krahasuese sipas modelit:

Dallëndyshja → sqepin _____
→ bishtin _____
→ krahët _____

Dallëndyshja e ka sqepin si gjilpërë

Fjalë e urtë:

SHKO KAH TË SHKOSH,
SI SHTËPIA JOTE
S'KA KURRKUND.

TOPI

Për ditëlindjen e Petritit, shokët i blenë një top të bukur e të larmë. Ai menjëherë i thirri ata dhe dolën në fushë me top. Sa e filluan lojën, erdhi edhe Arditi.

-Oh, sa top i bukur që qenka! I kujt është? – pyeti ai.

-Qëlloje! -tha Petriti.

-I Jetmirit.

-Jo, nuk ia qëlllove.

-I Gencit.

-Nuk është as i tij.

-Atëherë e di, është i yti.

-Nuk është as i imi. Mua ma dhuruan për ditëlindje, por me të luajmë të gjithë, prandaj, topi është i yni. Hyr edhe ti në lojë dhe do të bëhet edhe i yti.

I.D.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

ditëlindje – dita e lindjes së dikujt
qëlloje – gjeje

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kush e kishte ditëlindjen?
- Çka i blenë shokët Petritit për ditëlindje?
- Ku shkuan ata të luajnë?
- Kush erdhi aty më vonë?
- Ç'pyeti Arditi?
- Si u përgjigj më në fund Petriti ?

Të interpretojmë sipas planit:

- Dalja në fushë e fëmijëve për të luajtur.
- Ardhja më vonë e Arditi.
- Biseda ndërmjet Arditi dhe shokëve.
- Hyrja edhe e Arditi në lojë.

Të lexojmë bukur:

- * Lexoni tekstin me zë dhe kini kujdes në shenjën e pikësimit: “ - “
- * Lexoni pjesën sipas roleve!

Të zhvillojmë aktivitet:

- Shkruani në fletore urimet që i përdorim (sipas modelit)

për ditëlindje: _____ Urime ditëlindjen!
për përshëndetje: _____
kur nisemi për në rrugë: _____
për të sëmurin: _____

- Lidhi me shigjetë shprehjet, si në shembullin e dhënë:

Ju faleminderit shumë!
Gëzuar festën!
Mirëdita, urdhëroni!
Gëzuar ditëlindja!
Të dëshiroj çdo të mirë!

të urimit të festës
të shprehurit e falënderimit
të uruarit e ditëlindjes
të shprehurit e dëshirave
pritje e mysafirëve

ÇMIMI I PARË

Sot pasdite është festa e karnevaleve. Kanguri i vogël vështron rreth e rrotull qenushin, mikun e tij. Ka dëshirë ta marrë në festë, por më kot, qenushit nuk i pëlqen.

-Eja me mua,-ngul këmbë kanguri,-do ta jap kostumin më të mirë të karnevalit. Ja një maskë të madhe në kokë edhe gati!

Kanguri shkoi në karneval, zuri vendin e parë dhe fitoi një çokollatë të madhe nga festa. Nga gëzimi i madh filloi të vrapojë për t'i treguar qenushit:

-Qenush, o qenush, të kam sjellë një çokollatë, një çokollatë të madhe nga festa!

-Ti more çmimin e parë?

-Po,-tha kanguri dhe kërkon në xhep,por s'e gjen dot çokollatë.

-Ua, qenush, më paska rënë rrugës duke vrapuar, eja ta kërkojmë!

Duke kërkuar, qenushi e gjeti dhe thirri:

-Kangur,e gjeta një çokollatë...

Pas pak i afrohet kanguri dhe i thotë:

-Ta ndajmë përgjysmë!...

-Jo, kjo është çokollata ime, unë e gjeta.

Aty pari duke kaluar majmuni dëgjoji zënkat dhe u afrua:

-A më pranoni të bëhem arbitër?

-Pooo, -iu përgjigjën kanguri dhe qenushi.

-Atëherë, po e ndajmë në tri pjesë, a pajtoheni?

-Pooo!-thanë ata një zëri.

-Edhe ndonjëherë tjetër, në do të ju duhet arbitër, më kërko-ni.

Tani, mirupafshim!

Fatmira Beqaraj



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

kanguri -gjitar barngrënës nga Australia, që i ka këmbët e prapme më të gjata se të përparmet.
qenush – qen i vogël
kostum – veshje
arbitër – gjyq

Të kuptojmë shprehjet:

festa e karnevaleve - festë ku njerëzit vënë në kokë maska të ndryshme.

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Për çfarë feste përgatitej kanguri?
- Kë dëshironte ta marrë në festë?
- A shkoi qenushi në karneval?
- Çfarë vendi zuri kenguri dhe çka fitoi?
- Ç'i kishte ndodhur atij më vonë?
- Si donte të veprojë qenushi pasi e kishte gjetur çokollatën?
- Si e ndajti drejtësinë majmuni?

Të interpretojmë sipas planit:

- Kanguri fton qenushin në festë.
- Qenushi rri në shtëpi.
- Kanguri zë vendin e parë dhe fiton një çokollatë.
- Rrugës i humb çokollata.
- Dy shokët nuk gjejnë mirëkuptim.
- Majmuni ndan drejtësinë.

Të lexojmë bukur:

- * Veçoni lutjet e kangurit dhe lexoni me zërin e duhur!
- * Lexoni fjalët ku shprehet zënka e tyre!

Të zhvillojmë aktivitetet (Bashkëbisedim):

- Tregoni si visheni ju me rastin e ndonjë feste?
- Sipas teje, kujt do t'i takonte çokollata e gjetur?
- Plotësoni fjalitë: (në fletore për punë të pavarur)
- A ishin miq kanguri dhe qenushi i vogël?

Po, kanguri... _____

A shkoi qenushi në karneval me mikun e tij? _____

Jo, ... _____

Si e ndau majmuni çokollatën? _____

vazhdo vetë _____

Formoni fjali me fjalët:

vizitë, ditë, Shkup, zoologjik, kopsht, luan, tigër, gjirafë, majmunë, kangur

DIMRI

Sikur një piktor i rryer
lule të bukura vizaton në xham,
dhe përjashta po resh bora
sa i gëzuar unë që jam...
Le të resh e le të bien
fjollat radhë-radhë;
le të shtrojë dimri në rrugë
një qilim të bardhë!

I.Q.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

piktor – njeriu që vizaton
i rryer – I stërvitur mirë në një punë
resh – bie borë me furi
qilim – një lloj shtroje

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kush vizaton lule në xham?
- Pse poeti I gëzohet dimrit?
- Çfarë qilimi u duhet fëmijëve për të luajtur në dimër?
- Çfarë loje luan ti në dimër?

Detyrë:

- Përshkruaj gojarisht ndonjë pamje nga dimri (duke u bazuar në fotografi)!
- Mëso vjershën përmendsh!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shkruaj disa fjali sipas modelit:

Bora është e bardhë.

Dimri _____ i ftohtë.

Unë jam i gëzuar.

Ariana është ____ gëzuar.

Andi rrëshqet.

Fëmijët _____

Fëmijët e lagjes bëjnë dordolec.

Andi _____ dordolec.

ZGJOHU HERËT TË TË THONË MIRËMËNGJES

Toli ndiqte klasën e tretë fillore. Mësimet i vijonte pasdite. Ishte një gjumash që nuk e kishte shokun. Edhe kur rastësisht të zgjohej herët, rrotullohej në krahun tjetër dhe nuk i bënte zemra të ngrihej. Sytë i fryheshin si të maçokut e fytyra i buhavitej si petull pazari.

Nga shtëpia dilte aty nga ora njëmbëdhjetë, pa larë as fytyrën dhe përzihej me shokë, që mbasi kishin kryer detyrat, luanin të gëzuar.

-Mirëmëngjes! – u thoshte Toli, por askush nuk ia kthente.

Kështu një ditë, dy, pesë... Kështu përditë dhe Toli habitej pse nuk e përshëndeste kush. Vendosi t'i ankohej të ëmës, që bashkë me të atin ngrihej pa gdhirë e shkonin në punë.

-Përse, o mami, nuk më përshëndet kush, kur unë u them të gjithëve mirëmëngjes?!

-E, si të të përshëndesin, o bir. Ti ngrihesh afër drekës... Çohu herët, Toli i mamit, po dëshiron të të thonë mirëmëngjes.

Bardhyl Xhama



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

gjumash – që fle shumë
rastiste – ndodhte
fryheshin – ajeshin,
pa gdhirë – pa aguar mirë

Të kuptojmë shprehjet:

nuk i bëhej zemra të ngrihej - nuk donte të zgjohet

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Cilën klasë ndiqte Toli?
- Çfarë vetish kishte ai?
- Kur zgjohej në çfarë gjendje dilte nga shtëpia?
- Si i përshëndeste shokët?
- A ia kthente dikush përshëndetjen?
- Si iu ankua Toli të ëmës?
- Si iu përgjigj e ëma?

Të interpretojmë sipas planit:

- Toli gjumash.
- Dalja nga shtëpia – i rregulluar.
- Përshëndetja : “Mirëmëngjes!”.
- Ankimi te e ëma.
- Përgjigjja e së ëmës.

Të lexojmë bukur:

* Gjeni dhe veçoni fjalët ankuese të Tolit, që ia thotë të ëmës, mandej edhe përgjigjen e saj!

Të bisedojmë së bashku:

- Trego ti kur zgjohesh në mëngjes dhe si e kalon kohën deri në drekë?
- Sikur Toli të zgjohej herët, si do t’ia kthenin shokët përshëndetjen?

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Plotësoni tabelën dhe tregoni se çfarë bëni në këtë kohë, mandej shkruani në fletore sipas modelit:

ORA	AKTIVITETI
7-30 Zgjohem nga gjumi	Unë më 7-30 zgjohem nga gjumi.
7-30-8 I laj dhëmbët dhe pastrohem	
I bëj detyrat dhe lexoj	
Luaj me shokët dhe shoqet	
U ndihmoj prindërve	

NORISI NË TELEFON

Para festës së Vitit të Ri, mami i dhuroi Norisit një revole uji. Lodra qe e bukur. Norisi u kënaq duke luajtur. Pastaj mendoi sa mirë do të ishte sikur të vinte aty Doriani dhe të luanin së bashku.

Ai e kishte vënë re gjyshen. Sa herë donte të bisedonte me teta Ritën ose me Dorianin, ajo ngrinte receptorin, pastaj shtypte disa herë tastën me numra. Prandaj edhe Norisi kr-eu të njëjtin veprim.

-Alo? Kush je? -u dëgjua një zë i trashë burri.

-Unë jam Norisi.

-Kë kërkoni, ju lutem? -e pyeti ai.

-Kërkoj Dorianin, -i tha Norisi.

-Këtu nuk ka Dorian! -iu përgjigj rreptë burri. - Ç'numër kërkon?

Norisi s'dinte si të përgjigjet, prandaj e mbylli telefonin.

Ai provoi sërish po gjithmonë i dilnin njerëz të tjerë. Ata i thoshin se kishte gabuar numrin. Norisi vajti te gjyshja dhe iu ankua.

-Gjyshe, pse kur e merr ti telefonin del teta Rita ose Doriani dhe kur e marr unë dalin disa njerëz të tjerë?

Se ti i shtyp numrat e tastës kot më kot, -i tha gjyshja. -Ti akoma nuk i di rregullat. Secila shtëpi ka një numër të veçantë, teta Rita, për shembull, e ka 552-334.

Eja tani të provojmë bashkë?

Me ndihmën e gjyshes, Doriani shtypi numrat që ia tregoi gjyshja dhe pas pak u dëgjua zëri i Dorianit.

-Alo? Kush më kërkon? -pyeti ai.

-Kushëriri yt, -i tha Norisi, -dhe vazhdoi. - Dori, mami më ka blerë një revole uji.

Do të vish të luajmë bashkë? Eja se të pres!

Doriani i tha se po nisej në çast dhe Norisi i gëzuar mbylli telefonin.

N. Prifti

GJËEGJËZË

T i këtu

E motra larg

L ëviz gishtin

E në çast

F are lehtë,

O, si në përralla

N ë skaj të botës

I kën fjala.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

receptorin – kufja e telefonit
tastën – tabela me numra të telefonit
rreptë – i nervozuar

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Çka i dhuroi mami Norisit?
- Ç'donte të bënte ai në telefon?
- Ç'i ndodhi atij, kur tentoi të thirrte Dorianin?
- Kush e mësoi për ta përdorë telefonin si duhet?
- Me kë bisedoi mandej Norisi?

Të interpretojmë sipas planit:

- Nëna i dhuroi Norisit një revole uji.
- Norisi shtypte numrat e telefonit kot më kot.
- Gjyshja e mëson Norisin.
- Bisedimi me Dorianin.

Të lexojmë bukur:

- * Gjeni dhe veçoni bisedimin e Norisit me Dorianin.

Të bisedojmë së bashku:

- Sikur të ishe ti në vend të Norisit, si do të bisedoje me shokun tënd?
- Trego ti ndonjë rast që të ka ndodhur nga pakujdesi në telefon.

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Bëhuni dy grupe në klasë dhe me ndihmën e mësuesit ushtroni bisedime në telefon:
- Si quhet mjeti më bashkëkohor për komunikim (mbahet edhe në xhep) ?
- Trego disa veprime që mund t'i bëjmë me telefonin celular?
- (Shërbehuni me fjalët: bisedë, llogaritje, fotografim, shkruarje e mesazheve, inçizim, lojë).

PSE I DUA BABADIMRAT

I dua Babadimrat, shumë-shumë i dua-
njëri të ngjat ty, e tjetri më ngjet mua.
I dua se fytyrën e kanë gjithë hare,
edhe pse janë pleq, n'ta ka diç të re.
Ka diçka të re, që s'di ta tregoj,
që me ty e mua, është diç njësoj...
I dua Babadimrat, sepse janë të fortë,
i shoh se si enden gjithë nëpër botë.
Në fshatra e qytete-n' shpinë me thes të kuq,
edhe pse të moçëm, kurrë s'i sheh gërmuq!
I dua Babadimrat, se nuk flasin tinëz,
e, kurrnjëfarë të keqe nuk ta bëjnë pas shpinës!
I dua sepse dhëmbët i kanë si të ketrit,
nuk ruhen prej fëmijëve, as prej njëri-tjetrit.
E dua Babadimrin, ngase mirë e di,
se në vitin tjetër, na vjen përsëri!

Agim Deva



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

ngjet – përngjan
hare – gëzim
enden – udhëtojnë gjithkrah
gërmuq – i përkulur

Të kuptojmë shprehjet:

Babadimri–njeri nga përrallat, për të cilin fëmijët mendojnë se natën e Vitit të Ri u sjell dhurata dhe u plotëson dëshirat

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kujt ia kushton poeti këtë vjershë?
- Pse i do Babadimrat?
- Çka bartin Babadimrat në shpinë?
- Kur vjen Babadimri?

Të lexojmë bukur:

Gjeni dhe veçoni fjalët që tregojnë cilësitë e Babadimrave.
(Shembull: Babadimrat fytyrën e kanë gjithë hare)

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Përshkruaje pamjen e jashtme të Babadimrit.
(Fjalë për ndihmë: mjekra, mustaqet, flokët, gëzofi, kësula, çizmet, dorëzat, thesi)
- * Përshkruaji cilësitë e brendshme të Babadimrit.
(Fjalë për ndihmë: I thinjur, zemërmirë, i gëzueshëm, i hareshëm)
- * Shkruaj në fletore tri dhurata që do të doje të t'i dhuronte Babadimri.
- * Shkruaj edhe tri dëshira që do të doje t'i plotësonte Babadimri.

Vëni re:

KALENDARI

Kalendari është ndarja e viti në 12 muaj, 52 javë dhe 365 ditë (366 ditë-në çdo katër vjet).



Dita e parë e vitit është një janari, kurse dita e fundit është tridhjetë e një dhjetori.

LEPURI ME PUSHKË

Gjuetari e hoqi kollanin me fishekë, pastaj pushkën dhe i mbështeti për një lis. Vetë zbriti te burimi të pijë ujë. Lepuri këmbadoras, tinëz ia mori pushkën e fishekët dhe iku në mal.

-Ëhë. Ëhë. Ëhë...Tash e tutje nuk do të ik më, o burra! -tha, dhe i ra pyllit, duke ecur në maja të gishtërinjve, si trim i madh luftime. Rrugës e takoi kaprolli. Kur e pa "trimin" tonë, desh i shpëtoi gazi, por e përmbajti veten.

-Tungjatjeta, o lepur! Nga je nisur me atë pushkë?

-Eheee, o kaproll! Mjaft e ka, tash e tutje nuk ik më lepur!

-Ha-ha-haaa..., -qeshi kaprolli. -Nuk e besoj, o lepur!


-Pse?! A nuk e sheh këtë mauzer? A po nuk ta mbush syrin?

-Po, por mauzeri do edhe zemër!...



Lepurin e hidhëruan këto fjalë të kaprollit. Nuk desh i ta zgjaste më bisedën dhe e vazhdoi udhën. "Budallai. Mauzeri, thotë, do edhe zemër! S'e di i gjori se ky nuk është nga mishi, por nga druri dhe hekuri...".I përdrodi mustaqet edhe njëherë, ashtu si ta hante mendja se dukej një burrë dhe eci kah Lugu i Ymerit. Zogjve u shpërtheu gazi, kur e panë këtë frikacak me mauzer për qafe. Edhat nga humori i lepurit mbanin barkun me dorë, ndërsa dhizat preknin njëri-tjetrin me bërryla. Po lepurit? Lepuri nuk ua varte veshin qeshjeve të tyre. Ai me cilindo trim të krisur që do t'ia zinte udhën, do të ndante mejdanin me mauzer."Do të shkoj te burimi ta shoh veten si më rrinë fishekët dhe mauzeri", tha Lepuri. Kur arriti te burimi, desh plasi nga frika. Oleleee... Te burimi pi ujë ujku! Vrik e vrik hoqi pushkën dhe kollanin me fishekë dhe i hodhi në përrua. Aba-baaam... Ua dha këmbëve përpjetë kodrës. Në majë të malit, tha me vete: "Mirë tha kaprolli, mauzeri do edhe zemër!..."

Abdylazis Islami



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

mauzer – lloj pushke
i gjori – i mjeri
vrik e vrik – shpejtë e shpejtë
ua dha këmbëve- iku vetëtimthi

Të kuptojmë shprehjet:

desh i shpëtoi gazi–sa nuk qeshi
do edhe zemër-kërkon guxim, trimëri
nuk ua varte veshin- nuk i përfillte
do ta ndante mejdanin- do të dilte
në dyluftim

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'bëri lepuri, pasi që gjuetari e hoqi kollanin dhe pushkën?
- Si e ndjeu veten ai tani?
- Çka i tha kaprolli lepurit?
- Ç'bënë zogjt kur e panë lepurin me pushkë në qafë?
- Ç'bëri lepuri kur arriti te burimi?
- Pse iku ai dhe ç'tha me vete?

Të interpretojmë sipas planit:

- Gjuetari dhe pushka.
- Lepuri merr pushkën.
- Takimi me kaprollin.
- Tallja e zogjve me lepurin.
- Lepuri te burimi.
- Ikja e lepurit nga frika e ujkut.

Të lexojmë bukur:

- * Gjeni dhe lexoni fjalët lavdëruese të lepurit.
- * Lexoni tregimin sipas roleve.

Të bisedojmë së bashku:

- * Lepuri dhe kaprolli nuk janë kafshë të rrezikshme. Kë kanë armik të përbashkët ata?
- * Zhvilloni një garë me shokët për emrat e kafshëve që i njihni!

Të zhvillojmë aktivitetet:

Shkruani dhe përgjigjuni pyetjeve me shkrim:

- A ka lepuri brirë?

-A mund të bëhen shok ujku me kaprollin dhe lepurin?

-Shënoni në fletore fjalët e kaprollit që ia tha lepurit.



USHQENI ZOGJËT

Fije-fije kur bie bora,
bën acar e nis të ngrijë,
mirë e mirë vishemi n'rroba...
në shtëpi tash kush të rrijë?

Me vrap shkojmë kërkujmë:
saj e ski - me nxitim;
rreshqasim pa nda,
të ftohtin se ndijm'.

Tërë ditën pa ngrënë fare,
të mërdhirë e të uritur,
vijnë çokasin në dritare
thërrmi buke për të lypur.

Ushqeni zogjtë, o fëmijë!
Që të mos i mund acari;
kur pranvera do të vijë,
të shpërblen me këng' behari.

Halina Pjetрова

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

acar – shumë ftohtë
nxitim – me të shpejtë
të mërdhirë – të ftohur
çokasin – trokasin me sqep

Të kuptojmë shprehjet:

thërrmi buke - copa, grima
të mos i mund acari - të mos i zhdukë
këng' behari- plot gjallëri; që lajmëron
pranverën

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Për cilën stinë këndon poeti në këtë vjershë?
- Si vishen njerëzit kur bën ftohtë?
- Ç'bëjnë fëmijët kur bie borë?
- Ç'bëjnë zogjtë në këtë kohë?
- Ç'e porositë poeti mikun e vogël (në strofën e fundit)?
- Zogjtë, me çka na shpërblejnë të mirën ?

Të interpretojmë sipas planit:

- Bie borë dhe bën acar.
- Vishemi me rroba të trasha.
- A mendojnë fëmijët për zogjtë?
- Porosia dhe këshilla e poetit.

Detyrë:

- * Lexojeni vjershën në heshtje disa herë!
- * Shkruani në fletore strofën e parë dhe të dytë!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Plotësoni me shkrim zërat që lëshojnë këta shpendë:

qikapiku	pik-pik-pik
gjeli	_____
pëllumbi	_____
pata	_____
qyqja	_____
guguçja	_____

GJITHËKA ËSHTË FJALA NËNË

Gjithçka është fjala nënë.
Gjithçka është fjala diell.
Gjithçka është fjala atdhe.
Gjithçka është fjala abetare.
Gjithëka është fjala motër.
Gjithçka është fjala vëlla.
Gjithçka është fjala dashuri.
Gjithçka është fjala Liri.

Gani Xhafolli



Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kujt i këndon poeti në vargjet e para?
- Në cilin varg u këndon anëtarëve tjerë të familjes?
- Çka çmon tjetër më së shumti poeti ?

Të interpretojmë sipas planit:

- Dashuria për familjen.
- Dashuria për atdheun, gjuhën dhe lirinë.

Të lexojmë bukur:

- * Lexojeni vjershën me zë dhe diksion.

Detyrë:

- Mësojeni vjershën përmendsh!

Të zhvillojmë aktivitetet:

Shkruani fjali duke u bazuar në tetë vargjet e vjershës:
“Gjithçka është fjala nënë” (sipas modelit):

Shumë e dashur është fjala nënë ...

Shumë e dashur është fjala _____

Fjalë e urtë:
FJALA NËNË DO TË THOTËS HTËPI.

KU TË LUAJ

Me prindërit banoj në Ulpianë. Afër fontanës. Në katin e pestë të pallatit. Banesa është e ngushtë. Një dhomëshe. Nuk kemi kah të sillemi!

Babi s'ka ku t'i vë librat. E, ai ka shumë libra, shumë! Është shkrimtar.

As unë që jam i vogël s'kam ku t'i lë lodrat! Babi kur zemërohet thotë:

-Kësaj s'i thonë banesë! Kafezi thonë! Kafez!

Edhe mami thotë kështu. Kështu them edhe unë, sepse s'kam ku të luaj!

Një ditë babi më solli një top. Sa nuk fluturova nga gëzimi. E putha në të dy faqet, ncëk e ncëk! E, topin? -do të pyesni ju. Kuptohet, fillova lojën menjëherë...

-A je në vete, bir?-më qortoi mami.

Marr topin dhe dal në kuzhinë. Sapo bëhem gati të luaj, sërish mami.

-Kuzhina s'është fushëlojë! Mos ta shoh më atë top – më kërcënohet.

Bëhem lepur. Ik në ballkon bashkë me topin. E hudh në faqe të murit një herë, dy herë... Mami vjen si për inat.

-Shporru që këtej! Do t'i thyesh lulet, limonin...

Nuk bëzaj. Me topin nën sjetull vrapoj shkallëve. Te fontana . E shqelmoj topin me sa fuqi që kam. Ai drejt e në lulishtë, ku kanë çelur trëndafilat nga më të bukurat. Në skaj të kopshtit-roja me mustaqe. Ma tund gishtin me kërcënim.

Ku të shkoj?

Ku të luaj?

Kthehem në dhomë i zemëruar. Lëshoj televizorin. Bashkë me topin shikojmë filmin vizatimor.

Nuk e di pse babi nuk e ka ndërtuar një shtëpi në Breg të Diellit. Atje do të kishte vend edhe për lojën time.

A ndërtohet shtëpia me vjersha?!...



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

pallati – ndërtesë shumëkatëshe

kuzhinë – dhomë për përgatitjen e ushqimit
kafez- (këtu) shumë ngushtë, mbyllur
fushëlojë – fushë sporti
kërcënohet - kanoset

Të kuptojmë shprehjet:

Ulpianë – lagje në Prishtinë
nuk bëzaj- heshti
Breg të Diellit- edhe kjo: lagje në Prishtinë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku banon vogëlushi i tregimit?
- Si është banesa ku banon ai me prindërit?
- Çka i solli babi një ditë të birit?
- Ku luante me top?
- Kush e qortonte vogëlushin dhe pse?
- Ç'bënte ai më në fund?
- Ç'dëshironte ky fëmijë?

Të interpretojmë sipas planit:


- Vendi dhe kushtet e banimit.
- Topi dhe luajtja me të.
- Me top – në kuzhinë.
- Me top – në ballkon.
- Me top – te fontana.
- Kthimi në dhomë.

Të lexojmë bukur:

- * Lexoni fjalitë ku shprehet zemërimi i vogëlushit për shkak të banesës së vogël.
- * Lexoni fjalitë ku tregohet gëzimi i djaloshit, kur babi i solli një top.

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Shkruani fjalinë pyetëse: “A ndërtohet shtëpia me vjersha?” dhe përgjigjuni ç’do të thotë vogëlushi me këtë: Në shoqëri nuk çmohet puna e shkrimtarit.
- Nuk ka levërdi ekonomike me profesionin e shkrimtarit.



MUAJT E MOTMOTIT

Ishin grindur dymbëdhjetë muajt e motmotit.

Tre muajt e pranverës i thanë verës:

-Po s'qemë ne t'i mbijmë bimët, t'i nxjerrim nga toka, çfarë kishe bërë ti verë?

-Vera u thotë:

Ju e mbini bimën nga toka, por po nuk qemë ne muajt e verës, ta rrisim, ti pranverë, ç'do të bëje?

Vjeshta e mori fjalën dhe tha:

-Mos u grindni mes veti: ti pranverë e mbinë bimën, ti tjetra e rrit, kurse unë e mbledh dhe e bëj grumbull!

Tre muajt e dimrit thanë:

-Përse fjaloseni ju tri stinët?

Ti pranverë e mbinë bimën, ti verë e rrit, ti vjeshtë e grumbullon frutin.

Doni të thoni se gjithë

këtë punë që bëni ju, unë e ha gati, ë?!

Jo, moj, jo, pa e siguruar unë ujin, s'bëhet gjë.


Muajt e dimrit dolën që të hanë ushqimin.

Adem Abdullahu



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

grindur – zihen në mes vedi
motmotit – vitit
fjaloseni – ziheni me fjalë
frutin – kokrrën



Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'kishte ngjarë me dymbëdhjetë muajt e motmotit?
- Ç'thanë tre muajt e pranverës?
- Çka u tha vera?
- Kur e mori fjalën vjeshta çka tha?
- Po si u arsyetuan tre muajt e dimrit?

Të interpretojmë sipas planit:

- Grindja e dymbëdhjetë muajve të vitit.
- Fjalët mburrëse të pranverës.
- Shprehjet e tre muajve të verës.
- Lavdërimi i tre muajve të vjeshtës.
- Fjalët përmbyllëse të stinës së dimrit.

Të lexojmë bukur:

- * Lexoni fjalët lavdëruese të muajve të pranverës!
- * Lexoni edhe fjalët që thonë muajt e dimrit!
- * Zgjidhni pjesën e tregimit që ju pëlqen më tepër dhe më pas lexojeni
- * pjesën sipas roleve.

Të bisedojmë së bashku:

- Cila stinë ju pëlqen më tepër? Pse?
- Bisedoni me njëri-tjetrin për karakteristikat e çdo stine!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Nënvizoni të saktën dhe shkruani (sipas modelit):

1. Zogjtë shtegtarë vijnë në pranverë, verë, vjeshtë, dimër.

Zogjtë shtegtarë vijnë në pranverë.

2. Fëmijët rrëshqasin në pranverë, verë, vjeshtë, dimër.


3. Fëmijët lahen në lumë në pranverë, verë, vjeshtë, dimër.

4. Rrushi piqet në pranverë, verë, vjeshtë, dimër.

DHE JU PUNËT MOS I NDANI

Unë dhe motra në shtëpi
punët kurrë nuk i ndajmë,
bashkë krevatin rregullojmë
edhe enët bashkë i lajmë.
Un' me fshesë fshi shtëpinë,
motra me leckë e pastron,
dhe kur unë lyej këpucët,
ajo mamit i ndihmon.
Dhe ju punët mos i ndani:
“Kjo për djal’ e kjo për çupë”,
se çdo punë, o fëmijë
është nder e nuk është turp!

Xhevat Gega



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

krevat - shtrat
fshesë - fshisë

Të kuptojmë shprehjet:

nuk i ndajmë – nuk bëjmë dallim

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kujt i këndon poeti në këtë vjershë?
- Si i bëjnë punët e shtëpisë vëllau dhe motra sipas kësaj vjershe?
- Cilat punë i bëjnë bashkë?
- Çfarë porosie japin ata (sipas strofës së tretë)?

Të interpretojmë sipas planit:

- Rregullimi i shtëpisë.
- Fshirja, pastrimi dhe lyerja e këpucëve.
- Porosia për punën.

Të lexojmë bukur:

* Lexojeni vjershën rrjedhshëm me zë duke respektuar shenjat e pikësimit!

Detyrë:

- Mësojeni vjershën përmendsh!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Përmend disa punë që i bën ti në shtëpi (duke përdorur fjalët: rregulloj, laj, fshi, pastroj, lyej) dhe shkruani sipas shembullit të dhënë.

1. Unë për çdo ditë rregulloj krevatin.

2. _____

3. _____

4. _____

PASTRUESI I RI

Në kopshtin zoologjik erdhi një pastrues i ri. Ai quhej Isë. Rojtari i kopshtit zoologjik, Martini, ia tregoi kafshët dhe i rrëfeu se si duhet të kujdeset për to, sa ushqim duhet t'u japë dhe kur duhet t'i ushqejë.

Isa veshi uniformën e punës dhe filloi që me papërgjegjësi ta kryejë detyrën e tij në kopshtin zoologjik.


Kështu, ai nuk u la përshtypje të mirë as kafshëve e as rojtarit. Ai i dukej Martinit sikur nuk dëshiron që ta kryejë detyrën, por çka mund të bënte ai në këtë rast, sepse edhe ai ishte vetëm një rojtar i thjeshtë.

Në mbrëmje Isa nuk i ushqeu kafshët, sepse iku më herët, andaj këtë e bëri Martini. Të nesërmen uji te elefantët nuk ishte i pastër, ndërkaj Isa në punë erdhi pak para dreke, ngase e kishte zërë gjumi. Luanët ishin të ndyrë me rërë, zebat kishin mbetur të uritura, ndërkaj tigrat ishin sëmurë. Megjithatë, drejtoresha nuk e vërente këtë, ngase ishte shumë e zënë me punën e saj në zyrë.

Martini shkoi në zyrën e saj dhe ia rrëfeu të gjitha. Drejtoresha dëshironte që ta përjashtojë nga puna pastruesin, por Martini e luti që t'ia japë edhe një mundësi me kusht që ta përmirësojë gabimin e tij.

Isa u pendua dhe premtoi se tash e tutje do të jetë i përgjegjshëm për kafshët në kopshtin zoologjik.

● E keqja, sado e vogël të jetë, duhet të luftohet ●



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

kopshti zoologjik – vendi ku ruhen kafshët e egra
uniformë– veshje e njëjtë për njerëzit që bëjnë po atë punë a shërbim
papërgjegjësi – pa kujdes, pa përkushtim
të ndyrë– të përlyer, të ndotur
të uritur – që nuk ka ngrënë
u pendua– i erdhi keq për atë që bëri
i përgjegjshëm – i kujdesshëm, i përkushtuar

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kush erdhi në kopshtin zoologjik për të punuar?
- Çka i tregoi Martini pastruesit të ri?
- A ishte i kujdesshëm Isa në punën e tij?
- Çfarë bëri Martini kur pa se Isa nuk u tregua i përgjegjshëm?
- Ç'ndodhi me Isën pasi ia fali gabimin drejtoresha e kopshtit ?

Të interpretojmë sipas planit:

- Në kopshtin zoologjik vjen një pastrues i ri.
- Në vendin e ri të punës papërgjegjësi.
- Martini lajmëron drejtoreshën për veprimet e Isës.
- Isa pendohet dhe premtun për përgjegjshmëri.

Bashkëbisedim:

- Çfarë punëtori ishte Isa?
- Trego disa veti të njeriut të papërgjegjshëm.
- Trego disa veti të njeriut të përgjegjshëm.
- A veproi mirë Martini që e zbuloi rastin?
- Ç'do të bëhej sikur Martini të mos e paraqiste rastin te drejtoresha?

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shkruani në fletore punët e pakujdesshme të Isës dhe pasojat e veprimit me papërgjegjësi , duke përdorur fjalët: elefantët, luanët, zebat, tigra.
- * Bëhuni dy grupe dhe shënoni në tabelë veprimet e papërgjegjshme të Isës, kurse në anën tjetër shkruani veprimet e kundërta me ato të parët, duke përdorur fjalët: i pakujdesshëm, dembel, gjumash, i bishtëron punës, bën punën shkel e shko.

(Shembull)

Veprimet e papërgjegjshme	Veprimet e përgjegjshme
1.1 pakujdesshëm	1.1 kujdesshëm

FJALËT MAGJIKE

Vjollca është një çupë e vogël, për atë gjyshja e mësoi:

-Patjetër t'i mësosh fjalët magjike!

-Pse, a thua ekzistokan fjalë të tilla?!

-Posi!...Ato janë: Ju lutem; Faleminderit; Urdhëroni; Më falni...

Çdo njëra nga këto fjalë është magjike.

-Faleminderit, gjyshe që më mësove!

Gjyshja i buzëqeshi. Vjollca e mësoi fjalën e parë magjike, por nuk e hetoi.

Nexhati Zekirija

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

çupë – vajzë e vogël

fjalë magjike – shprehje figurative; që ka fuqi të madhe apo ndikim mbi diçka

hetoi – diktoi

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Çka i tha gjyshja Vjollcës?
- Cilat janë fjalët magjike ?
- Pse buzëqeshi gjyshja kur Vjollca e falënderoi?

Të zhvillojmë aktivitetet: (Bashkëbisedim)

- Trego disa fjali në të cilat do të përdorësh një fjalë magjike!
(Të njëjtat fjali mandej shënoi në fletore)
- Me ndihmën e arsimitarit apo të prindit, sqaro shprehjet:
"Mjalt i rridhte nga goja" dhe "Një fjalë, një lirë"!
- Kur dhe ku i përdor fjalët magjike?
- Lidhi fjalët sipas shembullit dhe shkruaj në fletore.

Mirëmëngjes
Mirëdita
Mirëmbrëma
Ditën e mirë
Mirupafshim
Faleminderit
Lamtumirë
Natën e mirë
Lamtumirë themi

kur takohemi me dikë në kohën e mbrëmjes
kur takohemi me dikë në kohën e mëngjesit
kur ndahemi e nuk shihemi gjatë kohë
kur takohemi me të tjerët gjatë ditës
kur i shprehim mirënjohje dikujt për diçka
kur ndahemi nga shokët gjatë ditës
kur ndahemi nga shokët në kohën e mbrëmjes
kur ndahemi nga të tjerët për një kohë të gjatë
kur ndahemi e nuk shihemi gjatë kohë.



MOSMIRËNJOHËSET

Në oborrin e një shtëpie, mu pranë



të



, vogëlushët

kishin bërë një



të bukur. Ai i ngjante plotësisht gjahtarit,

sepse në supe i kishin varur një pushkë druri.

Në orët e vona të natës, kur



ishte i vetmuar dhe



kishin rënë

në gjum të thellë,



dinake dhe e uritur iu afrua



që t'i sulmonte



, por kur e pa



, pandehu se është gjahtar

dhe ia mbathi.

Të nesërmen



u rrëfeu se çfarë kishte ndodhur gjatë

natës.



fare nuk e besuan:

-Yhyyy!... një njeri prej



na paska shpëtuar prej



, çfarë

marrie, çfarë gënjeshtre e madhe!



I pikëlluar, pak prej ofendimit, pak prej rrezeve të ngrohta të diellit

u shkri dhe u tret fare nga faqja e dheut.

Në mbrëmje,



përsëri erdhi dhe kur pa se s'ishte



, ajo i

sulmoi



. Të gjorat e pësuan sepse s'ishim mirënjohëse.



koteci



dordoleci



pulat



dhelpra

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

kotec –shtëpizë e vogël për shpezë
 dordolec–figurë e bërë me borë
 pandehu– ashtu iu duk
 ofendimit–fyerjes

Të kuptojmë shprehjet:

ia mbathi- iku

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'kishin bërë fëmijët pranë kotecit të pulave?
- Kush iu afrua kotecit të pulave në orët e vona?
- Ç'deshi të bënte dhelpra dinake?
- Ç'pandehu dhelpra kur e pa dordolecin?
- Si e tallën pulat atë?
- Ç'ndodhi natën e dytë kur erdhi dhelpra?

Të interpretojmë sipas planit:

- Vogëlushët bëjnë një dordolec.
- Dhelpra vjen te koteci i pulave.
- Frika e dhelprës nga dordoleci.
- Biseda e dordolecit me pulat.
- Ardhja e dhelprës përsëri.
- Pësimi i pulave.

Të lexojmë bukur:

* Gjej dhe lexo fjalët ofenduese të pulave!

Bisedë:

- Pse e pësuan pulat nga dhelpra?



MARSI SJELL SHUMË GJËRA

Keni menduar ndonjëherë më gjatë për marsin, të dashur nxënës? Keni gjetur gjë të rëndësishme apo interesante këtë muaj? Me siguri, po.

Po, si nuk paska!?

Marsi, për shembull, është muaj i dy stinëve: i dimrit dhe i pranverës. Pra në mars përfundon dimri dhe po në mars fillon pranvera. Zbutet moti. Zgjatet dita. Rrezet e diellit bëhen më të ngrohta. Nis të ngjallet natyra. Paraqiten lulet e para.

Pastaj na vjen 7 Marsi, Dita e Mësuesit të dashur. Është dita kur u hap shkolla e parë shqipe në Korçën e bukur më 7 Mars 1887 nga drejtuesi Pandeli Sotiri.

8 Marsin e duan, sepse është festa e nënave tona shumë të dashura. Kjo festë kremtohet në mbarë botën. Në këtë rast të gjithë fëmijët u dhurojnë lule nënave, mësueseve, me plot përqafime e buzëqeshje të ngrohta.

Më 21 Mars është ditëlindja e pranverës. Në mars organizohen shëtitjet e para të nxënësve në natyrë. Në mars ka ditëlindjen një shok i imi, i iyti, i atij, i yni, një shoqe e jona e dashur Marsiana, një Marslinda, një Pranvera, një Lule, pastaj një Lulëzim, një Gëzim etj...

Lulëzimi i dhuroi Lules një lule vjollce të posahapur.

Në muajin mars është edhe një festë tjetër shumë e bukur.

Ajo është Dita e Pranverës -21 Marsi. Dita kur fillon të zgjohet natyra, të blerojnë malet, fushat; të lulëzojnë pemët, të fluturojnë bletët dhe fluturat; të kthehen dallëndyshet, lejlekët, bilbilat...

Pra, kjo është dita kur fillon stina më e bukur e vitit.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

kremtohet – festohet
u dhurohet – u japin, u falin
blerojnë – jeshilohen, gjelbërohen

Të kuptojmë shprehjet:

zgjohet natyra – blerohet

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Cilat janë festat e muajit mars?
- Pse e duam 7 Marsin?
- Çfarë feste është 8 Marsi?
- Në cilën datë është Dita e Pranverës?

Për punë të pavarur:

- Shkruani sipas shembullit:
- 7 Marsi është Dita e _____
- 8 Marsi është Dita e _____
- 21 Marsi është Dita e _____

Vendosni shkronjën që duhet dhe formoni fjalën:

l	jala	fjala
t	xënësi	_____
d	ulja	_____
n	ësuesja	_____
k	regim	_____
f	arsi	_____
m	rita	_____

Të zhvillojmë aktivitetet:

* Shkruaj muajt e vitit dhe shëno festat që kremtohen në këto muaj:

janar - 1 Janari-Viti i Ri _____


mars

maj

nëntor

GËZIMI I PRANVERËS

Dega e bredhit prej dëborës
sa është çliruar,
bari fushës në kodrina,
gjumit është zgjuar.
Vjollca sytë e kaltër hap,
uli zërin era,
udhën larg e nisën retë,
ka ardhur pranvera.
I shkundi krahët gushëkuqi,
e lë vetëm ferrën,
me gëzim këndon në gardh,
këngë për pranverën.
Ketri, që dimrit ka qenë strukur,
thotë: “Sa paskam fjetur!”,
Ç’i gëzohet ai diellit
mbi degëzën mbështetur.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

gushëkuqi – zog i vogël me gushë të kuqe
ketri –gjitarr me trup të vogël e të shkathët, të mbuluar me qime të murme me bishtë të gjatë si të dhelpres.

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Pse vjersha titullohet: “Gëzimi i pranverës”?
- Si e përshkruan poeti ardhjen e pranverës në strofën e parë?
- Kush gëzon për ardhjen e pranverës? Lexojeni në tekst!

Të zhvillojmë aktivitet: (Bashkëbisedim)

- * Lexojeni vjershën bukur.
- * Bashkë me mësuesin apo mësuesen flisni për pranverën dhe bukuritë e natyrës në këtë stinë.
- * Shikoni me kujdes fotografitë e këtyre luleve dhe shkruani emrat e tyre duke u bazuar në shkronjat e dhëna.
- * (Fjalë për ndihmë: lule vjollca, lulebora, lule lale, zymbili,)



ÇERDHJA


Një çupëz e vogël filloi të krihte flokët pranë dritares që rrinte hapur. Nga dikah fluturoi një dallëndyshe...

Çupëza nuk dinte ç'ti jepte, por vetëm shkuli një fije floku nga koka dhe ia dha dallëndyshes.

Ajo e mori këtë dhe e përdori për ndërtimin e çerdhes së vet. Gjithçka mund të përdoret kur diçka dhurohet me gjithë zemër.



G.Ugolin



Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku u ndal çupëza?
- Çka filloi të bënte ajo pranë dritares së hapur?
- Kush fluturoi në dritare?
- Çka i dha çupëza dallëndyshes?
- Për çka e përdori dallëndyshea fijen e flokut?
- Trego porosinë e fundit të tregimit!

Të interpretojmë sipas planit:

- Çupëza pranë dritares.
- Ajo shkuli një fije floku nga koka.
- Dallëndyshea përdori fijen e flokut për çerdhen e vet.
- Porosia e tregimit.

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Ky tregim është i shkurtër, por në të gjejmë disa etapa.
- * Ritrego tregimin duke patur kujdes:
 - për cilën stinë bëhet fjalë (kur zogjtë fillojnë të ndërtojnë çerdhe);
 - çfarë përshtypjesh fitoni për çupëzën (e rregulluar, shpirtmirë);
 - një gjë që për dikë është pak, për dikë tjetër është shumë (sa e rëndësishme është fija e flokut për çupëzën, e sa për dallëndyshen);
 - çfarë porosie sjell ky tregim?

MIRËSIA


Fëmijë të dashur! Si më i rritur që jam, dëgjoni disa këshilla të mira që do t'u jap dhe t'i mbani mend përgjithmonë:

Po të takoni ndonjë të verbër në rrugë, kaloni pranë tij dhe përshëndetnie: "Mirëdita!" Kët fjalë ai gjatë kohë do t'i përsëritë me vete si një melodi shumë të bukur dhe do t'i duket se vjen nga kaltëria e qiellit.

Kur do të takoni ndonjë invalid, merrnie atë për dore, shtrëngonie fort dorën e shëndoshë dhe mbanie sa më gjatë që është e mundur. Ai do të besojë se edhe dora tjetër i rritet.

Kur do të takoni memecin, buzëqeshni me të me ngrohtësi. Ai do të ndiejë veten se fjalët nuk u duhen njerëzve.

Cane Andreevski



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

i verbër – njeriu që nuk sheh
invalid - njeri që ka ndonjë të metë fizike
mamec - njeriu që nuk mund të folë

Të kuptojmë shprehjet:

fjalët nuk u duhen njerëzve -
njerëzit kanë nevojë edhe përbuzëqeshje

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Pse shkrimtari këshillon që ta përshëndesni të verbërin me “Mirëdita”?
- Si duhet të veproni me invalidin?
- Çka do të besojmë memeci, po t’i falni një buzëqeshje të ngrohtë?

Të interpretojmë sipas planit:

- Dhënia e këshillave të mira.
- Takimi me të verbërin dhe përshëndetja “Mirëdita!”.
- Takimi me invalidin dhe shtërngimi i duarve.
- Takimi me memecin dhe të buzëqeshurit me të.
- Porosia e fundit e tregimit: “ Njerëzve u duhen buzëqeshjet”.

Të zhvillojmë aktivitet:

* Ky tregim është i shkurtër, dhe është me porosi edukative.
(Duke përdorur fjalët: respektim, nderim, mirësjellje, gjeni tre porositë dhe shkruani ato në shembullin e dhënë).

1. Të respektojmë të verbërit.

2. _____

3. _____

Çfarë porosie sjell tregimi?

ZHURDENI DHE MËSUESI

Zhurdeni, burrë i thjeshtë, që u bë i pasur me tregti, ka dëshirë të bëhet i ditur dhe i njerëzishëm që të mund të shoqërohet me njerëz të mëdhenj. Duke paguar shumë të holla, mori një mësues dhe nisi të mësonte në pleqëri. Ai mezi dinte të shkruante, prandaj luti mësuesin që t'i ndihmonte në hartimin e një letre. Ja biseda e tyre:

Mësuesi: A doni ta shkruani atë letër në vargje?

Zhurdeni: Jo, jo! Në asnjë mënyrë në vargje.

Mësuesi: Doni, pra në prozë ?

Zhurdeni: Jo! S'dua as në prozë as në vargje.

Mësuesi: Por, ju lutem, duhet të zgjidhni medoemos njërën ose tjetrën formë.

Zhurdeni: Pse?

Mësuesi: Sepse, zotëri, kemi vetëm dy forma, me të cilat njeriu i shpreh mendimet e veta: në prozë dhe në vargje.

Zhurdeni: Qysh qenka vetëm proza dhe vargu?

Mësuesi: Ta merr mendja, zotëri, çdo gjë që nuk është në vargje është në prozë.

Zhurdeni: Pra, ç'është ajo atëherë kur njerëzit flasin njëri me tjetrin?

Mësuesi: Prozë.

Zhurdeni: Si? Kur them: "Nikolinë, sillmi papuçet dhe jepma kësulën e natës" -është prozë?

Mësuesi: Po, zotëri.

Zhurdeni: O, zotëri mësues! Dyzet vjet që flas në prozë e kurrjë nuk di për të! Të falënderit shumë që ma mësuat këtë.

Zhan B. Molier



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

i thjeshtë – i rëndomtë
tregti – shitblerje
i njerëzishëm – i mirë
hartimin – punimin
vargje – rresht i shkurtë fjalësh, e shkruar në formë të lirë
prozë – rresht i gjatë fjalësh e shkruar në formë të radhëve

Të kuptojmë shprehjet:

njerëz të mëdhenj – të ditur
ta merr mendja – kuptohet

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Cilët janë personazhët e paraqitur në këtë tekst?
- Çfarë njeriu është Zhurdeni?
- Ç'dëshironte të bënte ai?
- Ç'bënë ai për të arritur këtë qëllim?
- Çka i propozoi mësuesi për hartimin e letrës?
- Pse nuk pajtohej Zhurdeni ta shkruanin atë letër, as në vargje, as në prozë?

Të interpretojmë sipas planit:

- Cilësitë dhe dëshirat e Zhurdenit.
- Biseda me mësuesin.
- Proza dhe vargu.
- Shembulli me Nikolinën.
- Të kuptuarit e fjalëve: “prozë” dhe “varg”.

Të lexojmë bukur:

- * Lexoni me zë vetëm dialogun e zhvilluar ndërmjet mësuesit dhe Zhurdenit.

Detyrë

- Mësojeni tekstin në role dhe luajeni në klasë

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Gjeni fjalët që janë të ngjajshme dhe shkruaj sipas shembullit:

i thjeshtë qejf i thjeshtë-i zakonshëm

i pasur shitblerës _____

dëshirë i zakonshëm _____


i ditur i mirë _____

tregtar pasanik _____

i njerëzishëm i mençur _____

Të shtojmë njohuritë

- * Bisedën e zhvilluar ndërmjet dy ose më shumë personazheve e quajmë dialog. Mendimet tona mund t'i shkruajmë në prozë dhe në vargje.



TI, OJ FLUTUR

Ç'më pehatesh përmbi bar,
përmbi bar e përmbi lule?
Hidhke valle të paparë.
Ç'më pehatesh përmbi bar?
E puthë vesën-lot të larë,
kokën andej e përkule.
Ç'më pehatesh përmbi bar,
përmbi bar e përmbi lule?
Përshëndete lulen qumështore,
trëndafilin dhe zambakun.
Rendja jote-valle prore,
përshëndete lulen qumështore.
Ti rend e rend drejt kaltërsisë,
zë shoqëri me atë puhi.
Me hovin tim të fëmisë,
do e thur një këngë për ty.



Zymer Elshani



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

pehatesh - fluturon
vesën - lëngun
përkule - ule,
zambak - lule
rend – nxiton
puhi – fllad

Të kuptojmë shprehjet:

valle të paparë - valle e bukur
lulen qumështore - një lloj luleje
e lakuar si hark
ktheve lot të larë - të lagur
përshëndete lulen - iu qase, iu afrove
zë shoqëri - shoqërohet
me hovin tim – me mundësinë time

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kujt i këndon poeti në këtë poezi?
- Ku hedh vallen flutura?
- Ku rend ajo?
- Me kë zë shoqëri?
- Në ç'mënyrë do ta shpreh dashurinë vogëlushi për fluturën e bukur?

Të interpretojmë sipas planit:

- Pehatja e fluturës mbi bar.
- Përshëndetja me lulet.
- Rendje drejt kaltërtisë.
- Thurja e këngës.

Të lexojmë bukur:

* Lexojeni rrjedhshëm vjershën në tërësi duke respektuar shenjat e pikësimit!

Detyrë:

- Mësojeni vjershën përmendsh!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Formoni fjalë me shkronjat e dhëna.
(Fjalët janë të nxjerrura nga poezia)

U R A F U L T _____

B A M A Z U K _____

N Ë R T A D I L I F _____

ASHENSORI

Hip e zbrit në ashensor,
kolovitemi me orë.

Del një gjysh te shkalla jonë,
na bërtet e na qorton:

-Ç'bëni ju, o kalamaj?

Ashensori s'është tramvaj!

Do të prishet ashensori

lumi t'gjithëve ne na mori,
gjyshi s'ngjitet dot gjashtë kat,
s'i punon këmba e ngratë!

Ashensori, ashensori

neve mendjen na e mori...

Po një ditë përtej takatit,

ne na la në mes të katit!

Erdh tekniku e tri orë

derdhi djersë në ashensor.

Ne si robër na çliruan,

na shpotitën, na qortuan.

Tani qesh me ne çdo plakë

se u bëmë qesharakë!



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

ashensori – mjet i mekanizuar që shërben për të ngritur e për të zbritur njeëz e sende kolovitemi – nuk rrimë në një vend tramvaj – tren elektrik, që ec nëpër binar. tekniku – mjeshtri për ndreqjen e ashensorit na shpotitën – na tallën, na qeshën me ironi

Të kuptojmë përmbajtjen:

Si sillen këta kalamaj të vjershës me ashensorin?
Kush i qorton ata? Pse?
Ç'u ndodhi një ditë kalamajve çapkënë?
Kush e ndreqi ashensorin?
Pse i qeshnin kalamajtë e pakujdesshëm?

Bisedë:

Thoni mendimin tuaj për veprimin e kalamajve. Ju si do të vepronit?
Tregoni ndonjë ngjarje që ju ka ndodhur juve ose shokut tuaj në ashensor, në tramvaj apo në autobus.

Të zhvillojmë aktivitetet:

Formoni fjalë duke shtuar rrokjen e duhur dhe shkruaj sipas shembullit:
armi

_____ tekni ----- |___| Si ndahen ato në fund të reshtit?

teleferi

Ndani në rrokje fjalët e mëposhtme. Sa rrokje ka secila fjalë?

Shkruaj sipas shembullit.

dora _____ 2 _____ dy rrokje

gjyshi _____

kalamaj _____

këmba _____

ashensori _____

LAPSI DHE GOMA

Lapsi rrinte qetë mbi bangë dhe nuk donte të shkruante. Ishte i hidhëruar me gomën:

- Mezi që presësh që të bëj një gabim të vogël e ti menjëherë ta fshish!
- E, ç'paske dashur ti? Të të lë të shkarravisësh çfarëdo budallallëqesh në fletore?
- në vend ia ktheu goma.
- Përderisa ti nuk do të mësosh të shkruash si duhet, unë nuk do të lë të qetë!
- Ç'më shtiresh aq mençurake e hajde provo të shkruash ti diçka, të paktën vetëm një fjalë?! -tha lapsi.
- Nuk më vjen turp të pranoj se nuk më intereson për të shkruar - iu përgjigj goma. Sepse, kjo nuk është punë e imja. Këtu çdokush ka detyrën e vet të caktuar - ti të shkruajsh, kurse unë të fshij!
- Ti e ke lehtë! - ofshajti lapsi. -Unë djersitem duke shkruar, kurse ti me një lëvizje më fshin krejt mundin...

Goma buzëqeshi:

- Nuk është krejt ashtu si thua ti! Më së pari: unë nuk e fshi krejt mundin tënd, por vetëm gabimet. Dhe së dyti: përderisa fshi edhe unë zhdukem dalëngadalë.

Në këto fjalë lapsi heshti e s'kishte ç'të thoshte.

V. Podgorec

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

shkaravisësh – bën vija të paqarta
ofshajti–mori frymë thellë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku ndodheshin lapsi dhe goma?
- Pse lapsi nuk donte të shkruante?
- Pse nuk turpërohej goma?
- Pse goma qeshi me lapsin?
- Si iu përgjigj goma lapsit?
- Pse heshti lapsi?

Të interpretojmë sipas planit:

- Lapsi idhnohet me gomën.
- Goma i përgjigjet lapsit.
- Lapsi kërkon nga goma që të shkruajë.
- Goma përsëri i përgjigjet lapsit.
- Lapsi ankohet duke ofshajtur.
- Goma përgjigjet duke buzëqeshur.

Detyrë

- * Lexo me zë fjalët ankuese të lapsit!
- * Lexo fjalët e gomës që ia thotë lapsit duke buzëqeshur në fund!

Të zhvillojmë aktivitetet:

a) Ky tregim është i shkruar në formë të bisedës ndërmjet lapsit dhe gomës. Tento ta dramatizosh bisedën me shokun tënd: ti bëhu lapsi, ndërsa shoku yt goma! Mëpastaj ndërroni rolet!

b) Shkruaje tregimin në fletore si dramatizim!

LAPSI: (I hidhëruar). -Pret një gabim të vogël...

GOMA: (Ia ktheu në vend) -E, ç'paske dashur ti?....


Më tutje vazhdo vetë!...

Të kuptojmë shprehjet:

ç'më shtiresh mençurake-pse bëhesh
sikur je e mençur



ELEFANTI I VOGËL DHE NËNA E TIJ



Elefanti i vogël pyeste një ditë nënën e tij:
 -Mami, kush është më i fortë se ne?
 -Askush, bir! Ne elefantët jemi më të fortët e të fortëve.
 -Po pse thonë se luani është mbreti i kafshëve.
 -Këtë e thonë njerëzit...Për ne luani është si një mace.
 -Po rinoçeronti, mami, është i fortë?
 -Kur ne kalojmë pranë tij, ai ndalon dhe na hap rrugën.
 -Atëherë askush nuk mund të na godasë në noçkë dhe të na e dërmojë atë?
 -Askush, bir, askush, por ngrije kokën lart kur flet se, elefanti nuk flet kokulur...

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

rinoçeront – kafshë me trup të madh e me kokë të zgjatur, që ka në turi një bri a dy brirë
 noçkë – turi, feçkë, hundë e gjatë.

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'e pyeti një ditë elefanti i vogël nënën e tij?
- Si iu përgjigj e ëma?
- Kush thotë se luani është mbreti i kafshëve?
- Cila kafshë tjetër është e fortë?
- Si i tha nëna më në fund elefantit të vogël?

Bisedë:

- Cila nga kafshët është më e madhe: dinosauri apo lepuri?
- Cilat janë kafshët e egra që i ke parë në kopshtin zoologjik, të cilat i njeh?

Të zhvillojmë aktivitetet:

Shëno (+) për kafshët e egra, kurse me (-) kafshët e buta			
qeni			gomari
ujku			delja
iriqi			hiena
kali			lepuri
elefanti			dhia
luani			mushka
lopa			zebra
gjirafa			tigri
rinoçeronti			ariu

BREDHI DHE FERRA

Një ditë, majë kodrës, bredhi i thotë ferrës:

-Më shiko mua! Unë jam i lartë, i fortë, i hijshëm dhe mjaft i bukur.

Ç'të mirë ke ti? Je e vogël, e shëmtuar dhe shtrembaluqe.

Këto fjalë e mërzitën shumë ferrën, sepse e kuptoi se shoku kishte të drejtë.

Ditën tjetër, kodrës iu ngjitën disa druvarë. Ata filluan të prisnin bredhin.


Donin ta përdornin për të ndërtuar një shtëpi të re.

-Oh, e dashur! -thirri bredhi, ndërsa po binte.

-Sa do të doja të isha një ferrë!

Vetëm po të isha si ti, njerëzit s'do të më kishin prerë.

Porosi: Ata që mburren sot, mund të pendohen nesër.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

bredhi - dru i lartë gjethmbajtës
e shëmtuar - e keqe
shtrembaluqe - e shtrembër bredhi
druvarë - njerëzit që presin dru

Të kuptojmë shprehjet:

ndërsa po binte— për derisa rrëzohej

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Çka i tha bredhi ferrës?
- Si e ndjeu veten ajo?
- Ç'ndodhi një ditë tjetër me bredhin?
- Si iu ankua bredhi ferrës?

Të interpretojmë sipas planit:

- Fjalët mburrëse të bredhit.
- Mërzitja e ferrës.
- Prerja e bredhit nga druvarët.
- Fjalët ankuese të bredhit.

Bisedë:

- *Tregoni si u themi ndryshe atyre që mburren?
- *A është veti e mirë të lavdërohemi vetë, para të tjerëve?

Të lexojmë bukur:

- Gjeni dhe lexoni fjalët ku lëvdërohet bredhi!
- Lexoni fjalët ku ankohet bredhi!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Mbiemrat: i lartë, i fortë, i hijshëm, i bukur, e vogël, e shëmtuar, e shtrembër, ktheni në shumës dhe gjini të kundërt. (Punoni në fletore sipas shembullit)

mbiemri	shumës	njëjës	shumës
i lartë	të lartë	e lartë	të larta
I hijshëm			
I fortë			
i bukur			
e vogël			
e shëmtuar			
e shtrembër			

ZEMRA E DIELLIT

-Baba!

-Urdhëro, Ardi!

-I kujt është Dielli?

-I të gjithëve.

-Si i të gjithëve?

-Ashtu; i imi, i yti, i atij, i atyre...

-Tjetër?

-Dielli është edhe i tërë botës: i Tokës, i Hënës, i yjeve të shumtë. Ai ndriçon për të gjithë njësoj...

-Oh, kjo është mrekulli, baba, por nuk kuptoj si e arrinë ai gjithë këtë: të ndriçojë mbarë botën dhe t'u takojë të gjithëve?

-Ai ka zemër të madhe, të ngrohtë, o bir...

-Me siguri, baba, por prap po habitem: si ndriçon kaq shumë, megjithatë, nuk harxhohet?



-Natyra që përsëritet, këngët që derdhen, falënderimet e shumta nga të gjitha anët e botës drejtuar atij, i japin vullnet e fuqi. Lumturinë që ai ua fal të tjerëve e bën edhe atë të lumtur, i jep ngrohtësi zemrës së tij. Duke i gëzuar përherë të tjerët, duke ngjall e lulëzuar vazhdimisht jetën, ai sikur nuk ka kohë të vjetërohet. Përherë rri i ri, i fortë dhe duket i buzëqeshur...

-Sa mirë do të ishte sikur edhe njerëzit të kishin zemër të ngjajshme me Diellin!

-Po, bir. Kjo do të ishte mrekulli! Atëherë edhe lumturia në botë do të ishte më e madhe, e paskajshme...

At e bir tashmë kishin arritur në parkun e qytetit. Dielli nga horizonti sikur e kishte dëgjuar bisedën e tyre. Ua fali një buzëqeshje nga zemra e tij e ngrohtë, e madhe.

Ymer Elshani



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

mrekulli - shumë bukur
vullnet - forcë të madhe, fuqi
lumturinë – gëzimin

Të kuptojmë shprehjet:

ka zemër të madhe - është zemërgjërë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'e pyeti Ardit babin e vet?
- Si u përgjigj babi?
- Çka e bënte Ardin të habitet?
- Pse nuk harxhohet Dielli?
- Cila ishte dëshira e vogëlushit për Diellin?

Të interpretojmë sipas planit:

- Pyetja e Ardit drejtuar babait.
- Përgjigjia: Dielli është i tërë botës.
- Dielli ndriçon e nuk harxhohet.
- Arsyetimi i babait.
- Mesazhi ose porosia e vogëlushit.

Të lexojmë bukur:

- * Gjeni dhe lexoni me kujdes përgjigjet e babait, mandej të Ardit!
- * Lexoni tekstin sipas roleve!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Shkruani pesë fjali të babait të Ardit.
- Mësoni përmendsh përgjigjet e babait që ia dha të birit. (Vazhdo:

-Dielli është i tërë botës..._____

-Ai ka zemër të madhe..._____

-Natyra që përsëritet..._____

PËRGJEGJËSIA

Edhe pse ne jemi fëmijë,
Kemi dhe ne shumë përgjegjësi...
N'mëngjes zgjohemi për çdo ditë,
Zgjohemi herët e i lajmë sytë.
Shkojmë në shkollë rregullisht,
Dhe mësimit s'i bëjmë bisht.
Mësojtoren e ruajmë si sytë,
Higjienën e mbajmë për ditë.
Jemi t'kujdesshëm, s'e teprojmë,
Kohën e lirë kot s'e çojmë.

S.E.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

përgjegjësi - obligime, detyra
mësojtore - klasë
higjienë - pastërti

Të kuptojmë shprehjet:

mësimi s'i bëjmë bisht – nuk i ikim mësimi

Të kuptojmë përmbajtjen:

- A kanë edhe fëmijët përgjegjësi?
- Çfarë përgjegjësie kanë fëmijët (sipas kësaj vjershe)?

Të interpretojmë sipas planit:

- Edhe fëmijët kanë përgjegjësi.
- Disa nga përgjegjësitë e fëmijëve...
- Shkuarja në shkollë rregullisht dhe mësimi.
- Mbajtja e pastërtisë.
- Organizimi i kohës së lirë.

Të bisedojmë së bashku:

- * Përshkruaj si e kalon kohën e lirë!

Detyrë:

- Mësoni vjershën për recitim!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Punoni sipas shembullit duke i shndërruar fjalitë mohore në fjali pohore dhe anasjelltas.
- Në mëngjes nuk zgjohem herët.
- Në mëngjes zgjohem herët.
- Zgjohem herët, nuk i laj sytë.

Nuk shkoj në shkollë rregullisht.

Mësimi i bëj bisht.

Pastërtinë nuk e mbaj si duhet.

Kohën e lirë e çojmë kot.

GARAT NË KOPSHT

PËLLUMBI: A dëgjove për garat në kopshtin tonë, që u bënë para disa ditësh?

TRUMCAKU: Çfarë garash?

PËLLUMBI: Gara në tërheqjen e litarit.

TRUMCAKU: Ndërmjet kujt?

PËLLUMBI: Ndërmjet perimeve dhe frutave.

TRUMCAKU: Ndërmjet perimeve dhe frutave?!

PËLLUMBI: Po.

TRUMCAKU: Vërtet gara interesante!

PËLLUMBI: Interesante dhe tepër interesante...

TRUMCAKU: më intereson: cilët morën pjesë nga ana e perimeve?

PËLLUMBI: Domatja, speci, patatja, lakra, qepa, hudhra, fasulja, bizelja, spinaqi, karrota.

TRUMCAKU: Po në anën e frutave kush mori pjesë?

PËLLUMBI: Dredhëza, qershia, kajsia, pjeshka, molla, dardha, kumbulla, shalqiri, pjepri, rrushi, ftoni.

TRUMCAKU: Dhe kush fitoi?

PËLLUMBI: Fituan të dy ekipet.

TRUMCAKU: Të dy ekipet?


PËLLUMBI: Njëloj ishin të fortë, të shëndoshë dhe muskolor...

TRUMCAKU: Domethënë, dolën baras?

PËLLUMBI: Po, dhe të tillë do të jenë gjithnjë të gjithë fëmijët, të cilët i duan perimet dhe frutat që i hanë rregullisht!

A. K.

Përdorimi i rregullt i perimeve dhe i frutave na bën më të shëndoshë.



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

kopsht - vendi i caktuar për mbjelljen e zarzavateve
trumcaku - zog i vogël
spinaqi - bimë ushqyese me gjethe të gjelbërta
trangull - kastravec, sallatë
ekipet - grupe
muskulor - njeri me muskuj të fortë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Tregoni çka ndodhi në kopsht?
- Ç'i tha pëllumbi trumcakut ?
- Kush mori pjesë në anën e perimeve?
- Po kush - në anën e frutave?
- Kush doli fitues?
- Si përfunduan garat në kopsht?

Të interpretojmë sipas planit:

Pra disa ditëve filluan garat në kopsht...
Pjesëmarrja e perimeve dhe frutave.
Porosia dhënë fëmijëve.

Të lexojmë bukur:

- * Gjeni dhe lexoni fjalët lavdëruese të spinaqit!
- * Lexoni tregimin sipas roleve!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Përgjigjuni pyetjeve sipas shembullit:
- Çfarë është spinaqi?
- Spinaqi është bimë ushqyese me gjethe të gjelbërta.
- Ç'ngjyrë ka ai?

-Ku rritet ai?

-Për çka e përdorim?

Vizatoni dhe ngjyrosni në fletë një shportë : domate, patate, purinin, lakrën, specin.

DASHURI PËR VENDIN

Na paska jetuar njëherë e një kohë një fshatar. Atij i paskan lindur shumë fëmijë. Të gjithë të shëndoshë si molla në gem, si vesa mbi bar. Në skaj të arës së tij paska genë mali. Meqë fëmijët iu rritën, i duhej më shumë tokë për të nxjerrë bukën e tyre. Para se të hapte malin e ta bënte arë, iu desh ta digjte. Para se ta digjte, shkoi e pyeti një plak të urtë: “O plak i dheut! -ia nisi. Më duhet të çel malin për kafshatën e fëmijëve, po para se ta çel, më duhet ta djeg. Në pyll ka shumë kafshë e shpendë. Kam frikë se i djeg zjarri. Më mëso çfarë të bëj, o plaku i dheut, që je i njohur për mençuri e dituri në të katër anët e vendit”.

Plaku i dheut ishte menduar gjatë e më në fund e kishte këshilluar burrin me shumë fëmijë: “Merr daullen dhe bjeri tri ditë e tri netë pareshtur. Duke i rënë, thirr me zë të lartë: “Për kafshatën e gojës së fëmijëve të mi, duhet t’i vë zjarrin malit që të mund ta çel më lehtë. O shpendë, o kafshë dhe o gjithë ç’merrni frymë në mal, ikni posa ta shikoni zjarrin dhe të shikoni tym!”

Tri ditë e tri net kishte gjëmuar lugina nga daullja. Pas tri ditësh, siç thotë legjenda, fshatari ia paska vënë zjarrin malit që të mund ta çelte. Një ditë, duke punuar pranë një shkëmbi, pa skeletet e një shqiponje dhe të zogjve të saj. E pyeti:

Aman, moj shqiponjë, kur unë i rashë daullës tri ditë e tri net, në gjumë të thellë qëlllove apo ishe shurdhuar që nuk ike?

Thuhet se skeleti i shqiponjës paska folur e paska thënë:

“As isha në gjumë të thellë, as isha memece e shurdhë, por nuk desha të lëshoja truallin tim. Këtu lindi e këtu desha të vdes.”

Vehbi Kikaj



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

gem - bisk, degë e re
skaj - kënd, anë
pareshtur - pa ndërprerje
daulle - lodër
skeleti - eshtrat

Të kuptojmë shprehjet:

të hapte malin - të bënte tokë për të mbjellë
kafshatën e fëmijëve - bukën e gojës
në të katër anët e vendit - anëmbanë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ç'e shtyu fshatarin të shkonte te plaku i dheut?
- Ç'këshillë i dha plaku fshatarit?
- Ç'i ndodhi fshatarit kur po punonte tokën?
- Ç'i tha fshatari skeletit të shqiponjës?
- Po ai si iu përgjigj?

Të interpretojmë sipas planit:

- Ka jetuar njëherë një fshatar...
- Shkoi për të pyetur një plak të urtë.
- Këshilla e plakut.
- Fshatari ia vë zjarrin malit.
- Fjalët e skeletit.

Të lexojmë bukur:

- * Lexoni me kujdes tregimin dhe gjeni personazhet .
- * Së bashku me mësuesen gjeni fjalitë që ju kanë pëlqyer më së shumti!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Shkruani bukur në fletore: Pse e duam atdheun tonë dhe ç'duhet të bëjmë për të.
- Së bashku me mësuesen mësoni për qëndresën e shqiptarëve në sundimin e huaj.
- Vizato dhe ngjyros në fletë bukuritë e vendlindjes tënde.

ATDHEU I ELEFANTËVE

Gjyshi e donte shumë nipin e vet, por edhe nipi e donte shumë atë. Ai i tregonte shumë përralla të bukura e nipi e dëgjonte me vëmendje të madhe.

Një natë prej netëve, i rrëfeu një tregim për elefantët, i tha se ata edhe pse janë të mëdhenj, janë kafshë fisnike dhe mjaft të mençura. Vetë e përcaktojnë territorin e tyre për jetesë, duke e konsideruar për atdhe, e që e nderojnë shumë. Elefantët në atdheun e vet kanë vetëm një varrezë. Ai elefant që është i sëmurë ose është tepër plak, shkon e kullot afër varrezës. Kur e sheh se do të vdesë, shtrihet pranë eshtrave të të parëve të vet e atje edhe vdes. Në atë vend ka shumë eshtra.

Disa njerëz i duan dhëmbët e elefantëve, prandaj ata shkojnë te varrezat për t'i vjedhur dhëmbët e tyre. Për këtë ata caktojnë roje. Ajo roje sa e sheh se skeletëve i afrohet dikush, bërtet aq shumë sa buçet i tërë pylli. Elefantët e dëgjojnë rojen, i qasen me shpejtësi të madhe dhe e rrethojnë varrezën. Hajnat detyrohen t'i lënë dhëmbët e elefantëve dhe të ikin të tmerruar.

-Gjysh, a përherë kështu veprojnë elefantët? -pyeti nipi i vogël, Pirrua.


-Kur është fjala për mbrojtjen e varrezave, ata të gjithë veprojnë si të jenë një.

-Po, pse i mbrojnë eshtrat, gjysh?

-Po, ata duke e mbrojtur varrezën, e mbrojnë atdheun e vet, të cilin e duan shumë, -u përgjigj gjyshi.

Pirrua i vockël u habit për fisnikërinë dhe mençurinë e elefantëve.

Abdylazis Islami



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

vëmendje - kujdes e interesim
rrëfeu - kallëzoi, tregoi
fisnike - të mira, bujare
territor - vend i caktuar
buçet - ushton
i qasen - i afrohen
tmerruar – shumë të frikësuar

Të kuptojmë shprehjet:

si të jenë një - unik, të bashkuar

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Çfarë tregimi i rrëfen gjyshi nipit të vet?
- Çfarë kafshe janë elefantët?
- Pse thuhet se ata janë kafshë të mençura?
- Për çka kujdesen ata më së shumti?
- Si i mbrojnë varrezat e tyre?

Të interpretojmë sipas planit:

- Gjyshi dhe nipi.
- Rrëfimi për elefantët.
- Përcaktimi i territorit, atdhe.
- Varrezat.
- Caktimi i rojeve të varrezave.
- Biseda e sërishme ndërmjet nipit dhe gjyshit.

Detyrë:

- * Ritregoni përmbajtjen me fjalët tuaja!

Të lexojmë bukur:

- Gjeni dhe lexoni fjalitë ku tregohet fisnikëria dhe menëuria e elefantëve!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Vëndoni shenjën plus (+) për të shënuar si janë elefantët e tregimit:

fisnik	_____	frikacak	_____
të mëdhenj	_____	të vegjël	_____
të rrezikshëm	_____	të shpejtë	_____
të mençur	_____	të tmerrshëm	_____

KAFSHËT NË PIKNIK

Një ditë karsinët dolën në piknik. Dhe, ç'ndodhi! I pari u paraqit elefanti:

-Roov! -e ngriti feçkën. -Nuk guxojmë ta lëmë fushën në këtë gjendje!

Çdogjë që ka përreth nesh, duhet të mblidhet!

-Unë nuk mundem! -tha kali i Nilit. -Patjetër tani të kthehem në lum.

-Edhe unë nuk mundem, do t'i përlyej pendlat! -shtoi gata.

-Buum! -i hidhëruar murmuroi luani.

-As shirat më të mëdhenj nuk do të mund t'i bartin këto mbeturina. Vendi do të ngel i shëmtuar për t'u parë nëse nuk e pastrojmë!

-Krejt unë do t'i mbledh! -u paraqit majmuni.

- Nga ne këtu, vetëm unë kam duar!

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

piknik - shëtitje e organizuar në natyrë

feçka - zorra e elefantit

kali i Nilit - kafshë e madhe që jeton edhe në ujë

pendla - pupla

gata - shpend uji me qafë e sqep të gjatë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku shkuan kafshët?
- Ç'tha elefanti?
- Pse luani murmuroi i hidhëruar?
- Kush propozoi që të pastrohet vendi?
- Pse i takoi majmunit të pastronte mbeturinat?

Të interpretojmë sipas planit:


- Dalja në piknik.
- Propozimi i elefantit.
- Arsyetimi i kalit të Nilit dhe gatës.
- Arsyetimi i luanit.
- Paraqitja e majmunit.

Të bisedojmë së bashku:

- * Kujtohu kur ke qenë ti herën e fundit në ndonjë piknik në natyrë!
- * Si veproje ti ndaj natyrës?
- * Ç'ke bërë ti para se të kthehesh në shtëpi?

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Bëni diktim vizuel të tregimit (në fletë)



Zenë Arona




MERIMANGA DHE MIZA

Një merimangë thuri pezhishkën e saj në skajin ndërmjet plafonit dhe dritares.
Kur dielli lëshoi rrezet, ajo filloi të gjasojë në një rrjetë të artë.

Një mizë pa pëlhurën e artë dhe deshi të bëjë një fustan me fije ari.
U ndal në rrjetë dhe u ngatërrua.

Erdhi merimanga dhe e hëngri mizën.

Pagoti (Itali)



Nuk është ar çdo gjë që shkëlqen

GJËEGJËZË

Pa gjilpërë veç thur e end
e për peri veç ngarend;
rrjetë thur grumbuj-grumbuj,
gjuan miza, gjuan brumbuj.

Të kuptojmë fjalët e panjohura:

pezhishkë - rretë e merimangës
gjasojë - ngjajë, përngjaj

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku e thuri pezhishkën merimanga?
- Në çka gjasonte ajo kur i ranë rrezet e diellit?
- Ç'donte të bënte miza me pëlhurën e artë?
- Ç'i ngjau mizës?

Të interpretojmë sipas planit:

- Thurja e pezhishkës.
- Vezullima e rretës.
- Miza sheh pëlhurën dhe ngatërrohet.

Të zhvillojmë aktivitetet:

* Formoni tre fjali me fjalët që kanë numra. (Shkruani në fletore).

- | | | |
|------------------|----------------|-------------------|
| a) 3. pezhishkën | b) 1. fustan | c) 6. që shkëlqen |
| 1. Një merimangë | 2. të artë | 3. ar |
| 4. e vet | 3. Një mizë | 2. është |
| 2. thuri | 4. të bëjë | 1. Nukl |
| 6. dritares | 5. pa pëlhurën | 5. gjë |
| 5. pranë | 6. dhe deshi | 4. çdo |

a) 1.2.3.4.5.6.

b) 3.5.6.4.1.2.

c) 1.2.3.4.5.6.

EJANI O FËMIJË

Të kapemi në valle, t'vallëzojmë me dashuri,
në të katër anët t'lëshojmë porosi:
asnjë fëmijë në botë t'mos jetë i uritur,
asnjë lule në kopsht t'mos jetë e pulitur!
Ujku me Kësulëkuqen së bashku të lodrojnë,
lejlekët bretkosat le t'i respektojnë!...
Të kapemi në valle, fëmijë pa halle:
për t'gjithë kalamajtë ka vend në këtë valle;
me cicërrimat e zogjve, me dëshirat flakëroshe,
me ëndrrat e ylbërta për dritën bardhëloshe,
me jehun e k'saj kënge do t'i shembim brigjet,
të kapur dorë për dore do t'i çelim shtigjet!

Syrja Etemi



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

pulitur këtu - vyshkur
lodrojnë - luajnë
kalamajtë - fëmijët
shembim - shkatërrojmë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Kush janë kapur në valle dorë për dore?
- Ç'dëshirojnë të bëjnë fëmijët?
- Ç'farë porosie dëshirojnë të përcjellin ata?
- Çka do të bëjnë fëmijët përmes këngës e lojës?

Të interpretojmë sipas planit:

- Kapja e fëmijëve dorë për dore.
- Dërgimi i porosisë.
- Efekti i mesazhit të tyre.

Të lexojmë bukur:

*Lexojeni rrjedhshëm vjershën në tërësi, me zë, duke respektuar shenjat e pikësimit.

Të bisedojmë:

- *Çfarë porosie tjetër do t'u dërgoje ti fëmijëve?
- *Çfarë porosie do t'u dërgoje të rriturve?

Të zhvillojmë aktivitetet:

- Përshkruaj vargjet e vjershës, të cilët të kanë pëlqyer më së shumti.

EMRAT PËRKËDHELËS

Babait ditë për ditë
buzagazin ia kam falë,
më ka çupëzë sorkadhe
dhe më thërret “djalë”.

Në sytë e nënës sime
jam e mençur dhe e bukur!
-Ku je, moj manekene
eja, bija ime flutur!

Sipas motrës së madhe
(e paça me shëndet)
ajo më quan ndryshe:
oj, pulëbardhë mbi det.

Në oborr lojë pas loje
fëmijët bëhen kurrështarë,
njëri thotë: pa vështroje
at' voglushen faqebardhë!

E puthsha mësuesen tonë...
N'emër më thërret: JEHONË.

Mustafa Spahiu



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

buzagazin - buzëqeshjen
sorkadhe - femra e kaprollit
manekene - këtu: bukuroshe
pulëbardhë - zog deti
kureshtarë - që kërkon të dijë një gjë.

Të kuptojmë shprehjet:

në sytë e nënës sime - pranë nënës sime
çupëzë sorkadhe - vajzë e butë
më thërret djalë - nga malli që s'ka djalë

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Si e thërret babai çupëzën e vet?
- Ç'është ajo për nënën?
- Si e quan nëna bijën e saj?
- Po motra, si e thirr?
- Si quhet vogëlushja në të vërtetë?
- Kush e thërret në emër?

Të interpretojmë sipas planit:

1. Babai dhe çupëza sorkadhe .
2. Nëna dhe bija” manekene”.
3. Motra dhe pulëbardha mbi det.
4. Fëmija dhe vogëlushja faqebardhë.
5. Mësuesja dhe Jehona.

Të lexojmë bukur:

- Lexoni vjershën pa zë (në heshtje), mandej, nënvizo dhe shëno në fletore emrat përkëdhelës!!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- * Shkruani emrat përkëdhelës në fletore (sips shembbullit):

ARBEN	Beni	AGRON	Goni
KUJTIM	_____	LEONORA	_____
ARBENORA	_____	PREMTIM	_____
AGIM	_____	ERMIRA	_____
MARIGONA	_____	GJINUSH	_____

Ëndrra

Ati i Artanit zakonisht lexonte deri vonë në mesnatë. Një natë derisa po lexonte vërejtë se biri i tij s'po bënte gjum të rrehatshëm. Sytë mbyllur, përpëlitej në shtratin e tij. Pas një kohe të shkurtër u dëgjua një klithmë në dhomë. Me të shpejtë i ati i erdhi në ndihmë: "Artani ashtu i habitur i shikonte prindërit e tij në heshtje. E ëma e mori t'ia ledhatonte flokët dhe e futi në gjirin e ngrohtë. "Babi, një qen endacak deshi të më kafshonte në këmbë". "O biri im, të pastë babi, s'ka qen në dhomë të fjetjes". "Po, po ishte në dhomë, tani iku në korridor". E ëma me buzëqeshje i tha që e kishte parë qenin në ëndërr.

Pas fjalëve të së ëmës, Artanin përsëri e zuri gjumi. Pastaj asaj iu kujtua se atë ditë në kopsht kishte hyrë një qen endacak. Fëmijët kishin luajtur me të. I ati u zemërua me fëmijët pse kishin luajtur me një qen endacak. Kanë mundur të infektohen. Ai është i papastër, e duhet të kenë kujdes çdo herë. Nuk është mirë që fëmijët të luajnë me qen endacak, madje asnjëherë.

Izet Hoti

Këshillë: Lani duart mirë pasi të keni prekur macen apo qenin!



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

përpëlitje - lëvizte andej-këndeje
klithmë-zë trishtues
ledhatonte-përkëdhelte
infektohen-fëlliqen

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Për kë flitet në këtë tregim?
- Me ç'fjalë mendohej të qetësonte i ati?
- Ç'bënte e ëma? Si vepronte ajo?
- Pse zemërohej i ati i Artanit?

Të interpretojmë sipas planit:

- Përpëlitja e Artanit në gjum.
- I ati dhe e ëma I vijnë në ndihmë.
- "Qeni deshi ta kafshonte djaloshin".
- Nënës I kujtohet "ndodhia" e ditës.
- Zemërimi I babait.

Të bisedojmë sëbashku:

- * A ju ka ndodhur të shihni ndonjë ëndërr të keqe në gjum?
- * Si keni vepruar ju?
- * A luani ju me kafshët shtëpiake?

Të lexojmë bukur:

- Gjeni dhe lexoni me zërin e duhur fjalët qetësuese të babait dhe nënës së Artanit.
- Gjeni dhe lexoni fjalët e Artanit.

Të zhvillojmë aktivitet:

- Përgjigjuni pyetjeve me shkrim:

-Kur luani? _____

-Me kë luani? _____

-Me cilat kafshë luani më tepër? _____


-A i lani duart pasi luani me kafshët shtëpiake? ____

Mirupafshim shkollë

Shkolla jonë e dashur-
Nëna jonë e shtrenjtë,
Tani shkojmë n'pushime
Ty do të lëmë vetë!...

Ti na ndrite ballin
E zemrat e zjarra,
Me mësimet e dije,
E këshilla të arta.

Nuk do të lëmë gjatë
Në vetmi të rrish.
N'shtatorin që vjen,
Do të shifemi sërish...



Të kuptojmë fjalët e panjohura:

e shtrenjtë - e çmueshme
sërish - përsëri

Të kuptojmë përmbajtjen:

- Ku do të shkojnë fëmijët?
- Me çka i gëzoi shkolla fëmijët edhe këtë vit mësimor?
- Kur do të kthehen nxënësit sërish në shkollë?

Detyrë:

- Mësojeni vjershën përmendsh!

Të lexojmë bukur:

- * Lexoni vjershën me lexim shprehës dhe me zë!
- * Rikëndoni edhe njëherë vargun e tretë dhe të katër të strofës së fundit!

Të zhvillojmë aktivitetet:

- (Ushtrime me shkrim dhe me gojë)

Përshkruaje strofën që tregon se veprimi do të bëhet në kohën e ardhme.
Me ndihmën e mësuesit apo prindit, sqaroni shprehjen : ti na ndrite balline zemrat e zjarra.

TEKSTI DHE FJALIA

NË NATYRË

Sot është dita e shtunë. Nëna, Edi e Bleona vendosën të dalin në natyrë.

U përgatitën dhe u nisën.

Rrezet e diellit ledhatonin degët e drunjëve. Fëmijët luajnë të gëzuar. Ata shëtitën deri vonë. Në mbrëmje u kthyen të kënaqur.

Kujdes:

Ky është **tekst** i shkruar që përbëhet prej **fjalisë**. Secila fjali përbëhet prej **fjalësh**, kurse secila fjalë përbëhet prej **tingujsh**, që i shënojmë me shkronja.

tekst

fjali

fjalë

tingull

Detyrë për në klasë:

1. Në tekstin e mësipërm, numëro fjalitë (duke shënuar në fletore).

Shembull:

Në tekstin e mësipërm ka ... _____

2. Shkruaje fjalinë e pestë në fletore dhe trego sa fjalë ka.

3. Fjala: n a t y r ë , sa rrokje dhe sa tinguj ka?
(Shkruaj në fletore)

Fjala natyrë ka _____ rrokje.

Fjala natyrë ka _____ tinguj.

Kujdes:

Tingujt nëse përdoren si të veçantë, nuk kanë kuptim. Për shembull: d l l i e.

Mirëpo, kur bashkohen formojnë tërësi të kuptueshme që i themi **fjalë**.

Çdo fjalë ka kuptim të caktuar. Kur dëshirojmë të themi një mendim, përdorim dy a më shumë fjalë që i radhisim sipas rregullave të caktuara. E, me këtë bashkim fjalësh formojmë **fjali**. Pra, fjalia përbëhet prej dy a më shumë fjalësh që shërbejnë për të shprehur një mendim apo kuptim..

Detyrë për në shtëpi:

Nga ilustrimi i dhënë, thurri fjali për të formuar një tekst.

“SHTËPIA IME”



4

Rikujtohuni edhe një herë!

teksti fjalitë fjalët tingujt

Teksti paraqet bashkësi fjalish.

Fjalja paraqet bashkësi fjalësh.

Fjala paraqet bashkësi tingujsh.

Tingujt i shënojmë me shkronja.

FORMOJMË FJALË DUKE ZËVENDËSUAR SHKRONJA

GJOL	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	zëvendëso shkronjën e parë	zëvendëso shkronjën e mesme	zëvendëso shkronjën e fundit
VESA	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	zëvendëso shkronjën e fundit	zëvendëso shkronjën e parafundit	zëvendëso shkronjën e parë
ROSA	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	zëvendëso shkronjën e fundit	zëvendëso shkronjën e parafundit	zëvendëso shkronjën e parë

5

TEKSTI I SHKURTËR

janë për shëndetin të mira Pemët

Ata vonë deri shëtitën

në dalin Ata natyrë

gjëra Libri na mëson të mira

gëzueshëm futboll Fëmijët luajnë

Kujdes:

Shembujt që i kemi shënuar lartë nuk janë të rradhitur si duhet, prandaj edhe nuk shprehin ndonjë mendim të caktuar. Lidhja e fjalëve në fjali bëhet sipas kuptimit dhe rregullave gjuhësore.

Detyrë për në klasë:

1. Bëni rradhitjen e fjalëve në fjalitë e mësipërme ashtu që të shprehin një mendim të caktuar (duke shkruar në fletoret tuaja).
2. Fjalitë e mëposhtme me fjalë të shpërndara, me ndihmën e prindërve, rradhiti si duhet ashtu që të kenë kuptim (si në shembullin e dhënë):

e diellit	tokën	ndriçojnë	Rrezet	<i>Rrezet</i>	e diellit	ndriçojnë	tokën		
1	2	3	4	4	1	3	2		
këndojnë në degë	Zogjtë	të drunjve							
1	2	3	4	3	1	2	4		
shëtitën	vonë	deri	Fëmijët	në mbrëmje					
1	2	3	4	5	4	1	3	2	5

TREGIM PA FJALË



Dallimi dhe formimi i fjalive me kuptim



Detyrë për në shtëpi:

1. Nga fjalitë pa kuptim, formoni fjali me kuptim, duke u bazuar në fotografitë e dhëna.

Shembull:


në Valoni lahet pishinë.

Valoni lahet në pishinë.

dhe Genti Vjollca me prindët janë e tyre.

Korbi në qëndron degë.

2. Plotëso fjalitë me fjalët që mungojnë, duke përdorë fjalët e duhura:



Motra ime po

Macja ime ulur.

Aeroplani

7

Detyrë për në klasë:

1. Me fjalitë e dhëna, formoni tekst sipas shembullit :

Mësuesja ime më mëson

të shkruaj e të lexoj
shumë vjersha e tregime
të jem e edukuar
e pastër
dhe e sjellshme

ta dua librin

t'i dua prindërit e shokët

të dua vendlindjen time të bukur

Mësuesja ime më mëson të shkruaj e të lexoj.


Mësuesja ime më mëson të jem e edukuar, e _____ dhe e _____

*Mësuesja ime më mëson ta dua _____, t'i dua _____
e _____ të dua _____*

Detyrë për në shtëpi:

1.Me fjalitë e dhëna, formoni tekst sipas shembullit dhe shkruani në fletore.

8




Mësuesja ime më mëson shumë tregime.

*Mësuesja ime më mëson të jem e _____
dhe e _____*

*Mësuesja ime më mëson ta dua _____,
e _____ të dua _____*

FORMOJMË FJALI NË BAZË TË FOTOGRAFISË




XHA UKA NUK MUND TË
FLEJË




Xha Uka është burrë plak dhe
i duhet shumë qetësi ...
Fatkeqësisht afër banesës së tij ka
shumë zhurmë.

(Shikoni fotografinë dhe
tregoni se kush bën zhurmë)

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____



Drunj , Banesa nr. 88 , Rruga “28 Nëntori”, Autobusi nr. 22-14, Vetura nr.74-92, Ndërtesa 14 katëshe



10 Në fotografi shihen _____ drunj.
Në fotografi shihen gjashtë drunj.

Albani jeton në banesën nr. _____ të rrugës

“ _____ Nëntori”.

Autobusi nr. _____ kalon rrugës, kurse në
anën tjetër, përpara shtëpisë me numër 16 është e parkuar vetura me tagër

Në ndërtesën _____ katëshe banon shoku i

Albanit, Blendi.

FJALIA DËFTORE

Ushtrime:

Në shembujt e mëposhtëm do të gjeni fjalitë me të cilat tregojmë diçka:

1. Sot është dita e hënë.
2. Liza është klasa e tretë.

Kujdes:

Fjalitë me të cilat tregojmë apo dëftojmë diçka i quajmë **fjali dëftore**. Në fund të fjalive dëftore vëndojmë pikë .

Detyrë për në klasë:

1. Nga fjalitë e mëposhtme, hiq ndonjë pjesë të fjalisë ashtu që të mos humbet kuptimi i saj (si në shembullin e dhënë):

- Artani luan me top.

Artani luan.

- Anita lexon për çdo ditë. (_____)

- Bilbilat në pranverë këndojnë. (_____)

- Andi shkruan shumë bukur. (_____)

2. Nga fjalitë e mësipërme, formoni disa fjali dëftore dhe shkruani në fletore.

Shembull:

Artani luan me top.

Me top luan Artani.

Me top Artani luan.

Luan me top Artani.

Anita lexon për çdo ditë.

Për çdo ditë... _____

Anita për... _____

Lexon Anita... _____

Bilbilat këndojnë në pranverë.

Në pranverë.. _____

Bilbilat... _____

Këndojnë... _____

12

Detyrë për në shtëpi:

1.Nga fjalia e mësipërme (Andi shkruan shumë bukur),formoni disa fjali dëftore. (Si në shembujt e mësipërm).

FJALIA PYETËSE

Ushtrime:

Në shembujt e mëposhtëm do të gjeni fjalitë me të cilat pyesim diçka:

Gjin, a shkon ti në shkollë?
Sa është ora?

Fjalitë me të cilat pyesim diçka i quajmë **fjali pyetëse**. Në fund të fjalive pyetëse vëndojmë pikëpyetje ?

Për shembull:
A ka lule në kopshtin tënd?
Ti a mbledh lule në kopsht?
A kanë lulet aromë të këndshme?

Detyrë për në klasë:

1. Fjalitë dëftore ktheni në fjali pyetëse sipas këtij modeli:

FJALI DËFTORE	FJALI PYETËSE
Genti shkon në shitore	<i>Genti a shkon në shitore?</i>
Liqeni i Strugës është i bukur	
Viti ka katër stinë	
Fjolla i bëri detyrat e shtëpisë	

13

1. Fjalitë pyetëse ktheni në fjali dëftore:

FJALI PYETËSE	FJALI DËFTORE
Ju a kujdeseni për shëndetin?	<i>Ju kujdeseni për shëndetin.</i>
Ju a keni qenë në teatër?	
Nxënësit a e pastruan mësojtoren?	
Nxënit e kl. së III a shkuan në shëtitje?	

3. Shndërroni fjalitë e mëposhtme sipas modelit të dhënë:

Genta e ndihmon vëllaun *Genta e ndihmon vëllaun* *A e ndihmon Genta vëllaun*
në mësimin e matematikës. *në mësimin e matematikës.* *në mësimin e matematikës?*

Bardhi rregullisht *Bardhi...* *A...* _____
i bën detyrat e shtëpisë. _____

PARASHTROJMË PYETJE

Bekimi shkon në _____ KINEMA
Ku shkon Bekimi ?

Ai banon në _____ TETOVË

Babai i Blendit quhet _____ BASHKIM

14

Babai dhe nëna e Bekimit punojnë në _____ FABRIKË

TETË MARSË

Ushtrime:

Parashtro pyetje gojarisht për çdo fjali .

Vajza i dhuroi lule nënës. *Çka i dhuroi vajza nënës?*

Nëna e puthi të bijën. _____

Vajza e përqafoi të ëmën. _____

Vajza ia uroi Tetë marsin nënës. _____

Nëna e falënderoi. _____

Nëna dhe vajza u gëzuan. _____

Detyrë për në shtëpi:

1. Formoni fjali pyetëse me etiketat dhe shkruani në fletore:

u zemërua me Bardhin Pse Dea _____

e këshilloi A nëna Deën _____

fajin Dea e kuptoi A _____

2. Plotësoni pyetjet që duhen bërë për të marrë përgjigjen djathtas, si në shembullin e dhënë:

Ç' bën... _____ ? Lena flet në telefon.

Kush ... _____ ? Në telefon flet Lena.

Me kë... _____ ? Ajo flet me Rritën.

15

3. Me fjalitë e mëposhtme formoni fjali pyetëse:

1. fajin, Roni, e kuptoi, A _____ ?

2. u zemërua, me Tringën, pse, Zana _____ ?

3. Rinën, si, nëna, e këshilloi _____ ?

Detyrë për në klasë:


1. Në fletoret tuaja llogaritni dhe shkruani se kush arrin i pari në cak?







Genti



Besimi



16

	= 3 sekonda		= 6 sekonda		= 5 sekonda		= 4 sekonda
		C	A	K	U		

Detyrë për në shtëpi:

1. Parashtro vet pyetje me shkrim, po ashtu edhe me shkrim përgjigju.

(Shembull)

Kush arrin i pari në cak?

I pari në cak arrin _____

Të hequrit dhe të shtuarit e pjesëve të fjalisë

Detyrë për në klasë:

1. Nga fjalitë e mëposhtme, hiq ndonjë pjesë të fjalisë ashtu që të mos humbet kuptimi i saj (si në shembullin e dhënë):

Puhiza luan në piano shumë bukur.

Puhiza luan në piano.

Armendi shkon në shkollë për çdo ditë.

Dielli ndriçon me rreze të arta.

Pranvera sjell gëzim për ne.

17

2. Fjalive të mëposhtme shtoni edhe ndonjë pjesë plotësuese ashtu që të mos humbet kuptimi i fjalisë.

Shembull:

Puhiza luan në piano.


Puhiza bukur luan në piano.

Armendi shkon në shkollë.

Dielli në pranverë ndriçon.

Pranvera sjell gëzim për ne.

FJALI PËR TË POHUAR (pohore)



Ora është trembëdhjetë e tridhjetë.

Ushtrime:

1. Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni:

Rruga është e gjatë.
Këpucët më vijnë tamam.
Blendi vjen me vrap.
Kështu është mirë.

Kujdes:

Fjalitë e mësipërme janë **fjali pohore**, sepse pohojnë diçka.

18

Detyrë për në klasë:

1. Në tabelën e mëposhtme kemi fjali që pohojnë diçka dhe fjali që mohojnë.

Gjej fjalitë pohore dhe mbi kolonë shëno *Fjali pohore.*


Unë kam mace.	<i>Unë nuk kam mace.</i>
Ajo luan me shoqet.	<i>Ajo nuk luan me shoqet.</i>
Ai është i pari.	<i>Ai nuk është i pari.</i>
Vjosa këndon bukur.	<i>Vjosa nuk këndon bukur.</i>
Anda di shumë vjersha.	<i>Anda nuk di shumë vjersha.</i>

Detyrë për në shtëpi:

1.Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme duke i filluar fjalitë me **Po**.

A i ke bërë detyrat e shtëpisë?	Po, i kam bërë .
A do të shkoni në shëtitje?	
A dini të përdorni kompjutorin?	
A doni të luani futboll?	

FJALIA PËR TË MOHUAR (mohore)



Ora nuk është trembëdhjetë e tridhjetë.

Ushtrime:

19

1.Lexoni fjalitë e mëposhtme dhe vëreni:

Rruga nuk është e gjatë.
Këpucët nuk më vijnë tamam.
Blendi nuk vjen me vrap.
Kështu nuk është mirë.

Kujdes:

Fjalitë e mësipërme janë fjali mohore

Detyrë për në klasë:

1. Në tabelën e mëposhtme kemi fjali që mohojnë diçka dhe fjali që pohojnë.

Gjej fjalitë mohore dhe mbi kolonë shëno: *Fjali mohore.*

Ela nuk është në shtëpi.

Ela është në shtëpi.

Sot nuk është kohë e mirë.

Sot është kohë e mirë.

Nxënësit nuk erdhën në kohë.

Nxënësit erdhën në kohë

Sot s'mund të shkoj në teatër.

Sot mund të shkoj në teatër.

Kjo melodi nuk më pëlqen.

Kjo melodi më pëlqen.

Kujdes:

Në tabelën e mësipërme kemi një fjali kështu: **Sot s'mund të shkoj në teatër.** Kështu, kemi përdorë (**s'**) në vend të (**nuk**) . Prandaj themi se:

20

Fjalëza s' përdoret në vend të fjalëzës **nuk** dhe anasjelltas.
Ja edhe disa shembuj:

Nuk mund – s'mund

S'më pëlqen – nuk më pëlqen

Nuk kam – s'kam

S'është – nuk është

Detyrë për në shtëpi:

1. Në fjalitë e mëposhtme, dalloni fjalitë pohore dhe ato mohore
(Fjalitë pohore shënoni me **PO**, kurse fjalitë mohore shënoni me **MO**)

Gjergji nuk i ka bërë detyrat. **MO**

Rrena i ka këmbët e shkurta. _____

Nuk është festë çdo ditë. _____

Mos fol kurrë pa menduar. _____

Dita e mirë shihet që në mëngjes. _____

Kush s'punon, nuk fiton. _____

Liqeni s'është i madh. _____

PJESËT KRYESORE TË FJALISË



Artani lexon



Iliri noton bukur.

Kujdes:

Fjalja e parë përbëhet prej dy pjesëve: ” *Artani* dhe “ *lexon* “. Pjesa e parë është kryefjala dhe e nënvizojmë me një vijë _____, kurse e dyta është kallëzuesi dhe e nënvizojmë me dy vija _____, sepse kallëzon se ç'bën kryefjala.

Kryefjalën e gjejmë me pyetjen **kush?**, ndërsa kallëzuesin e gjejmë me pyetjen **çka?**

Detyrë për në klasë:

21

1. Shkruaj sipas shembullit:

	Kryefjala	Kallëzuesi
Genta shkruan	<i>Genta</i>	<i>Shkruan</i>
Nxënësit luajnë me top.		
Luani doli i pari		
Vjosa vallëzon bukur.		
Ardi reciton vjershën..		

FJALIA MË E VOGËL



(Anita duke vrapuar)
Anita vrapon



(Ariani duke luajtur në park)
Ariani luan me xhitën në park

Kujdes:

Fjalìa mund të përbëhet nga dy e më tepër fjalë me gjatësi të ndryshme. Nga shembujt e mësipërm shohim se fjalia e parë është më e shkurtër se fjalia e dytë. Fjalia e dytë është më e gjatë se fjalia e parë.

Fjalia: **Anita vrapon** është e përbërë prej dy pjesëve kryesore dhe themi se kjo është **fjali më e vogël**.

Fjalia: Ariani luan dhe vrapon në park. Është e përbërë prej më tepër pjesëve dhe themi se kjo është **fjali e zgjëruar**.

22

Detyrë për në klasë:

1. Lidh me shigjetë fjalët për të krijuar fjali më të vogla.

Për shembull:

dielli	luajnë
fëmijët	shkruan
mësuesi	ndriçon


2. Plotëso fjalitë me fjalët që mungojnë duke përdorë fjalët: **im, ime**.

Për shembull:

Mamaja pastron.

Babai lexon.


Detyrë për në shtëpi:



Pëllumbi...



Shtëpiza...



Piktura...

1. Nga fotografitë e paraqitura, shkruani në fletore tre fjali më të vogla!

2. Nga fjalitë më të vogla ndërtoni fjali të zgjëruara:

(Fjalë për ndihmë: hap, shkruan, këndon)

Anila luan. *Anila luan dhe në piano.*

Genci lexon. *Genci lexon dhe në fletore.*

Arta fshin. *Arta fshin dhomën dhe dritaret.*

Detyrë për në klasë:

1. Në tekstin e mëposhtëm gjeni fjalitë më të vogla dhe shkruani ato në fletore:

DITËLINDJA

Albani feston ditëlindjen. Në mbremje i erdhën mysafirë. Ata i prunë shumë dhurata. Vera i pruri flomastera dymbëdhjetë ngjyrëshe. Natalia i pruri Enciklopedinë për fëmijë. Tringa i pruri "Milsh" shokoladë. Ata luanin të gëxuar. Më vonë ndexën tetë qirinjë.

2. Formoni dhe lidhni fjalitë më të vogla sipas shembullit:

Dielli ndriçon.

Genci i vogël lexon një libër.

Genci lexon

Dielli i artë ndriçon .

24

Xeni lahet

Fëmijët e shkollës luajnë në oborr.

Fëmijët luajnë

Xeni i sjellshëm lahet.

Detyrë për në shtëpi:

1. Nga fjalitë e dhëna, ndërtoni fjali të zgjëruara dhe shkruani ato në fletore.

(Shembull):

Arbini vrapon.

Arbini vrapon dhe në fushë të sportit.

Azra këndon.

Mësuesja na mëson.

Mami shkon në punë.

Iliri ushtron.

DALLIMI I EMRAVE

Detyrë për në klasë:

1.Sipas modelit të dhënë formo nga një fjali për secilën figurë apo vizatim:

Modelet:

Dhentë janë kafshë shtëpiake.
Kafshët ushqehen me kullosë.
Mirsa dhe Dea luajnë me top.
Topi është dhuratë për ditëlindje.



Bardha dhe Lola janë nxënëse



Qeni dhe maca janë kafshë



Telefoni është i ri


Kujdes:

25

Emërimin e frymorëve (njerëzve, kafshëve) dhe sendeve e bëjmë me **e m r a**

Detyrë për në shtëpi:

1.Sipas modeleve, për çdo fotografi thuaj ndonjë fjalë.



Ushtrime:

*Lumi më i madh në Maqedoni është Vardari.
Nga ballkoni, Agimi i hodhi sytë kah Shkari.*

Kujdes:

- ◆ Me shkronjë të madhe shkruhet fjala e parë e fjalisë.
- ◆ Me shkronjë të madhe shkruhen emrat gjeografikë, emrat e rrugëve, shesheve, firmave, etj;
- ◆ Me shkronjë të madhe shkruhen edhe emrat e përveçëm, pa marrë parasysh se a është ai në fillim të fjalisë, në mes apo në fund.

Nuk shkruhen me shkronjë të madhe:

- ◆ **emrat e përgjithshëm:** shtëpi, lule, erë, bukë, mal, etj;
- ◆ **mbiemrat:** i bukur, i vogël, i errët, i egër, e madhe, etj;
- ◆ **përemrat:** unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato, i imi, i saj, etj;
- ◆ **numërorët:** një, dy, pesë, dhjetë, shtatëdhjetë, etj;
- ◆ **foljet:** shkoj, lexoj, shkruaj, ha, pij, etj.

26

Detyrë për në klasë:

1. Rregullo fjalitë e mëposhtme duke përdorë shkronjën e madhe aty ku duhet dhe shkruaj në fletoren tënde:

- ◆ rrugës për në shkup, kaluam përreth vardarit.

Rrugës

- ◆ për pushime verore do të shkojmë në strugë.

Për

- ◆ pasi i bëmë detyrat, unë, bardhi, arbëri dhe leka shkuam në mal .

Pasi

EMRAT MASHKULLORË DHE FEMËRORE

Ushtrime:

1. Mendo dhe përgjigju në pyetjet:

-Çka emëron me emrat?

-Me çfarë shkronje shkruhen emrat e përveçëm?

-Numëro pesë emra të përgjithshëm dhe pesë emra të përveçëm!

2. Në këtë tabelë ka të paraqitur emra që dallohen sipas gjinisë.

Shëno me **f** emrat e gjinisë femrore, kurse me **m** emrat e gjinisë mashkullore:

çanta	<u> f </u>	mësuesi	<u> </u>
fletorja	<u> </u>	klasa	<u> </u>
libri	<u> m </u>	bjeshka	<u> </u>
tavolina	<u> </u>	lumi	<u> </u>
drieri	<u> </u>	fshati	<u> </u>
kali	<u> </u>	qyteti	<u> </u>

Kujdes:

28

Emrat në gjuhën shqipe u përkasin këtyre dy gjinive: **mashkullore** dhe **femërore**.


Emrat: pula, delja, shkolla, nëna, janë në gjininë femërore.

Emrat: nxënësi, gjeli, babai, janë në gjininë mashkullore.

Detyrë për në klasë:

1. Emërto sendet që janë në ilustrim. Trego cilës gjini i përkasin.

(Shëno me m nën figurën që i përket gjinisë mashkullore dhe me f nën emrin që i përket gjinisë femërore).



Detyrë për në shtëpi:

1. Trego cilës gjini i përkasin emrat. (Vëndo mbaresat e duhura dhe shëno me m për emrat që i përkasin gjinisë mashkullore dhe me f emrat e gjinisë femërore).

derë	der-a	<u>f</u> __
laps	laps-i	___
ujk	ujk-u	___
shkollë	shkoll-__	___
mjek	mjek-__	___
qen	qen__	___

2. Trego cilës gjini i përkasin emrat e figurave të mëposhtme. (Vëndo m për emrat që i përkasin gjinisë mashkullore dhe f për emrat e gjinisë femërore).

lepurushi



zilja



lepurusha



çanta



29


libri



lapsi



shkolla



drenusha



ujku



EMRA TË GJINISË FEMËRORE QË MBAROJNË ME - ë

dorë, këmbë, dhomë, pemë, dardhë, shkollë, rrugë, klasë

Detyrë për në klasë:

1. Lexoni fjalët e mësipërme dhe shihni se me çfarë shkronje mbarojnë.

2. Shkruani emrat e mëposhtëm sipas shembullit të dhënë.

shkolla	_____	→ një shkollë
çanta	_____	→ një _____
rruga	_____	→ një _____
ena	_____	→ një _____
kënga	_____	→ një _____
bleta	_____	→ një _____

3. Shkruani drejtë emrat e mëposhtëm.

këng _____, fush _____, gom _____, flet _____

nën _____, hën _____, bang _____, pem _____

30

Detyrë për në shtëpi:


1. Në tekstin e mëposhtëm, vini shkronjën ë atje ku duhet.

Babai i dha Teutës njëzet denar_. Teuta numëroi shpejtë e shpejtë dhe shkoi në supermarket dhe bleu: një çokollat_, moll_ dhe një kokërr dardh_. Deshi të blente edhe një gom_ përtypëse, por me parat_ që kishte nuk mundte, pasi i duheshin shtuar edhe pesë denar_.

2. Në fund të figurës, shkruani sipas shembullit:



buzë




th.....



f.....



k.....



p.....

DALLIMI I NUMRIT TË EMRAVE

Kujdes:

Nëse emri tregon një frymor apo një send, ai është në numrin njëjës.

Nëse emri tregon më tepër frymore apo sende, atëherë është në numrin shumës.



Nxënësi shkruan në fletore.





Nxënësit shkruajnë në fletore.

Kujdes:

31

Edhe njëjës edhe shumës, fjala fletore është njësoj, por jo edhe fjala libër, si për shembull: Një libër. Shumë libra.



Detyrë për në shtëpi

Blendi luan me top.

Blendi me shokët luajnë me top.

Vazhdo sipas shembullit të dhënë.

Të shprehurit e vetive të sendeve dhe frymorëve

Shembull:

Një shtëpi e vogël duket në kodrinë.
Gitara e drunjhtë ka zë më të bukur.
Nxënësit e mirë mësojnë me dëshirë.
Mbi çati kishte plotë pëllumba të bardhë.

Ushtrime:

1. Trego çfarë vetish kanë sendet dhe frymorët: shtëpi, gitara, nxënësit, pëllumbat?

Detyrë për në klasë:

1. Shfrytëzo edhe cilësi tjera të sendeve dhe frymorëve e mandej zgjeroi fjalitë e mësipërme (dhe shkruaj ato në fletore)

Shembull:

32

Një shtëpi e madhe duket në kodrinë.

2. Trego pesë fjali të reja, madje ato zgjeroi me veti tjera.

Shembull:

Vetura është e shpejtë.
Vetura është e ngadalshme.

Detyrë për në shtëpi:

1. Sipas ilustrimeve trego pesë fjali dhe shkruaj në fletore.
Mundohu të tregosh sa më shumë cilësi. Ki kujdes fjalitë të jenë mirë të shkruara.



SHUMËSI I EMRAVE MASHKULLOR

Kujdes:

Kemi thënë se emrat e gjinisë mashkullore në fund marrin mbaresën: **i** ose **u**, por ka disa emra që nuk marrin asnjërën nga këto mbaresa, p.sh. emrat: djalë, kalë, ujk etj.

Detyrë për në klasë:

1. Emrat e gjinisë mashkullore:

djalë, kalë, ujk, nxënës, mësues, shkruani në numrin shumës.

numri njëjës	numri shumës
djalë	<i>djemë</i>
kalë	
ujk	
nxënës	
mësues	

33

Kujdes:

Kemi emra që edhe në numrin njëjës edhe në numrin shumës me po ato mbaresa, si është rasti me emrat e mësipërm: nxënës dhe mësues.

DALLIMI I FJALËVE QË EMËRTOJNË CILËSI

Kali i **bardhë** vraponte nëpër kullosën e **gjelbërt**. Kur e pa qenin tim **të vogël** u ndal në vend. Një fëmijë i **gëzuar** që rrinte aty pranë, shikonte se çfarë po ndodh. Qeni i **vogël** luante nëpër barin e **butë** me shallin e **leshtë** të gjyshes, ndërsa kali vazhdoi rrugën.

Ushtrime:

1.Lexo me zë fjalët e shkruara me të zeza. Para cilëve lloje të

fjalëve janë përdorur emrat: *kali, kullosa, qeni, fëmijë, bari, shalli?*

2.Parashtro pyetjen: “Si është kali?” Përgjigjja do të pasojë: “i bardhë”,ose: “Si ishte kullosa?” Sigurisht se përgjigjja do të ishte : “e gjelbërt”!

Kujdes:

Fjalët që tregojnë ndonjë cilësi të sendeve, frymorëve dhe fenomeneve (i bardhë, e gjelbër, e vogël, i gëzuar, e butë, e leshtë, quhen **mbiemra**. Mbiemrat, zakonisht tregojnë cilësitë e emrit.

34

Detyrë për në klasë:

1.Në listën ku në njërën anë janë të grupuar emrat dhe në anën tjetër mbiemrat, lidhi ata me shigjetë.

Për shembull:

emrat

klasa
shkolla
dielli
mali
Struga

mbiemrat

e madhe
i nxehtë
e pastër
e bukur
i lartë

Detyrë për në shtëpi:

1.Shkruaj në fletore pesë fjali të zgjëruara duke përdorë mbiemrat:

i pastër, i ngjuar, e fortë, e flohtë, i ngrohtë, i kuq, e lehtë.



Ushtrime: (e madhe, e kuqe, i verdhë, e gjelbër, e bukur, e keqe)

1. Nga ilustrimi i dhënë shkruaj në fletore disa karakteristika, si për shembull:

- Shtëpia e shtatë xhuxhave është e madhe.

- _____

- _____

- _____

- _____

- _____

- _____

Detyrë për në shtëpi:

1. Në listën ku në një rën janë të grupuar emrat dhe në anën tjetër mbiemrat, lidhni me shigjetë emrin me mbiemrin përkatës.

emrat

mbiemrat

shtëpia

e madhe

dera

i nxehtë

korriku

e blertë

pranvera

e bukur

Shkupi

i madh

2. Gjeni dhe shënioni fjalën e kundërt të këtyre mbiemrave duke u bazuar në fotografitë e dhëna:



qengji



zogu

Qengji është më i madh se zogu.

Zogu është më _____ se qengji.



aeroplani



vetura

36

aeroplani është më i shpejtë se vetura.

Vetura është më _____ se aeroplani.



nëna



e bija

Nëna është më e vjetër se e bija

E bija është më _____ se nëna

MBIEMRAT MASHKULLORË DHE FEMËRORË NË NJËJËS DHE SHUMËS

VJESHTA

Me ditë të tëra po bie një shi i imët vjeshtë. Koha është e ftohtë. Dielli është i vrenjtur dhe i nxirre. Përrocka e turbullt, lumi i turbullt, rrugica e turbullt. Kemi nevojë për diellin e ngrohtë.

Ushtrime:

1. Si është koha? Si është qielli? Si është përrocka? Si është lumi? Si është rrugica? Si është dielli?
2. Përcakto gjininë e emrave: koha, qielli, përrocka, lumi, rrugica, dielli!
3. Cilës gjini i takojnë mbiemrat: i imët, e ftohtë, i vrenjtur, i nxirre, e turbullt, e ngrohtë?

Ushtrime:



Dielli i verdhë



Kamera e vogël



pëllumbi i bukur

Kujdes:

Mbiemrat çdoherë marrin gjininë e emrit.

Detyrë për në klasë:

1. Lidh emrin me mbiemrin si në shembullin e dhënë:

djali	e blertë
vajza	i lartë
nxënësi	i zellshë
drenusha	e sjellshme
fusha	e butë
mali	punëtor

Detyrë për në shtëpi:

1. Lidh emrin me mbiemrin si në shembullin e dhënë:

bleta	i kaltër
çupa	e fortë
nxënësi	i zellshëm
pëllumbesha	e sjellshme
deti	e butë
era	punëtore
treni	i shpejtë

MBIEMRAT E GJINISË MASHKULLORE DHE FEMËRORE

Detyrë për në klasë:

1. Lexoni mbiemrat e poshtëshënuar dhe vëreni se me çfarë shkronje mbarojnë në fund: i mirë, i drejtë, e gjatë, e mbarë, i artë, e bardhë, e shtrenjtë, i lirë
2. Mbiemrat e mësipërm ktheni në shumës (sipas shembullit):

Njëjës	Shumës
i mirë,	të mirë,
i drejtë,	
e gjatë,	
e mbarë,	
i artë,	
e bardhë,	
e shtrenjtë,	
i lirë	

3. Mbiemrat e gjinisë mashkullore kthej në mbiemra të gjinisë femërore dhe anasjelltas, mandej shkruaj në fletore (sipas shembullit):

Gjinia mashkullore	Gjinia femërore	Gjinia femërore	Gjinia mashkullore
i mirë	e mirë	e gjatë	i gjatë
i drejtë		e mbarë	
i artë		e lartë	
i lirë		e shtrenjtë	

38

Detyrë për në shtëpi:

1. Gjeni fjalën e kundërt të këtyre mbiemrave: i shkurtë, e bardhë, i ngathtë, i hollë, e shkathtë, e butë, i ftohtë, e lehtë

Mbiemri	Kuptimi i kundërt i mbiemrit
i shkurtë	<i>i gjatë</i>
e bardhë	
i ngathtë	
i hollë	
e shkathtë	
e butë	
i ftohtë	
e lehtë	


NUMRI I MBIEMRAVE

Ushtrime:

Bilbili **i vogël** këndon në degë.
Bilbilat **e vegjël** këndojnë në degë.




Pëllumbi **i** bardhë



Pëllumbat **e** bardhë



Lapsi **i** gdhendur



Lapsat **e** gdhendur



Peshku **i** vogël



Peshqit **e** vegjël

Në cilin numër janë emrat: bilbili, pëllumbi, lapsi, peshku?

Në cilin numër janë mbiemrat që janë pranë emrave?

Në cilin numër janë emrat: bilbilat, pëllumbat, lapsat, peshqit?

Në cilin numër janë mbiemrat që janë pranë emrave?

Kujdes:

Mbiemrat kanë dy numra: numrin **njëjës** dhe numrin **shumës**.
Numrin e marrin nga emrat pranë të cilëve qëndrojnë.

Detyrë për në klasë:

1. Mbiemrat vijues janë në numrin njëjës, shëndrroi ata në shumës, duke i shkruar në fletore (si në shembullin e dhënë):

i shpejtë

të shpejtë

i fortë

i mirë

e ngrohtë

e qeshur

e drejtë

2. Përcakto gjininë dhe numrin e këtyre mbiemrave (të zeza, i bardhë, e fortë, të mëdhenj, e trashë), mandej bën një tabelë në fletore dhe radhiti si në shembullin e dhënë:

njëjës	shumës	gjinia mashkullore	gjinia femërore
	<i>të xexa</i>		<i>të xexa</i>

Kujdes:

Gjinia dhe numri te mbiemrat çdo herë duhet të përputhen. Për shembull: nxënësja e mirë, e jo : nxënësja të mirë.

Detyrë për në shtëpi:

40

1. Ndërto fjali me mbiemrat e dhënë (e zezë, të bardhë, i fortë, i madh, të trashë, i lartë, të shpejtë, e gëzuar).

FJALËT QË TREGOJNË NUMRA (NUMËRORI)

LOJA MATEMATIKORE

Të qëlluarit e numrit të menduar

A: Mendo një numër më të vogël se dhjetë dhe unë do ta gjej se cili numër është ai!

B: Po, mendova.

A: Huazo nga X po aq sa ke menduar për vete.

B: Po, huazova.

A: Merri nga unë tetë dhe mblidhi krejt këto, kurse shumën e përgjithshme pjesëtoje me dy.

B: Po, e pjesëtova.

A: Tani jepja personit X ato që ia huazove!

B: Po, ia dhashë.

A: Tani a të kanë ngelë katër?

B: Po, katër më kanë mbetur.

Detyrë për në klasë:

1. Gjeni numërorët në tekstin e mësipërm dhe nënvizoni.
2. Zëvendësoni pikat me një numëror:

Emira shikon nga dritarja në autostradë dhe numëroi automjetet në rrugë që kaluan brenda dhjetë minutave. Kështu, nga të dhënat që i mblodhi, konstatoi:

41

- a) Brenda minutave kaluan më pak se dhjetë vetura dhe një më shumë se tetë. D.m.th. kaluan vetura.
- b) Përminuta kaluan më pak se pesë kamiona dhe më shumë se tre D.m.th. kaluan..... kamionë.
- c) Për dhjetë minuta kaloi vetëm autobus.

Detyrë për në shtëpi:

- 1.Përgjigjuni pyetjeve duke përdorur numërorë dhe shkruani në fletore. Sa nxënës jeni në klasë? (Shkruani me shifra).

Ne në klasë jemi _____

Sa djem jeni? _____

Sa vajza jeni në klasë? _____

- 2.Vazhdoni të shkruani në fletore numërorët gjer më dhjetë (sipas shembullit):

1 - një

2 - dy

...

Detyrë për në klasë:

1. Punoni në fletore, duke u bazuar në kërkesat e mëposhtme.



Pllaka me shkronja

A	A	A	R	R	R	K	K	K
N	N	N	A	A	A	R	R	R
I	I	I	N	N	N	A	A	A
R	R	R	E	E	E	N	N	N

Cila etiketë i përgjigjet ekranit të mësipërm?

Ekranit i përgjigjet etiketa numër ...

b) Sa shkronja ka në "Pllakën me shkronja"? (Vazhdo në fletoren tënde.)

42 c) Sa shkronja : "E," "K," "R," "A," "N" dhe "I" ka në "Pllakën me shkronja"? (Shkruaj në fletore sipas shembullit):

- Në "Pllakën me shkronja" ka *dhjetë* shkronja E.

-K.....

-R.....

-A.....

-N.....

-I.....

ç) Cilat shkronja mungojnë?

d) Sa shkronja mungojnë?

SHKRIMI I NUMRAVE ME FJALË

Detyrë për në klasë:

1. Vazhdoni të shkruani në fletore numërorët gjer më njëzet (sipas shembullit):

- | | |
|------------|-----------------|
| 1 një | 11 njëmbëdhjetë |
| 2 dy _____ | 12 dy _____ |
| 3 _____ | 13 _____ |
| 4 _____ | 14 _____ |
| 5 _____ | 15 _____ |
| 6 _____ | 16 _____ |
| 7 _____ | 17 _____ |
| 8 _____ | 18 _____ |
| 9 _____ | 19 _____ |
| 10 dhjetë | 20 njëzet |

43

Detyrë për në shtëpi

- | | |
|------------------|-----------------|
| 1 të përtrihet, | 14 foletë |
| 2 fillon | 15 bilbilat |
| 3 Toka | 16 ndërtojnë |
| 4 e bjeshkëve | 17 e tyre |
| 5 shkrihet | 18 me zërin |
| 6 dëbora | 19 duke kënduar |
| 7 dhe uji | 20 të ëmbël, |
| 8 gurgullon, | 21 zemërapur |
| 9 i tyre | 22 e ballëllart |
| 10 dalin | 23 kurse bujku |
| 11 dhe milingona | 24 punon |
| 12 Bleta | 25 në fushë |
| 13 në punë | |

Detyrë për në klasë:

1. Plotëso katrorët me numra dhe ngjyros.

										14		12										
										x		x										
										x	x	x										
		3								x	x	x	x	x								
0	1	2	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x			0	
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
	x	x	x	x	x	x	x	x	x		x	x	x	x	x	x	x	x	x	x		
10											3											10
											2											
											1											
											0											

45



me të kuqe



me të kaltër

KOHA KUR KRYHET VEPRIMI

Ushtrime:



Foshnje

KOHA e shkuar

Ka ndodhur dikur

Isha



fëmijë

KOHA e tashme

Ndodh tani

jam



e madhe

KOHA e ardhme

Do të ndodhë më vonë

do të jem

Detyrë për në klasë:

1. Punoni sipas modelit:

46

Vjet	Sivjet	Në vitin e ardhshëm
Isha kl. _____	jam kl. _____	do të... kl. _____
200	200	200
Dje	Sot	Nesër
E hënë		
Para	Tani	Pas
	Lexoj	

2. Cili numër ndodhet para dhe pas? (Shkruaj me shkronja).

Para	tani	pas
gjashtë	7	Tetë
	3	
	6	
	2	

Detyrë për në shtëpi:

1. Shkruani në fletore sipas shembullit:

Dje	Sot	Nesër
lexova	lexoj	do të lexoj
	shkruaj	
punova		
		do të luaj

Detyrë për në klasë:

1. Shkruani sipas shembullit, në cilën kohë ka qenë?

	Ka qenë PARA	Është TANI	Do të jetë PAS
1. Viti 2005			
2. Viti 2003			
3. Viti 2008			
4. Viti 2007			
5. Viti 2001			
6. Viti 2012			

47

1. Viti dymijë e pesë ka qenë para.

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

6. _____

Detyrë për në shtëpi:

1. Plotësoni duke u bazuar në shembullin e dhënë:

	E shkuar	E tashme	E ardhme
1. Unë lexova	+		
2. Unë lexoj			
3. Unë do të lexoj			
4. Unë punova			
5. Unë punoj			
6. Unë do të punoj			

FOLJA **jam** DHE **kam** NË KOHËN E TASHME

Ushtrime:



Unë jam me shokët në grupin e parë
Ne jemi në grupin e parë



Ti je me shokët në grupin e dytë
Ju jeni në grupin e dytë




Ai është me shokët në grupin e tretë
Ata janë në grupin e tretë

48

Unë jam në shkollë
Ti je në shkollë
Ai (ajo) është në shkollë
Ne jemi në shkollë
Ju jeni në shkollë
Ata (ato) janë në shkollë

Unë kam një
Ti ke një
Ai (ajo) ka një →
Ne kemi një
Ju keni një
Ata (ato) kanë një



Detyrë për në shtëpi:

1. Plotësoni fjalitë me foljen **jam** në kohën e tashme:

Unë ... në klasën e tretë. Ti në cilën klasë ... Edhe Jonita ... nxënëse në klasën e tretë.
Unë, Greta, Iridiani dhe Jonida ... në një klasë. Ju, a ... si ne nxënës shembullor?
Natyrisht se edhe ata ... nxënës të shkëlqyeshëm.

2. Plotësoni fjalitë me foljen **kam** në kohën e tashme:

Unë... shumë libra. Ato i ... të radhitura bukur në vitrinë. Ne në shtëpinë tonë të gjithë ... libra, por edhe kompjuter. Ju a ... bibliotekë dhe kompjuter në shtëpi?
Genci thotë se ... bibliotekë të pasur, por ... edhe një kompjuter "Pentium 4".
Po, ti, Kledi a ... bibliotekë dhe çfarë kompjuteri ... ?

Formojmë fjali me fjalët e dhëna

Detyrë për në klasë:

1. Formoni fjali me fjalët e dhëna, duke përdorë foljen **kam** ose **jam** në kohën e tashme:

e shkurtëra Rrena i këmbët

Rrena

të bukur e Pollogut Fshatrat

Fshatrat

dykatëshe jonë Shkolla

Detyrë për në shtëpi:

1. Plotësoni (në fletore) fjalitë me foljen **kam** dhe **jam** në kohën e tashme:

Unë ... Gresa. ... nxënëse shembullore. Shoqe e ... Gentën. Unë ... në bangën e parë, kurse ajo në bangën e dytë. Ajo i ka flokët e gjata, ndërsa unë i ... pak më të shkurta. Gjithmonë luajmë dhe mësojmë bashkë.

Detyrë për në klasë:

1. Në fletoret tuaja, zgjedhoni foljet: **kam** dhe **jam** sipas shembujve:

Unë **kam** një


Ti ... një

Ai ... një

Ne **kemi** një

Ju ... një

Ata ... një



Unë **jam** në bangën e parë

Ti ... në bangën e dytë

Ai... në bangën e tretë

Ne **jemi** në e parë

Ju ... në e dytë

Ata ... në e tretë

49

Detyrë për në shtëpi:

1. Plotësoni në fletore fjalitë sipas shembullit, duke i përcaktuar foljet:

kam, ke, ka, kemi, keni, kanë, jam, je, është, jemi, jeni, janë.

një laps	kam, jam		<i>Unë kam një laps</i>
	Unë ...	një laps.	
të gëzuar	Ne ...	të ...	
shumë libra	Ti ...	shumë ...	
shokë të mirë	Ju ...	shokë ...	
shumë lule në kopsht	Ai ...	shumë ...	
shokë të mirë	Ata ...	shokë ...	
në klasë të tretë	Unë ...	në ...	
lexuar gjatë	Ne ...	lexuar ...	
nxënës shembullor	Ti ...	nxënës ...	
ardhur shpejtë	Ju ...	ardhur ...	
në bangën e parë	Ai ...	në ...	
luajtur futboll	Ata ...	luajtur ...	

DREJTSHKRIMI I FOLJEVE **kam** dhe **jam** NË KOHËN E TASHME



Unë **kam**



një biçikletë



Ne **kemi** një biçikletë



Ti



Ju një biçikletë



Ai (ajo) ...



Ata (ato) ... një biçikletë

Detyrë për në klasë:

50

1. Plotëso sipas shembullit:

Unë	kam	Ne	kemi
Ti	Ju
Ai (ajo)	Ata(ato)

2. Plotëso sipas shembullit:

Unë	jam klasa e tretë	Ne	jemi klasa e tretë
Ti	Ju
Ai (ajo)	Ata(ato)

Detyrë për në shtëpi:

1. Vendosni nga një folje në vend të pikave:

Unë Mimi _____

Ti Lindi _____

Ai Besniku _____

2. Vendosni fjalët: unë, ti, ai (ajo), ne, ju, ata (ato) para foljeve:

_____ shkruajmë bukur.

_____ lexoj tregimin.

_____ shkon në shkollë.

_____ vizatoni bukur.

_____ këndon në piano.

_____ vrapojnë shpejtë.

Detyrë për në shtëpi:

1. Shënoni me **A** foljet në kohën e ardhme dhe me **T** foljet në kohën e tashme:

Mësimi fillon në ora tetë.	<u> T </u>
Sot do të shkojmë në piknik.	<u> A </u>
Ne lexojmë rregullisht.	<u> </u>
Jonita nuk ka biçikletë.	<u> </u>
Anita do të blejë një piano.	<u> </u>
Bletët janë punëtore.	<u> </u>
Nxënësit për festë do të recitojnë.	<u> </u>

2. Gjeni foljet dhe ktheni ato në kohën e ardhme:

- Çka lexon ti, Xheni ? *Çka do të lexosh ti, Xheni?*
Kur i bëni ju detyrat ? _____
Kur mbaron mësimi ? _____
Sa ditë ka ky muaj ? _____

Ushtrime:

- Unë **do të jem** nxënës i mirë dhe **do të kem** sukses shembullor.
Ti **do të jesh** nxënës i mirë dhe **do të kesh** sukses shembullor.
Ai **do të jetë** nxënës i mirë dhe **do të ketë** sukses shembullor.
Ne **do të jemi** nxënës i mirë dhe **do të kemi** sukses shembullor.
Ju **do të jeni** nxënës i mirë dhe **do të keni** sukses shembullor.
Ata **do të jenë** nxënës i mirë dhe **do të kenë** sukses shembullor.

51

Detyrë për në klasë:

1. Ndryshoni vendet e foljeve dhe punoni në fletore sipas shembullit të dhënë:

Unë do të kem sukses shembullor dhe do të jem nxënës i mirë.

Ti sukses shembullor dhe nxënës i mirë.

2. Ndryshoni kohën e foljeve në fjalitë e mëposhtme.
(Shkruani në fletore si në shembullin e dhënë):

E tashme:

Unë jam nxënës i mirë.

E ardhme:

Unë do të jem nxënës i mirë.

Ne do të shkojmë në Strugë.

Erjoni është klasa e tretë.

Ata, gjithnjë do t'i kemi afër.

FOLJA **jam** DHE **kam** NË KOHËN E ARDHME

Ushtrime:

Nesër Erita **do të shkojë** me prindërit e vet në Strugë. Këtu **do të vendosen** në hotelin "Drini", kurse ditën **do të vizitojnë** liqenin. Në plazhin e qytetit **do të lahen** dhe **do të rreziten**. Në Strugë **do të qëndrojnë** një javë.

Kujdes:

Fjalët e nënvizuara me ngjyrë të kuqe: **do të shkojë, do të vendosen, do të vizitojnë, do të lahen, do të rreziten, do të qëndrojnë**, tregojnë veprim, i cili **do të ndodhë në të ardhmen**.

Unë do të lexo-**j** mësimin
Ti do të lexo-**sh** mësimin
Ai (ajo) do të lexo-**jë** mësimin
Ne do të lexo-**jmë** mësimin
Ju do të lexo-**ni** mësimin
Ata (ato) do të lexo-**jnë** mësimin



52

Detyrë për në klasë:

1. Fjalitë e mëposhtme ktheni në kohën e ardhme:

Jonida **lexon** një libër.

Jonida do të lexojë një libër.

Vëllau i Gertës **është** i gëzuar.

Sot mësimi **fillon** më herët.

Klejdi **reciton** një vjershë.

2. Fjalitë e mëposhtme ktheni në kohën e tashme:

Pas mësimit do të shkoj në shtëpi.

Pas mësimit shkoj në shtëpi.

Pasi të ha drekë do t'i bëj detyrat.

Pasi t'i bëj detyrat do t'i ndihmoj babait.

Në kohën e lirë do të luaj futboll.

FJALËT E THJESHTA DHE TË PËRBËRA

Detyrë për në shtëpi:

1. Vendosni foljet në kohën e ardhme:

Kur mbaron viti shkollor? _____

Si i kalon pushimet verore? _____

Kur zgjohesh në mëngjes? _____

2. Vendosni në kohën e tashme foljet:



Çka do të mbjellësh do të korrësh.

Nëse do të bësh mirë, mos u lavdëro.

Kush do të punojë, do të ketë.

Kush do të punojë në rini, nuk do të vuajë në pleqëri.

Ushtrime:



Kujdes:

53

Nga shembujt e mësipërm shohim se tre fjalët e para drejtim, drejtor dhe drejtpërdrejt, përbëhen nga e rrënja e njëjtë e fjalës, **drejt** dhe **për**. Ndryshe këto fjalë quhen **fjalë të thjeshta**, kurse fjalët tjera që formohen nga fjala e thjeshtë quhen **fjalë të përbëra**.

Detyrë për në klasë:

1. Formoni fjalë të përbëra nga fjalët e thjeshta: **udhë** dhe **krye**, mandej shkruani fjalët e përbëra në anën e djathtë.

udhë → rrëfim udhërrëfim _____
 kryq _____
 heqës _____

krye → tar kryetar _____
 ngritje _____
 lartë _____

Detyrë për në shtëpi:

- Formoni fjalë të përbëra nga fjalët e thjeshta: **ved** dhe **dorë**, mandej shkruani fjalët e përbëra në anën e djathtë. (Fjalë për ndihmë: lindje, kalim, qëndrim, mandej, heqje, dhënë, shtrëngo)

NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK

Belinda me prindërit e vet, ditën e shtunë vizitoi Kopshtin Zoologjik. (Ajo, përndryshe është klasa e tretë). Në Kopsht, përderisa mbante në dorë ca banane, një ia hudhi majmunit që afrohej afër telave. Përveç kësaj, ajo edhe e përkëdheli edhe një gjirafë të "vogël" sa dy herë më e madhe se ajo.

Detyrë për në klasë:

- Nga teksti i mësipërm, veçoni katër fjalë të përbëra që fillojnë me fjalën e thjeshtë **për** dhe shkruaj në fletoren tënde si në rastet tjera.
- Formoni fjalë të përbëra nga fjalët e thjeshta: **jashtë** dhe **për**, mandej shkruani fjalët e përbëra në anën e djathtë.

54

jashtë	↗	zakonisht	<u>jashtëzakonisht</u>
		ligjshme	_____
		mase	_____

Detyrë për në shtëpi:

- Formoni fjalë të thjeshtë nga fjalët : **njohje**, **sjellje**, **kuptim** dhe **çmim**, **vlerësim**, **drejtor**, mandej shkruani fjalët e thjeshta në anën e majtë.

_____	njohje	_____
	sjellje	_____
	kuptim	_____
_____	vlerësim	_____
	drejtor	_____
	çmim	_____

FJALËT E REJA DHE SINONIMIKE

Ushtrime:

Dielli bën **dritë** në **dritare**.
Ariani **punon** në **punëtori**.
Në **detë** lundrojnë shumë **detar**.

Në fjalitë e mësipërme kemi tre fjali me fjalët që i kemi nënvizuar me të kuqe: dritë-dritare; punon-punëtori; detë-detar. Vërejmë se nga një fjalë mund të nxjerrim edhe **fjalë të reja**.

Detyrë për në klasë:

1. Nga fjalët e dhëna lidhni me shigjetë fjalët e reja (si në shembullin e dhënë):

FJALËT E DHËNA	FJALËT E REJA
libër	<i>fshatari</i>
këngë	<i>arsimtari</i>
qytet	<i>libraria</i>
fshat	<i>fjalori</i>
arsim	<i>këngëtari</i>
fjalë	<i>qytetari</i>

55

Detyrë për në shtëpi:

1. Nga fjalët e dhëna: mësim, shkrim, punë, mal, fletë, ngjyrë, formoni fjalë të reja dhe shkruani në fletore duke bërë një tabelë me dy kolona (në një rën anë gjashtë fjalët e dhëna, kurse në anën tjetër-fjalët e reja).

Ushtrime:

vajzë - **cucë**
djalë - **çun**
rrugë - **udhë**
fshat - **katund**

dhomë - **odë**
laps - **kalem**
plak - **i vjetër**
rroba - **tesha**

Kujdes:

Në shembujt e mësipërm shohim se kemi fjalë me kuptime të njëjta, për shembull: vajzë, që është e njëjtë me fjalën cucë, madje, djalë-çun, rrugë-udhë etj. Këto fjalë, që janë me kuptime të njëjta ndryshe quhen **sinonime**.

Detyrë për në klasë:

1. Gjeni fjalët që janë të ngjajshme dhe shkruaj në fletore sipas shembullit:

i thjeshtë	<i>gejç</i>	<u>i thjeshtë - I zakonshëm</u>
i pasur	<i>shitblerës</i>	_____
dëshirë	<i>i zakonshëm</i>	_____
i ditur	<i>i mirë</i>	_____
tregtar	<i>pasanik</i>	_____
i njerëzishëm	<i>i mençur</i>	_____

Detyrë për në shtëpi:

1. U gjeni fjalë të ngjajshme këtyre fjalëve vijuese: krye, kalamaj, hare, radhë dhe fshat.

KOPJIMI TREGIMI GRAMATIKOR

56

Jetonte dikur një bretkosë. Bretkosa si bretkosë. E vogël, me tri rrokje: **BRET- KO-SA**.

Dhe jetonte dikur një dre.

Dre! i madh, i madh! Por vetëm me një rrokje: **DRE!**

Kurse bretkosa e vogël tallej me drerin e madh:

-E, e, e! Sa I madh, kurse vetëm me një rrokje!

Por, nga kënetat doli një **GA - TË** me dy rrokje dhe e kollofiti atë **BRET-KO-SË** me tri rrokje.

Dhe, kjo ishte e tëra...

Detyrë për në klasë:

1. Bëni kopjimin e këtij tregimi në fletoret tuaja.

TREGIM PA FJALË



58




DREJTPËRDORIMI I TINGUJVE: Ç, Q, XH, GJ

Ushtrime:



Ky është qeni e nuk është çeni



Ky është gjethi e nuk është xhethi

Çka është gjethi s`është xhethi,

Çka është qeni s`është çeni;

Në të shkruar e në të folur,

Ju fëmijë ndër mend ta keni.

Kujdes:

Shpesh në të folur, por edhe në të shkruar të disa fjalëve, ka raste kur ato të shkruhen apo të shqiptohen gabim, për shembull, në vend që të shqiptojmë gjumi, themi apo shkruajmë xhumi, në vend që të themi qeni, shkruajmë ose theksojmë: çeni ,e, kështu të ngjajshme.

Detyrë për në klasë:

59

1. Vëndoni shenjën - (minus) për fjalën që nuk është shkruar si duhet:

gjami		xheli	
gjumi		xhami	
gjeli		xhygyimi	
gjemperi		xhevze	

2. Vëndoni shenjën + (plus) për fjalën që është shkruar si duhet:

qanta		iriçi	
çeliku		reqel	
qmimi		çilimi	
çeni		kaça	

DREJTPËRDORIMI I TINGULLIT “RR”

Kjo është



Kujdes:

Shpesh në të folur, por edhe në të shkruar të disa fjalëve, që kanë shkronjën rr, ka raste kur ato të shkruhen apo të shqiptohen gabim, për shembull, në vend që të shqiptojmë rrushi, themi apo shkruajmë rushi, në vend që të themi rrugë, shkruajmë ose theksojmë: rugë, e, kështu të ngjajshme.

Detyrë për në klasë:

1. Vëndoni shenjën - (minus) për fjalën që nuk është shkruar si duhet dhe + (plus) për atë që është e shkruar në rregull:

ryma		rotë	
rrumbullak		drritare	
rugicë		rrip	
rrudhë		rënjë	
rushi		ruga	

60

DREJTPËRDORIMI I TINGULLIT “Y”

Ky është numri → **2**

Kujdes:

Shpesh në të folur, por edhe në të shkruar të disa fjalëve, që kanë shkronjën y, ka raste kur ato të shkruhen apo të shqiptohen gabim, për shembull, në vend që të shqiptojmë dymbëdhjetë, themi apo shkruajmë dimbëdhjetë, në vend që të themi dyshim, shkruajmë ose theksojmë: dishim e kështu të ngjajshme.

Detyrë për në klasë:

1. Vëndoni shenjën - (minus) për fjalën që nuk është shkruar si duhet dhe + (plus) për atë që është e shkruar në rregull:

di		vishkje	
ilberi		illi	
dymbëdhjetë		qishki	
dyshim		qyski	
I diti		rryma	

